

Tajar Dollani



LETRA NGA SKËTERRA

roman publicistik dantesk


UEGEN

354-31
D 68

Tajar Dollani

Letra nga skëtterra

- roman publicistik dantesk -



EBB

Enti Botues Berat 1996

Redaktor: Ylli Polovina
Kopertina: Yzedin Shelegu

Të gjitha të drejtat i janë rezervuar autorit.

Botues: Xhevahir Lleshi
Shtëpia Botuese UEGEN, 1996
Tel. Fax: +355 62 33486. 32244
Realizimi në kompjuter "ALEKSI & Co"
Tel. Fax: +355 62 32287

Shtypur në Republikën e Shqipërisë
Shtypshkronja UEGEN, 1996

*Ia kushtoj
mbesës sime Miri,
me rastin e 7 vjetorit.
Të më rritet e lumtur
në një Shqipëri
të lirë, etnike dhe
demokratike.*

Gjyshi

Vlorë, 11 janar 1996

I

Midis meje dhe lundëtarit të Akeronit një mashtrues i madh

Të dashurit e mi!

Vendi nga po ju shkruaj nuk shëmbëllen me kasollen e atij fshati, as me ndonjë bazë tjetër ku ndenja më vonë. Ajo nuk është prej thupre e kashte, por një shpellë shkëmbore si banimet prehistorike.

Këto letra, pasi t'u kaloni një sy, jepuani sekretarëve t'i përpunojnë e t'i botojnë të lidhura si një roman (publicistik) sepse dua ta lëvroj dhe këtë gjini të letërsisë.

Muza flokëzezë, kur ngehet, më mirë se kudo, këtu gjen prehje. Ajo shkreh flatrat pendëshkulura mbi letrat e mia e unë shkruaj pa pushuar. Jam i frymëzuar prej saj. Do të mundohem t'ju tregoj një për një të priturat e të papriturat e këtushme si të më vijnë ndodhirat.

Në këtë letër dua të lëshoj hije - dritë mbi një shkrimtar, të cilin e mbanim nëpër këmbët tona, mbasi një gënjeshtër e tij e paskrupullt më del në rrugë e sipër drejt botës tjetër, të pasosurës.

Ju doni të dini se cili është ai?

Ai më mirë se kushdo e kuptonte se e përdora rremujën e luftës për të hedhur zaret e fatit tim, e dinte se për mua atdheu do të ishte një pellg gjaku ku shkelte çaprazi i çapit tim, që do të linte gjurmë në historinë e kombit, ai e dinte se për mua turma nuk kishte vlerë, kundërshtarët i

zhdukja, të nënshtruarit i shtypja pa mëshirë. Ai më kup-
tonte mirë mua sepse në strofkën e lepurit të tij flinte luani
im, me dogmat e mia, brumoste dokrrat e tij; kur më shihte
mua të zemëruar, vishte lëkurën e dhelpres më i përçmuar

Do ta shtjelloj , në këtë letër, sepse gënjeshtria e tij,
megjithse ka filluar në vargjet e atij aty, ajo mbaron në
varkën tonë këtu ...

- Ende pa kapërcyer tej varrezave jehona e trokit-
jeve të këpucëve tuaja,(të cilat më rrihnin si me tokmak
tëmthat e kokës) unë i mbetur fillikat, dëgjoja zëra e të thir-
rura:

- Ti o bir i skëterrës. vepër e djallit të mallkuar,
çohu! Largohu nga ne dëshmorët e rënë për kombin. çohu!
Ty skëterra po të pret. E dëgjon si po të thërret?

(përsëri dëgjoja zëra e thirrje)

I tronditur nga ky vegim i llahtarshëm, dal nga
arkivoli, më përshkojnë të rrëqethura nga tmerri. Një forcë
misteri më tërhiqte tatëpjetë shkallëve ashtu siç isha i ve-
shur me qefinin krahëve.

Qenë pak dyzetë ditë për të më shplodhur, për më
tepër kur do të endesha në atë natë të pasosur, pa pushuar
kurrë më.

Po fillonte të luhej tragjedia ime në skena të tjera.
Përballimi i kanosjeve më trondiste, më dukej se do të
humbisja ç'kisha fituar.

Po shpejtohem. Megjithëse aty kujtonin se s'kisha
nge, se gjoja shtjelloja çështje kardinale, mua këtu s'më
mbetet kohë të shkruaj dy fjalë më tepër për ju.

Gjumi i vdekjes nuk qënka kaq i rëndë sa e përfyty-
rojnë njerëzit, sepse, unë i fjetur isha e dëgjoja zërat që
përmëdnin emrin tim:

- O ti bir i skëterrës! Çohu! Ç'rri aty? Shokët po të

presin në ferr. Ne të rënet e Kombit të akuzojmë për tradhëti të idealeve tona Çohu! Çohu! Shporru që këtej! - më ushëtinin britmat pa rreshtur

U zgjova nga thirrjet ogurzeza në natën e të dyzetave e cila sapo kishte shkëlur pragun. Vandalizmi i çvarrimit më fanepsej e s'më linte të qetë. U nisa nëpër një udhë të rrahur deri te bregu i Akeronit. Në atë muzg një murrane me pirgje e sharapollë më shëmbëllente si beton-bunker lufte. Mendova të strukesha atje e të gatitesha për ndonjë të papritur?! U mësheva në atë gërmallë e po vështrëja valështruarin lumë. Dëgjova oshëtimë të hapave. Një hije po afrohej drejt meje. Po shpejtonte sa s'vraponte. Vallë më kërkonte mua?! Aty për aty përkëmbem e doja ta pyesja nëse dinte se ku nisej varka. Tashti isha zbuluar

Ai, sa po më gjeti, m'u hakërrua:

- Përse ke qëndruar këtu? Je frikësuar o varrgërmuar?

Duhet të vijosh udhëtimin për atje ku je nisur!

Mua më ishin mbërthyer nofullat e s'po mundja të lidhja fjalët e t'i thoshja se po prisja orarin e varkëtimit e se varka nuk dukeshë në horizontin uhor.

Foli përsëri ai pasi m'u afroa:

- Dëgjo këtu. Mua s'mundesh të më mashtrosh ti e askush tjetër;

Po ta them, mua, as më gënjen dhe as më dredhon në këtë botën time, o tinzar.

- Më trego më parë cili je? - s'e pyeta sa për të shuar kurreshtjen por më duhej të dija se cili ishte ky, me kë kisha të bëja.

- Jam kryeroja i veshur me pushtet për çdo të vdekshëm. Ti eja me mua se ke humbur I verbër je? A e kupton se këtu nuk i mban këmbët asnjë nga kalimtarët?

- Ecja pa të, por pas atij. Ai fliste, unë vetëm sa i dëgjoja zërin:

- Karonti, ky varkëtar i moçëm, qëkurse ka lindur njerëzimi e deri më sot e ka limanin atje - dhe më tregoi drejtimin me një lëvizje ajrore të krahut. Kjo këtu, duket, nuk është skelë. Po ti gjithmonë i je shmangur vdekjes, në luftë e pas saj, por ama të gjeti. Tashti kërkon t'i fshihesh skëterrës, por nuk ke sesi shpëton, do të të gjejë, ja po i afroresh me këmbët e tua.

Akuzat ia pranova në heshtje, por mua më çuditi përmëndja e emrit të Karontit, sepse ne e dimë se ai ka dalë në pension e nuk punon më! Apo ndoshta m'u përplasën nëpër llapat e veshëve rrokje të ngjashme me emrin e tij?

Ta pyes, të mos e pyes; do ta pyes.

- O ti i pushtetit nëntokësor, do të pyes: a e përmënde emrin e Karontit?

- Po, e përmënda, ai kryevarkëtar i palodhur e i papërkulur, në mot të qetë e nëpër tallaze e dallgë të tërbuara, përcjell pa pushuar në jetën e përtejme, të pasosurën, të gjithë pa dallim. Varka e tij barkgjërë e velangrehur udhëton e udhëton pa përtim.

Mua m'u kujtua poeti ynë, një varg i tij (që pati bërë bujë) atëhere.... Vendi ynë s'do të kishte më pleqëri?

- Ç'shqetësim ke? Përse pyete? -

U ndalua pranë meje dhe mbështeti dorën e tij të akullt mbi zverkun tim të holluar.

- Unë pyeta kot për atë - e gënjeva i tronditur.

- Dëgjo? - më doli përballë - E shoh se ke një barrë me thinja mbi kokë, ti këtu do të thuash gjithmonë të vërtetën. Prandaj kallzo se si je ngatërruar me varkëtarin e Akeronit faqeparuar.

- Kot mo, kot, për muhabet më tepër - i'u përgjigja

shkurt për të kaluar në një temë tjetër.

- Unë i kuptoj se ai do t'i kishte mashtruar të gjithë idhtarët, lexues të tij, por vetëm ty jo, por më trego më tej,
- e më preu rrugën prapë.

- Do të të dëftoj. Një nga më të shumtët i thurte vjershat ashtu si thuret një shportë, shpejt e shpejt. Në njëren ai lajmëroi botën se në vendin e tij nuk kishte më pleqëri, e se Karonti nuk do të kryente më ndonjë detyrë, por e la të pushonte nëpër mitet e kota. E kupton tashti?

- E kuartë.

Më la të ecja por rrugës më pyeti nëse e kisha monedhën.

- Po e kam, atij tatimi i jam nënshtruar pa vetëdije, se ditën e të tretave, më shtinë në gojë një të tillë.

- E mirë se Karonti do të lërë të zësh krimba e bakterie këtej ujrave akerone.

Mua ca nga djerët që më dualën kur u detyrova të them të vërtetën për këtë gënjeshtër dështake, që do ta quaja (si shprehet ai) kulminacion, ca nga mjegulla e dendur, po më rëndonin kindat e qefinit të linjtë. Unë i mbajta me njëren dorë ato që të mos më binin.

Ruga gjer te limani m'u duk e shkurtër se e kaluam me bisedë.

Ja, varka. Një fortesë e drunjtë e mbërthyer me perona metali të farkëtuara që nga koha efestiane. Tani jam fare pranë atij, - thashë me vete. Para meje shëmbëlltyra e gjigandit të valëve të amëshimit, Karonti. Të tjerët, lundëtarët, ishin truppërkryer si atletët e hershëm. Mua m'u kujtuan filmat, Evropa e viteve tridhjetë, Parisi, studimet, djalëria, Brukseli, aventurat.

Filluam të ngjiteshim në anije një e nga një. Mes leshrave të shpupurisë dy sy të kuqërremtë, si dy kongjij të

përflakur, më goditën mua si dy shigjeta vezulluese e unë mbeta krejt i hutuar si rrallëherë. Përse, vallë, më vrojtonte me këtë kureshtje të pangopur: Ç'qe kjo dëshirë e pasuar? Megjithëse unë po e kundroja vëngër, si e kisha zakon, ai prapëseprapë seç i jepte kësaj pamjeje të pazakontë një shpresë rilindjeje për ne të udhëtimit. Ku na çonte në mijëra e mijëra vozitje? Ku ishte fundi ynë? Po niseshim bashkë, por për në vende të ndara. Unë i përhumbur i dorëzova monedhën e florinjte, por dëgjoja se dy të tjerët i shpjegonin atij se taksën e tyre duhet ta paguaja unë, se ata veç shpirtit nuk kishin patur gjë e mall. Ai më lajmëronte me shenjë të kthehesha, por turma ku tashmë isha kredhur, më kishte fshehur.

Janë fate që përsëriten!?

Varkën po e ndihmonte një puhizë e pandërprerë. Lundrimi po na shkonte mbarë, mirëpo lopatjerët sepse nënqeshnin tek kthenin shikimin mbi mua.

- Cili qe atje ai i mënçëm'i botës që lajmëroi të vdekshmit e mbretërisë tënde se unë për'ta kisha dalë në pension? më pyeti Karonti qetë-qetë.

- Kush të ka gënjyer, o varrgërryer? - më pyeti shoqëruesi i tij, duke shikuar atë, si për të marrë pëlqimin e tij për këtë ndërhyrje.

- Një letrar që shërbente në oborrin tim, - iu përgjigja me një lloj mburrje.

- Trillimet e tij mund të shuajnë ç'është skalitur në mitet e legjendat e lashtësisë, me pendën e tij të mprehur për të thurur famë ty o shafran, por duhet ta dijë se unë rroj e veprojnë përjetim, se jam emëruar në këtë shërbim prej babait të perëndive të Olimpmit, Zeusit të gjithëpushtetshëm. Kam nisur për në botën e përtejme faraonë e sulltanë, mbretër e tiranë, monarkë e diktatorë, gjykatës e prok-

urorë, kusarë e katilë, spiunë e servilë, por emrin tim s'kanë patur guximin ta përgojnë në jetë të jetëve.

Porsa anija flatrashpejtë prekte bregun tjetër një lopatjer m'u afrua rrëzë veshit e me sa kishte zë më ulëriti:

- Rrëzohu për tokë!

- Më trëmbe mo, - i thashë.

Zbrita me ngathtësi se më ishin mpirë çapokët. Mëndja më përfytyronte poetin. Mua më thoshte njeri nga shokët e klasës, (e kam fjalën për në Francë) se ai s'i lexonte librat e realizmit socialist se kishin gënjeshtër me bisht.

Të mashtrojë kështu tjetri?

Në një letër të mëvonshme do t'u tregoj se si e shpëtuam nga kthetrat e sigurimit të shtetit poetin në fjalë.

Tek po ecnim në truall të fortë, deri tek portali i zyrtë, mua mu shfaq një plak mjekërbardhë plot fjalë:

- Mbaji mend këto që po të them, - më tha ai. - Sa më i tmerrshëm të jetë diktatori, aq më të frikshëm janë të diktuarit që e rrethojnë. Në atë shtet çdo punë shpërbëhet e humbet. Muzat flokëbardha arratisen prej pendëve letrare. Vepra të pavlera poshtërojnë nderin e një kombi. Hyjnesha e poezisë rri e zemëruar dhe i përbuz ata që të shërbyen ty o sundimtar i nëmur...

Ai u nda prej meje, për të mos u takuar kurrë, se u përzie me të tjerët në atë linjë nga buronte dritë. Atyre, si dhe atij, u zbardhonte një beretë. Kur e shtie dorën mbi kokë, e preka. Kisha dhe unë një, por e lashë të rrinte atje ku ishte, atë shënjë të kobshme të jetës sime, ndërsa vetë i vetëm bie në kërthizë të errësirës.

I juaj përjetësisht.

II

S'lind dielli atje ku perëndon, perenduaka shpirti atje ku lind

Ferri, më dukej mua, ishte në festë, sepse sapo kalova portalin e gurtë, para meje u shpalos një podium, shkëmb i dystë, mbi të cilin gumëzhinin grupe për këngë korale, kantate, oratorio e recitale. Kë prisnin kështu? Kush do vinte vallë? Thoshin se të gënjerit e penduar do jepnin një shfaqje koncertale të padëgjuar ndonjëherë në historinë e ferrit.

Zëri kumbues i tenorit çante ethirin ferror.

Unë s'po gjej fjalë për t'ju shpjeguar dhe shprehje për ta përshkruar këtë skenë të madhërishme. Një ndjenjë e panatyrshme më shtynte të shkrihesha në këtë shëmtim mahnitës, pa e kuptuar se ç'po ndodhte rreth meje. Ata mua më shikonin për së largu, pa mbrritur ende. Vallë e gjithë kjo ceremoni e pa shemërt, për mua gatitej? Filloi me muzikë vajtimtare. Në vijën e horizontit të përhimtë shkrepitinin shkarkesa zhurmëtare e si lindja ashtu dhe perëndimi e përjetuan këtë pritje kobëndjellëse.

Qanin dhe qeshnin; gëzimi përzjehej me dëshpërimin. Skëterra ishte në rrëmunjë. Kaosi e anarkia muarën përpjestimet e një katastrofe.

Moti u vrenjt. Retë gjuanin njëra-tjetrën me rrufe. Pas shkrepitimave filloi të binte breshër i kuq. Dëgjohen bubullima.

Gjithmonë me kryerojen si udhërrëfyes, unë ndër-

kohë, kisha mbërritur në mes tyre. Aty ajri, tashmë i qetësuar, u spërkat me një ngjyrë manushaqe, pishtarët e shumtë që i mbanin zhurmëtarët nëpër duar, qenë dëndësuar.

Dëgjohej një kantatë së cilës s'ia kuptoja fjalët.

Ndërkohë u ndodha në një rrethim të dëndur pa shteg dalje.

U dha alarmi: I porsa ardhuri në rrezik! Sillni përforcime.

Pushtetari i skëterrës thirri të tjerë roje. Në këtë situatë të papritur, të egërsuar, për të më shpëtuar mua nga rrëmbimi, ai më shtynte e më jepte të kuptoja se unë duhej të vazhdoja të ecja drejt. Por qe përpjekje e kotë, se shikimi m'u errësua dhe veshët më oshëtinin e u shastisa, mbeta pa mend.

Me sa duket më rrëmbyen dy roje që më siguruan në një hapësirë tjetër më në skaj, ku më lanë të vetmuar. Në mes të natës më vjen syzeza muzë: - "O skëterrë, djep i shpirtit tim, kthehem në zgavrën tënde me ndërgjegje të qetë e mëndje të kthjellët, se ta ndërtova shëmbëlltyrën tënde me përkushtim të përkryer si askush tjetër. Me lajkat e tua përkëdhelja ligësitë e mia. Ç'kërkon më prej meje? Ç'mund të bënte një tjetër i dërguar prej teje?"

Jetova e veprova sipas zërave që më vinin prej këndeje, se ti më kishe ngjizur, ty të përkisja e askujt tjetër.

Lakmia, makutëria, smira e të gjitha epshet e mia, yshteshin nga fryma jote e molepsur.

Ambicja, egoizmi, megalomania, harbonin në shpirtin tim e më hazdisnin. S'i përçmoja veset se më pëlqenin. Unë e ndjej dhimbjen e nëndheut, por do ta duroj, ngushëllohem se jam i yti. Epërsitë e mia ia kushtoj helmit farmak që më lëvrinte në deje. Në udhën tonë, unë isha që-

llimi, mjete ishe ti.

Por lërmë të të tregoj mënyra lemerie e t'u shprish gjumin banorëve të tu në këtë pisk nate se në skëterrë s'ka patur ndonjëherë qetësi.

Le të zgjohen! Zgjohuni! Unë erdha. Jam midis jush.

Dëgjohen ulërime e rënkime.

E kam përzënë mëshirën, se s'më vlente. E mbajta pashpirtshmërinë si një armë që stolis gjerdanin e një banditi katil.

O skëterrë! po zbres në zbrazëtirën tënde i shkarkuar tejprtej nga andrrallat e një intrige të pambarim, e cila e mbushte jetën time plot e përplot e s'derdhej asnjëherë.

O mallkim i nëndheut, skëterrë! Po kthehem! Unë eca në udhën e dhunës e nuk u vela as kur emri im u mbulua me turp e tmerr.

Dëgjohen të thirrura.

Më dëgjo o ferr i nëmur:

Druri i shpirtit tim gjethehidhur, rrënjët këtu i pati, degët lart i ndente si shigjeta të thara nëpër shkretëtirë që s'lidhën frute kurrë.

Kë ke më me pekule se unë? Më shtrenjtë se unë kush ta pagoi tramën? Ç'borxh do të të paguaj tjetër? Tashti më qorto. Errësirën e errësoja me errësirë, paditurinë e dituroja me paditurinë. Drita thyhej atje ku ishte hija ime. Skëterra s'mund të kishte fytyrë tjetër, - Këtë sekret s'e dinin njerëzit e thjeshtë, të ngratët dhetarë, të shumtët.

Ç'fituan, armët do t'i mbroja me armë. Caku i mëshirës që gjaku, le të rridhte. Plagët e kombit s'ishin të miat, dhimbjen e provonin të tjerët, veteranët. Atyre që nuk pranonin zgjedhën, kryelartëve, ua përdrithja kokën. Do t'i

kërkojnë një ditë eshtrat e kufomave. S'kanë për t'i gjetur kurrë, sepse u shpërndanë vend e pa vend e trualli është i gjerë, megjithëse e zotëronte një pallat i vetëm, masivi i gurtë. Tek ai masiv, ku mbështilleshin kufijtë e lirisë, unë shtroja planet për të krijuar skëterrën mbi tokë.

S'nginjem duke të soditur, megjithëse s'kam natyrë endërrimtare, por prapë më dukesh si një vegim, o skëterrë! Dua të zhytem i tëri në ty si ai dashnori i marrë, e të shijoj gëzimin e parë që ti më fale.

Himnet, kantatat, rapsoditë, bustet e bronxta e të mermerta i lashë lart e vetë zbrita poshtë. Atje vajta për t'i vënë në gjumë, këtu vij për t'i zgjuar.

Le të zgjohen të mitë! U jam fanepsur natën e më kanë kërkuar. Ja ku më kanë. Le të zgjohen. Kurrë mos u zgjofshin tjetër natë! O sot o kurrë. Ja me mua, ja kundër meje. Në janë të mitë le të çohen se i dua të gjithë këtu!

Dëgjohen të thirrura.

Kurorëzimi i fitoreve në errësi të kërkon më tepër figura të errëta. Zgjuhuni!

Zëra të ngjirur.

Dilni këtu në ingjir të vuajtjeve. Mos pandehni se ju kam harruar. Kujtoni të kaluarën tuaj, dosjet. Ju që kini dëbuar njëri-tjetrin, tashti mblidhuni prapë tok. ndeshjet klanore le të mbeten atje ku u zhvilluan.

Ju pranoj si jeni: të shndërruar në dreqër syshkyer, a në lubi gojëhapur; qenie të zvetënuara, a në formë të neveritura se kam psherëtirë njëherë për ju, si sot, prandaj dilni, unë ju thërras. Dëgjohen klithma.

- Ç'ke, ç'të gjeti, ama - më ndërpreu roja.

- Po thërras të mitë - iu përgjigja.

-Ferri ka ligjet e tij. Këtu është e ndaluar të mblidhen të gjithë sepse janë shpërndarë sipas gjyqit të fundit,

nëpër rraçhë gjithandej.

- Të paktën një të më gjendet pranë, ashtu si më është gjendur në kohën e luftës e deri në vdekje.

- Cilin do të sjellin të parin?

- Dua të takohem më parë me "Babën".

- Fole mirë, kërkesë me mënd e me vend - më lavdëroi ai. Si e kanë quajtur tët atë bre?

- S'më duhet im atë por "Baba" - ngulja këmbë unë në kërkesën time.

- Unë s'mund ta kuptoj se babai yt nuk qënka yt atë, - ngriti vetullat leshatore deri në strehë të flokëve.

- Jo, "Baba" nuk është im atë, të jesh i bindur.

- Mua nuk më lejohet të flas me ty, do të të çojë atë kuçedrën që i fërfërijnë leshrat e kuqe, ajo ndoshta e një "babanë" tënd, — dhe u bë erë, një flakë jeshile më verboi.

Tashti që po të shkruaj këtë letër, kanë kaluar muaj e ndoshta vjete (këtu errësira s'ka masë kohore) që nga ajo ceremonia e pritjes sime te portiku i ferrit.

Larg jehonte muzikë. Vargjet i dëgjoja por nuk i kuptoja, megjithatë ngjarja do të më qëndrojë gjatë në kujtesën e tharë si një tronditje e përjetuar aty.

Kur nata sterrë kapërceu, mua gjumi më rrëmbeu.

I juaji përherë.

III

Fjalimi i kryetarit të detashmentit të djajve të skëtterrës mbyllet me shfaqje festive

Unë, tek shikoja se përpara meje kalonin frymore (të vdekur sa vjet) të ngarkuar me tavolina e stola, flamuj e banderola, pllakata e detaje skene, mendova se po përgatitej ndonjë mbledhje solemne me rëndësi.

Ajo vjen e ndalon para meje. Flokët e kuqërremtë që i valëviteshin nëpër erë i binin gjer te këmbët e i tepronin më Pasi u përpëliti dy-tri herë pastaj me ato gish-tat kockanjare gjeti kufirin e ndarjes për të nxjerre në pah tiparet e shëmtuara të saj. Ishte kuçedra, e derguara nga qëndra.

- Shpirtin tend e degdisen tek ne, - deklaroi ajo me përçmim

- Unë e

- Ti s'ke të drejtë të flasësh, as liri të mendosh se je nën kthetrat e mia. - vazhdoi ajo e egërsuar me zërin e trashë dhe të ngjirur.

- Po unë

Rri Pa fjale! Çohu! Ulu! Çohu! Dëgjo këtu, do të të tregoj shkurt dhe shpejt se s'kam nge të merrem me ty, me presin punë të tjera. Të gënjerit prej teje, tani të penduar, përbëjnë një forcë të pa përmbajtur lëvizëse ferore dhe janë betuar të të zhdukim pa lënë gjurmë, apo të të djegin nëpër zjarret flakëronjës

- Une dua te takohem me "Baben" se .

- Këtu nuk mund te takohesh as me "Baben" e as me taten Ieri tekati! Je nën urdherat tona. A e kupton, budallë! Kuu te duam ne, do të takohesh me te, jo më parë!

Sa rrotullova kokën te kuptoja se ç'bënin amatorët e koncertit, se s'po dëgjoheshin më, ajo u shndërrua në një shtellungë reje që rrapëllente

Ku shkoi valle? Pa më lenë të thurja plane, se tundimi që i shkurter, sepse nga ai lësh drite që erdhi duke u rrotulluar dherazi, u sajua një gardian i cili - me dha shenjë t'i shkoja pas. Kaluam një ngushtice te erret si rrugicat tona. Amfiteatri ishte mbushur plot me djaje. Trupzhevshurit ngroheshin rreth zjarrit, e zderhalleshin me njeritjetrin. Kryedjalli urdheroi te zinin vendet

- Bëhuni vesh e me degjoni fjalën. Këtë shpirt, që është vepra më e perkryer e artit tuaj djallezor, - u liste ai nga një sofat i lartë, - ta mbron se është fenomen i paarrirë të paktën gjer në ditët tona. Nese tentojne për ta rrembyer para gjyqit te fundit te denimit, detyre mbi detyrat është gadishmeria juaj e rrufeshme, sakrifica me sublime për ta shpetuar me çdo kusht pjellen tone drite-shkurter

Degjohen duartrokite frenetike

Posa ne satrapinen e tij s'lejonte te digjej temjan, kuptohet se është yni e nuk ndryshon nga ne. Trillet e intrigat e tij shugateshin me fyren tone, fajet e mekatet e tij kishin fjetur ne shtetet shtruar nga ne ku joshjet e pshore shperthenin si një semundje e dyfishte e tij. Ai është biri i sketerres. Emin s'ja permendim se është nga ata që s'meriton varë as ndër të tijet (Ovacione dhe brohoritje)

Prapë lëreni te hatbojë, kush nuk e lakmon këtë labirinth. Këtu mekataret e dheut gjejne pune për qëllimet e tyre të paarrira. Ligësia e tij dhe motrat e saj le te defrehen

këtu, se në ndarje të tilla kopukut nuk i thyhet zemra. Le ta rrëkellej smirën e tij, te pathinjuen, mbi ata që rrahën ta rrëzonin dikur. Mos e pengoni por përgjojeni. Shoqërojeni këmba-këmbës por lëreni vetem. Ambicja e tij do të gjeje shtigje të tjera lufte.

Kështu e perfundoi fjalën, sakaq atij i sjellin një shandan, në të nuk shihet flakë dhe një kosore së cilës i ndrin presa. Me dy lëvizje të krahut ai ua dorëzon rojeve. Të tre filluam të ecim në atë shkallare të rrafshuar me skenen e kur mbërritem në gjysmen e harkut ndodheshim përballë saj. Ata u ulën para meje e une i ngucur rrija midis tyre. Simbolet e tyre me të cilat po më nderonin ishin të perafërta me të stemës sonë. Doja t'i pyesja por ç'më duhej të ngisja me tre qe, arat i kisha lënë lart.

- Përse mendohesh? - më pyeti roja nga e djathta

Une ngrita supet

- Të lavderoi kryetari yne, - foli tjetri

- Nuk më kanë velur ndonjëherë ato, po ju përse më merrni frymën?

- Prandaj po na rri buzëvarur? Kryetari yne flet tërthorazi

- Jo, ai ju tha të më lini të lirë, - u ankova me ne fund

- Do të largohemi? - më pyeten të dy me një zë

- Po

- Vetem do të rrish? - përseri me një zë

- A do të të dërgoj një djallushke zeshkane? - i pari

- Apo të të gjej një grua shtrigane? - i dyti

- Po mirë, mo, mirë, - punë djajsh, megjithatë unë u zija besë.

- Do të të vijne pas mesnate - thanë të dy

Ndërkohë u hap perdja me xhufka e zile. Në njërën

anë djaj të veshur me uniformë të shndritshme ngjyra-
ngjyra mbanin vegla dhe nga ana tjetër grupi i kengëtarëve
të përbërë nga shtriga të veshura me flokate. ne mes grupi i
përzier i valleve që tundeshin me shkathtesi e padurim. Por
kur u dha sinjali, shpërtheu një uturimë shtërngate. u ndje
një tërmet. Me bujë e eufori folkloristët pushtuan me rram-
pamë pjesën e ndritshme.

*Një grumbull me eshtra e kokallë:
eshtra e kokallë.*

*Flet i vdekuri me të gjallë,
i vdekuri me të gjallë.*

U përhap lajmi anë e mbanë

Kori:

*anë e mbanë;
ra nga fronti një tiran
ra një tiran.*

Korifeu:

*Vargjet ngrinë nëpër strofa, nëpër strofa.
Ç'e gjet Totemin pyet bota, pyet bota.
Natat ngelën në pentagram, në pentagram,
pyet Evropa për Kalanë, për Kalanë.*

Kori:

*Ky Totemi i zëmëruar, i zëmëruar;
dëshon se e kanë tradhëtuar, tradhëtuar
Totemi harronte se ishte kalimtar, kalimtar;
vetëm një arkivol do ta merrte në varr, në varr.*

Bie perdja.

Mua më ra një mendim, bereta e zeze ishte aty,
dëshmi e kobshme. Kujt iu kushtua gjithë ky koncert? Tani
e kuptoja se më prisnin shpërblime dhe shpagime ne këte
jetë të pasosur.

S'më vjen keq për lotët e lolove rreth arkivolit tim.

as për ata që ngashereheshin për forçe zakoni, as për ata që ua prisha planet e ua shthura ënderrat, as për ata që vinin me zell të ngrinin grushtin te qivuri, por me vjen keq që lashë fronin i cili (ashtu si thotë një varg i poetit tjetër) i kishte rrenjët në gjak e për ty, se të lash vetëm midis çakëve të uritur për pushtet e ujërve që do të dilnin një ditë si armiqtë tanë. O grua dëshirat e tua do të digjen si ky shpirti im këtu

Një thirrje e rojeve më këputi fillin e mendimeve

- Çohu, shfaqja mbaroi.

- Ku të shkoj, më t'errët nuk shikoj

- Ja gjej një vend të sheshtë e shtrihu të pushosh

Prita sa u largua turma këmbëshpejtë, u vidhisa aty nëpër ato shkallare për të fjetur atë natë, por gjumi kishte marrë arratinë. Mendimi për ty rrinte zgjuar, gjithësia flinte

Të tridhjetë e tretën natë lajmëtari më tha të shkoja në hetuesi.

L'juaj përherë.

IV

Unë nuk e kam më atë që më dhuroi lakmia, ju mbani mësimet e mia

Hetuesi dhe dy të tjerë, anëtare, se ç'bisedonin, unë qëndroja para tyre. Na ndante tavolina e mbuluar me copë të kuqe. Në të djathtë sekretari se ç'shkruante, në të mëngjër xhelati me zinxhirët në duar.

I pari foli hetuesi.

- Shpirtin tënd e braktisën në skëterre sepse të akuzojnë si një kulm makabër i pashoq në tërë tallazet e të gjitha kohërave, nga Kaini e deri në netët tona.

- Datëlindja e shkollimi yt? - mu drejtua anëtari i parë.

- Datëlindjen time e gjeni të gdhëndur në pllakën e varrit.

Babën e quaja "xhaxha" nënën "ane" megjithëse më donin njëlloj se ata më kishin plellë. Filloren e të mesmen e mbarova në qytetin tim të lindjes. Të lartën më dërguan ta kryeja në Francë. Në gjuhët e huaja përparoja, frëngjishten e dridhja në majë të gishtërinjve.

- Si re në kontakt me doktrinën revolucionare? - më pyeti tjetri.

- Kisha kokë për doktrina. Gjatë viteve tridhjetë gazetat shkruanin sensacione për një vend ku kishin triumfuar të kuqtë ndaj të bardhëve. E kuqja kishte triumfuar në 1/6 e rruzullit tokësor. Rendi i vjetër borgjes atje ishte shka

-tëruar dhe nga familja mbretërore i gjallë nuk mbeti as një trashëgimtar Shtetin e sundonte vetëm i gjithëpushtetëshmi.

- Si reagove kur e pe për herë të parë fotografinë e atij tirani gjakatar?

- Kur e pash për herë të parë madhështor tek shtrinte krahun drejt, me pëllëmbën poshtë, zemrës sime i shpëtoi një pikë loti. Më pushtoi mallëngjimi për të. Më brithte mendja. Një, një i vetëm dhe i gjithëfuqishëm.

- Sekretari ndërpreu punën, trokiti e pyeti:

- A e degjuat se ç'tha? Xhelat!

Gjykimi u ndërpre. Më kthyen në strofkën time.

Jane të rreptë këta xhelatët e skëtërrës. Plagët qenë më të rënda se prangat. Kur u shërova, filloi seanca tjetër.

- Ç'të detyroi të tradhëtosh çështjen e vendit tënd e te shërbesh si vegël e verbër i sllavizmit? Përse shikoje në lindje ti banor i perëndimit?

- Si një lëng helmatar më lëvizte në gjak ambicja. Doja të dilja mbi ujrat e turbullta të atyre viteve të trazuara, prandaj më duhej të kthehesha. Rastësia është fati. Më debuan nga shkolla për turpje ndërsa nga ambasada belge se vashdova të bëja thagma të tjera edhe atje. Aguan shpresat e mia. Si vajta erdha. Më emeruan profesor liceu.

Lufta! U degjuan gjëmime artillerie. Plasi Lufta e Dytë Botërore. Vetedija përpunonte sinjalin e dëshiruar. Lufta që dëshira ime. Në krahasim me qëllimin tim madhor, vogëlsirat nuk më pengonin. Në fushë-betejë ndeshja do të që e ashpër por për çudi, në momentin më kritik të jetës sime m'u gjendën pranë një serb dhe një malazes. Ligjet e zhvillimit të shoqërisë as më lejonin dhe as më ndalonin. Mua më pengonin kryetarët e grupeve të formuara nga të dërguarit e Kominternit. Grindja për të shtrirë nën zotërim

drejtimin e partisë si brënda saj dhe në prapavijë që e ashpër, gjakatare. Më duheshin sa njësitet guerrile aq dhe gjyqe partizane. (U kërkova një pikë ujë se po më thahej pështyma, por ata më kërcënuan) Vendosa një disiplinë të hekurt kudo e për këdo. U thashë se do të luftonin, dhe ata luftuan. U thashë se do të fitonim me therorizëm e theror. Veprimet e mia nuk qenë kurrë të çastit, sheshimi i rrugës drejt pushtetit shtetëror kushtëzohej me shpartallimin e likuidatorëve, kapitullantëve, elementeve antiparti, komplotistëve e agjenturave të huaja.

- Si arrite ta ushtroje gjithpushtetshmërinë e hurit dhe të litarit deri në sekondën e fundit të frymës sate.

- O, s'di të të

U dëgjua rrapëllima e prangave.

- I dëgjove? - më pyeti gjykatësi rreptë.

Unë tunda kokën që më rëndonte mbi supë sa një kungull vjeshtë e vazhdova: - Në esencë evenimentet kishin për pikënisje gjithmonë dhunën. Nga mikrobet, bakteriet, viruset më shpëtonin mjekët e mi por vuajtjet m'i shkaktonte etja për pushtet personal: Më duhej çdo rival të fronit tim ta zhdukja, çdo lëvizje të armatosur ta dërrmoja. Të gjitha të drejtat e liritë t'ua mohoja. Kush shikonte drejt perendimit e verboja. Kokën e partisë herë-herë e freskoja me clementë të bindur e të denjë për mua.

E kjarë, - ndërhyri kryetari. - Tashti na trego ç'mësuan të vdekshmit prej teje?

S'kisha nevojë për oratorë enciklopedikë sepse më mirë se unë kush tjetër do të mbulonte me fjalë varfërinë, mjerimin, paditurinë: kush do t'u mbushte mëndjen atyre se duhej të hanin gjellë kazani, vetëm kështu ata duke ngrenë buken e tyre me doren time mua më tepër do të më donin. Asnjë tjetër më mirë se unë s'do t'i mësonte: Budallenjte të

mendonin, të paaftët të drejtonin, molomënët të shpjegonin. Të digjnin në zjarr zakonet e vjetra nga mua të mësonin. T'i shtypnin kokën armikut të kllasës, të urrenin botën borgjezo revizioniste prapë nga mua do mësonin. Unë i mësova komunistët ta donin Strategun e madh sepse ai na porosiste që të pangrënët t'i linim të uritur, të paparët t'i linim të pashëtitur. Unë e shndërrova partinë në një kudhër ku u kalitën të gjithë me ideologjinë e klasës punëtore, detashmente pararojë e jetës së vendit në çdo fushë. Unë i mësova ata të kenë derte e të mos rënkojnë, të kenë etje dhe të mos e shuajnë, të kenë kokë e të mos u dhimset, të kenë krahë e të mos fluturojnë...

Nga pëshpërime e tyre vura re se ata tashti argalisheshin e po qeshnin nën buzë.

- Po grave mo, grave, çfarë u mësove të ngratave? - Emancipimi i tyre?

- U' grave u mësova që para se t'u bjerë fëmija t'i thonë se është ushtari i partisë. Nën timer për çerdhe e kopshte, mësonjësit nëpër shkolla e gjetkë për mua t'u kallëzojnë e të më lavdërojnë. Pleqtë e plakat të mos tangërlllojnë, të tepërta s'ka, se jemi në epokën e madhe. E ç'kërkojnë më tepër nga mua?

- Vazhdo më tutje, thellohu, - më shtynte njëri nga ndihmës-hetuesit - të tjera na kallëzo! Ç'i mësove vegjëlisë?

- U' i mësova fshatit të dorëzonte prodhimin në shtet pa e bërë vetë "me shëndet", të rronin pa pronë e pasuri, pa një gjedhe e pa bagëti, pa një pulë me dy këmbë e të mos mbanin mënd ç'hëngrën mbrëmë. Shtresës qytetare i mësova të shkonte të punonte në frontet më të vështira, ku përleshje jeta me vdekjen. Nuk di se ç'duhej t'u mësoja më tepër. Të dëgjonin klithmën e nënave e të duronin, të shikonin yjet tek shkëputeshin e të mos shkallonin,

të shpalosej flamuri e të mos e nderonin, të kishin atdhe e të mos e donin. Ata ndezën zjarrin që t'i digjte, ata lëshuan lumin që t'i mbyste, ata mbuallën erën që t'u korrte të lashedat, ata ndollën tërmetin që t'u prishte vatrat, ata kërkuan errësirën që t'u shuante dritat, ata përqaftuan djallin që t'u pushtonte shpirtrat.

- Ç'ke që shkrofëtin si kali kur e shalojnë? - më ndërpreu hetuesi i tretë.

U mbloodhën kokë më kokë; se ç'biseduan. Hetuesi më tha:

- Ne do të vazhdojmë hetimet, do t'i zbulojmë krimet e do të detyrojmë t'i pranosh ato.

- Unë ndoshta do të pranoj fajësinë por në shtigje të reja do kërkohet pavarësinë.

- Para se të vendosësh për këtë mendo se ata të gënjerit e penduar janë forca lëvizëse e shoqërisë ferriane, si do t'i përballosh një i vetëm je! - donte të dinte ai.

- Më shërben përvoja tokësore për t'i përballuar se edhe këtu do të më gjenden pranë pasuesit e mij.

Seanca e tretë u mbyll. Dy rojet më kthyen atje ku më muarën të mbërthyer në pranga.

A të kujtohet, o grua, se edhe ti e pate vënë re që unë po dyshoja te roli i individit në histori? Shpesh herë pyesja nëse vërtetë më donin ata që më brohorisnin apo shpirtëreshin se më donin. Ai dyshim i ditës më mundonte natën. (Gjumi i këtushëm është i varfër me ëndrra se vetë jeta e këtushme është një ëndërr e llahtarshme, megjithëse ty të përfytyroj me sy hapët tek më rri pranë).

Ne po e kuptonim se po ndodhnin ndryshime të dukshme e midis njerëzve tanë s'po e ndjenim më atë ngrohtësinë e dikurshme, a më dukej mua se isha i sëmure? Fjalimet e mia po u binin atyre si breshëri lavë vullkanike, çdo fjalë i digjte

çdo fjali i përvëlonte. Sa me afër e shihja vdekjen aq më larg ata. Më tepër krime u dashkan për të merituar dashurinë e një turme dhe të një detashmenti?

Shefit vallë a i kishte ndodhur kështu vitet e fundit të jetës së tij? Do luaj nga vendi gurët e skëterrës e do ta takoj atë

Ç'vlera kishte ai më tepër se unë?

Si e siguroi ai pavdekësinë?

I juaji kurdoherë.



Ju m'u bëtë këmbë kur unë u nisa drejt pushtetit shtetëror

- Unë u nisa drejt pushtetit shtetëror, ju m'u bëtë këmbë. Unë doja të fluturoja te kulti i individit, ju më dhatë krahë. Unë doja t'i dënoja rivalët e kundërshtarët, ju ngritët gjyqet. Unë ju dhashë armën e sigurimit të shtetit, ju e shprazët atë. Unë ju mpreha në luftën klasore, ju e ashpërsuat atë. Unë e farkëtova kudhrën e kalitjes së ndërgjegjes proletare, ju i rrahët çekanët. Unë ju mblodha në strofka të ngrohta dhe ju më s'dualët prej tyre.

- Unë ju mblodha përsëri dhe ju them:

Ju shihnit tek unë komandantin legjendar (legjendë me gjak) që po zbriste nga malet për të shkallmuar botën borgjeze, ndërsa unë shihja tek ju pasonjës të devotshëm për qëllimet e mia finale.

Unë isha i vetëm në tavolinën e kryesisë, ndërsa ata ishin të ndarë në dy pjesë. E kuptova. Ishte pasojë e luftës së bërrylave klanorë. E kotë përpjekja për t'i bashkuar sepse edhe këtu, mua më duheshin të përçarë. Të hanin shpirtrat e njëri-tjetrit.

- "Ka ndonjë prej jush pyetje? - Heshtja do të thotë jo. Mirë atëherë vazhdojmë.

Djalli që të sundonte në tokë gënjeu më parë në qiell. Unë sulmova lart që të sundoja poshtë. Shkatërrova kryqet, shëmba minaret, ngrita në legjendë besimin tek partia, i ktheva faltoret në klube të dëfrimit toktanë. Mua

nuk më shërbyet vetëm ju që iu kam përpara por edhe kalemxhinjtë me veprat e tyre ku mbarështruan akte heroizmi nga epopeja e veprës time. Edhe e gjithë ajo falangë që blatoi në jetë dhe në histori gjithpushtetshmërinë time, në kohë dhe në hapësirë. Për ta unë isha kudo e mbi këdo. Juve, o zemërlepui, unë ju bëra trima, ju o budallenj, unë ju bëra të mënçëm. (Dëgjova mëmëritje dhe lëvizje, dy tre vetë u ngritën e ikën). E di se do të më shërbejnë më tepër se ju këtu ata lart si prej frikës të së kaluarës dhe të së nesërme që po vjen. Prandaj mënyra ime e të menduarit do të bëhet robërim i mendjes së tyre pa do të kërkojnë vazhdimësinë. Unë do të mbetem tumor i pashërueshëm në materien e tyre. Ndërgjegja e sprovuar nuk do të ndryshket në rrethana të errëta e të papritura ku do zhyteni pas vdekjes time.

- Me leje? Përse ia ndillni këto situata partisë sonë të lavdishme?

- Sepse sipas parashikimeve të magjistricave të Këshillit Qëndror të Skëterrës, shëmbja e regjimit tonë do të vijë me tmerrin e shkatërrimeve e të shkallmimeve, me varfërimin e shtesave të gjëra, me urrejtje e hakmarrje, me gjak, me lot e dhimbje. Prandaj ju kam mbledhur në këtë mesnatë të errët sterrë për të vendosur fatet e partisë, për të thirrur forcat më të devotshme në luftë për çështjen e partisë e të popullit.

- Mua nuk më kujtohet viti, por entuziazmi që thoshin se shpërtheu nuk e di se me ç'rast qe një ...?

- Ty të paskan rrjedhur trutë, si s'e mbajtkë mënd datën e letrës së hapur të K Q.?

Ulu, ulu! Cila është origjina dhe veprimtaria e tij, se të harrosh entuziazmin dhe iniciativat e masave do të thotë t'ia thashë jetën partisë (Dikush ngashërehet). Djersa derdh

-ej rreke në atë zallishte të shkretuar. Por pikërisht ajo shpresë për të ardhmen ish sekreti, se partia u jepte jetë nga jeta e saj, e u sillte dritë nga sytë e saj, i emociononte ata.

Mua më kane lënë kujtime të pashlyeshme ato ditë te furishme - më plotësoi tjetri

Nga fundi i sallës dëgjoheshin të grindura.

- Rri aty e mos u ndje më! - e kundërshtoi i pari.

- Pse të ulem? Dua të flas! - i tha tjetri

- E çfarë t'i thuash atij? Ne bijtë e revolucionit, hëngrëm njëri-tjetrin në arenën e ndeshjeve të bërrylave - ndërhyri i treti.

- Përse nuk bashkoheshin në një klan ata që shpëtonin gjallë, - i dyti përsëri.

- Sepse ata që mbeteshin gjallë flinin për natë në shtratin e vdekjes apo në arrest për t'u dënuar si antiparti. Ky mburrej se po pastronte skorjet.

- Përse grinden ata? - pyeta i shqetësuar - Po kurd- isin ndonjë komplot kundër meje? Edhe këtu mo? Hë mo, flisni?

- Janë shokët tanë, janë tanët.

- Të mitë gjithnjë më shëmbëllejnë si huxhër të liq, të tërbuar, që duan të më kafshojnë kokën e të më fshijnë nga ai fron që e ndërtova vetë dhe vetëm për vete.

- Qetësohu, qetësohu bre. Pse je i tronditur? Froni mbeti lart

Më prunë përsëri te tribuna, në krye.

- Si kërkova të vijnë njëherësh, le të shpërndahen! urdhërova dy të mitë.

- Ti ende nuk je shëruar nga ajo sëmundje që ke vuajtur.

- S'është e thënë kjo, të shuhet partia për një natë! Ia kam lënë në dorë pengut tim dhe të tjerëve. Në e merito-

ftë besimin tim do të dijë të trashëgojë ç'i kam lënë. Të gjithë e dinë, ai i ka të lyera duart me atë gjak që është derdhur në themelet e atij fronti. Unë e parandjej tradhëtinë. Më kanë tradhëtuar! Instiktet jo idealet, e detyruan të më ndjekë pas në vepra e në vese.

- Qetësohuni, mos u hardallosni kështu. Ata do të vazhdojnë vijën tënde. Ç'ke? Ai, ku ke vënë ti këmbët, do të vërë kokën.

- E di se s'e ka mendjen shterpë, le t'i pjelle ashtu si qeni i tërbuar që pjell këlyshë të tërbuar. Le të bashkojë forcat e errëta.. Ku e patëm fjalën?

- Te Letra e Hapur më duket? - donte te më largonte nga tema.

- Jo, jo tek falli i magjstricave, - tha tjetri.

- Magjia thotë se partiakët e lartë të prekur prej përpjekjeve për përmbysjen e pushtetit popullor nga armiqtë e kllasës... do të lëndohen por s'do të rrezohen, ata do të ndryshohen por s'do të ndërrohen, hija ime do t'i ndihmojë të mbijetojnë. Komisarët e doktrinës bolshevike, në përpëlitjet për shpëtim do notojnë në ato ujra e do të krijojnë përsëri partinë e tyre. po të dëgjojnë uturimën e fjalimeve të mia, do të arrijnë të fitojnë ato privilegje të humbura dhe mua të më përjetësojnë lavdinë.

- Me çdo çmim ata t'i shmangen asaj katastrofe!

- A ka si përballohet shpartallimi?

- Le të thërresim forcat e errëta.

Me dialektikë të analizojmë rolin e kllasës punëtore në këto fenomene, të zbulojnë shkaqet, të mbulojnë pasojat me thirrje të etura për terror e gjak. Militantët e partisë të zbresin në fushën e betejës e te rivendosin rendin.

- Po dale bre, ti po shkumëzon tëpkë si aernaj Shlodhu se do na sëmuresh dhe këtu.

- Jo, jo. Të mbyllin me piramida e armë kufijtë. Shtigjet e ndërlikuara për elementin e huaj i rrihni me kamzhikë të kuq. Demagogjia gjithmonë na ka ndriçuar. Mos nënvlerësoni luftën e ashpër me liberalizmin dhe sentimentalizmin, sepse janë armët e mprehta të ideologjisë borgjeze, për denigrimin e njeriut tonë të ri duke ia helmuar ndërgjegjen e tij. Helmet s'na bien prej kupolave. Në esencë ato janë shpirtësi e oportunitizmit politik që përshkojnë në damarët e tyre si produkt i trysisë së botës borgjeze.

- Si të veprojnë xhanëm?

- Mua satanai më mësoi si t'u fitoj zëmrat juve, prandaj s'duhet të largohen nga mësimet e mia se do shuhen si thëngjijtë e zjarrit larg vatrës. Secili nga ata e di përmëndësh jetën dhe veprën time kushtuar sundimit tonë. Në se do të pjesëtohet partia, të qëndrojmë bijë besnik të saj, në se do të lejohen pronat ata të jenë pronarët e rinj. Të vrapojnë të parët kurdoherë. Ashtu më ju lumtë. Ata bëhen zotër të përfitimeve trashëguar prej meje e unë mbetem pronar i truporeve të mia.

Të rrojë partia!

I juaji përherë.

VI

"Më sulmojnë të paformuarit për të më sharë e për të më vrrarë"...

Jam tepër i lodhur e i drobitur, sytë nuk mund t'i përqëndroj në letër, duart më dridhen nga tronditjet nervore, por muza flokëzeze e frymëzimit më shtrëngon të shkruaj kujtimet e këtushme si shkruaja të atyshmet. Lakmia e shtrirë në dy jetët paska funde të veçanta.

Ç'është kjo zhurmë si rrokullisje gurësh? Po zbresin nga lart apo ngjiten përpjete?!... Më pas një fërfërimë e hijeve dredh ajrin... Zëra nate të mbytura... Ç'të jenë valle?!... Ku po venë?!... Kujt do t'i trëmbin gjumin e shprishur, të brengosurin. - Cilët jeni? Ç'kërkoni nëper errësirë?

I numëroj. Ishin katër

- Ju që rendni tutje-tëhu me fytyra të zverdhura e me zëra të dredhura, në kini ndonjë lajm për mua ma thoni. Përse më mundoni?!

- Ne lajme për ty nuk kemi, por nja dy-tri fjalë do t'i themi, më rrethuan dhe m'u pergjigjën:

- Fantazma do vijmë, fantazma do shkojmë,
gjumin do ta vrasim, vrerin do ta zbrazim!

U shkëput i pari dhe më tha:

- Isha i etur të jetoja pa iu përkulur askujt, por ti më skllavërove, or mizor i mizorive Punoja por nuk fitoja. Frytet e punës sonë i shijonte hierarkia jote. Te gruaja e te fëmijët duarthatë shkoja. Më në fund u detyrova të vidhja e të mashtroja. Për këtë ves jam dënuar këtu në skëtërrë të

vuaj

- E se në rrethin e tretë je, - e ngushëllova. - Të ka kalitur partia.

M'u afrua tjetri më i egërsuar:

- Dëgjomë mua! Sigurimi i Shtetit, arma jote më e dashur, më njolloosi me turpin e spiunit, më poshtëroi nderin, në punë të ndryra, u shndërrova në një vegël të sundimit tënd, më bëri shkrimtar me pahir! Jo. mua qortimet e ndërgjegjes nuk më janë ndarë. Dua të të shaj me fyerjet më të rënda sa ta nxjerr djallin që ke brënda

Më përfshiu për gryke

- Lëshomë, o o o! - i them frymëshkumëzuar.

- Nuk të lëshoj, - m'u kërcënua, - se kur kujtoj shokët e mi në lulen e djalërisë, dergjur burgjeve, e nënat e gjora pranë vatrave të shuara me sytë e qorruar prej lotëve (ububu!), një tjetër djalë trim i pushkatuar e jetimët e tij të zbathur me bark të zbratur, gruan e re të një tjetri që e la shkretë kurorën e dasmës, këtu, të shkyer nga hijenat e Skëterrës, nëpër përrenj, dua të të gjejnë! - Matet të më hedhë tatëpjetë por e ndaloi roja.

Më lëshoi mua e i binte kokës së tij me grushta sikur të mos e kish të tijën

- Krimet e mia do të përgjigjem unë e ti more tiran e katan...

Nga zemërimi m'u çuan flokët përpjetë e u bëra si qen i tërbuar e iu përvësua.

- Të kishe vatur në shkollën e sigurimit më mirë do të.

- Oficer sigurimi më quajte?!

Prapë më shkundi e më lëshoi përtokë

- *Quamë njeri pa vatan,
Më quaj varr pa nishan,
Quamë akrep me shtatë sfigurqe,
Më quaj prangë nëpër burgje.*

*Thirrme errësirë, quamë mesjetë,
Inkuizicionin, që vret e pret.
Quamë plumb, që rrëzon një yll,
Më quaj rrufe që djeg një pyll.*

*Thirrme qen që rri përgjon,
Quamë çakall që ulërron,
Më quaj lavë që zjen buçet
Quam Vargua, që lidh një shtet.*

*Thirrme zinxhirë, robëri,
Gjak terror e lemeri,
O xhelat i vendit tim,
Prej teje vuaj, s'gjej shpëtim.*

U mënjanua tepër i tronditur

Më afrohet më pranë i treti:

- Tashti dëgjomë mua Isha anëtar partie. Premtimet e tua na dolën gënjeshtër. Ti na mashtroje ne, e ne të tjerët, sipas mësimeve të tua te pagabuara.

Ku po vinim? Ku po na çojë? Unë po e ndjeja se amaneti i të rënëve po shkelej, korrupsioni e prostitucioni hidhnin valle në vilat tuaja. Ku do përfundonim?

Befas më hodhi taserën e tij, i paformuari.

Lehtë-lehtë më vjen pranë tjetri:

- Përse je dënuar ti? - e pyes.

- Më parë se ti të dish pse-në e dënimit tim, mëso, o mijeran, se ka këngët bilbili që na zgjon mëngjeseve, ka aro-

mën trëndafil qëndisur me brilantin e vesës, ka lamtumirën shpendi në vjeshtën ngjyrë alle, ka hapësira kaltërsinë ku shqipja ndeh flatrat, ka gurgullimën uji që zbret ujëvarave të bjeshkëve...

- Përse je dënuar të them? - e pyes prapë.

- Vrava veten, të vraftë rrufeja dhe me çaponj e me thonj të shkyefshin korbat.

- Poet dekadent, s'ke pranuar parimet e ...real...?!

- Dëgjomë mua, se unë të kam dëgjuar ty! Njeriu mendon e jeton si të dojë. Kënga do melodinë, do bukurinë arti, ndjenjat i do poezia, dashuria do lumturinë, ëndrrat i do rinia; ka duete greku, italiani kanconetat, xhazin ka Amerika, Parisin franca, Romën Evropa, New Jorkun Bota. Ajo, partishmëria jote, mohonte të vërtetën, përçmonte talentin. Ti fitoje famën, ne verigat na vërvite.

Nga Atdheu nuk ka gjë më të shtrenjtë në botë,

Nga zjarri i dashurisë s'ka ndjenjë më të ngrohtë.

Duke u larguar, e zbrasi koburen tri herë në drejtimin tim, por kur u largua tymi i barotit, para meje rrinte një grua të cilën nuk e stolisnin hire femërore, por mua më hutoi sa nuk mbaj mend se ç'më tha. Më duket se kishte tradhëtuar bashkëshortin me sekretarët e partisë dhe ankohej se përse i qarkulloja ata në çdo tre vjet. Të paktën me njërin...

Ajo grua e thjeshtë, s'mund të kuptonte se qarkullimi partiak i kuadrit shmangte grupazhet, miqësitë e sëmura dhe thashethemet për këto aventurat e tyre. Janë parimet e palëkundura të politikës sonë: njeriu ynë i ri, vepra më e çmuar jona. E di ti se ideologjia ka kllasikët, pushteti ka diktaturën, sigurimi ka burgjet, forca lëvizëse ka luftën e kllasave? Ç'na duhet se ç'ka Evropa e ç'ka Bota?! Kjo është vija e masave. Mo e harroni-ketë!

Ai letrar i paformuar duhet të dinte se lufta për jetë a vdekje ishte beteja ngadhënjimtare për fitorjen e socializmit. E kjo betejë përmbliidhej në legjenden e pesëvjeçarëve e prodhimit të bukës në vend. Ai se ç'më thoshte se kishte bukurinë ylberi, kur brezonte pas shiut pranveror, se kishte nata yjet magjepsës, kur xixëllonin, se kishte Evropa atë e kishte bota këtë..., sikur kishte lindur para meje.

Mua më duhej tjetër prozë poetike. më duhej një letërsi që të militonte për mua e vetëm për mua e as për një bukuri tjetër të gjallë sado e shëmtuar të ishte vdekja e saj e pashmangshme.

I juaj kurdoherë.

VII

"Misionit" të UOR fisit kufirin ia caktova te thana.

Një palë këmbë godisnin truallin me një trokëllimë ushtarake Vërvitej dikush me një ecejakje aty pranë. Fillova të dyshoja... Cili ishte ky? Nga ushtarakët e mi jo. Se ata as merrnin guximin e as i merrte malli. Ne u ndamë si armiq e më urrenin për vdekje. Qëndrova në përgjim. Mbatja frymën. Ai pyeste për mua duke shqiptuar vetëm mbiemrin tim. I huaj, ndonjë nga të luftës. Fshij sytë. Ai, më dukej si në ëndërr... Por jo. Ja, ai, para meje, më shikonte ngultazi po me ata sy të çelur. Më tepër nga fytyra e kuqërremtë, që dëshmonte ende se e kishte pirë uiskin me shishe, e shëmbëlleva. Emri i tij s'më kujtohej fare. Megjithatë isha i sigurtë se ky trashalug, rreth të pesëdhjetave, ishte gjenerali anglez, i dërguari i forcave aleate të Mesdheut me qëndër në Kajro. Pa dyshim ky ishte ushtaraku i shërbimit sekret të cilin "Baba" e priti me këmbët e para: "Duam të na hudhni armët!"

- O gjeneral! A vjen të më kujtosh gjeniun e vargut e mikun e tij, apo ato përplasje të rrepta lufte të mbushura plot me shpresa lavdie e fitoreje?!

- Në të vërtetë, ne politikanët ushtarakë që shërbyem si misionarë, jemi në rrethin e parë e të dytë. Zbrita këtu për të takuar një mikun tim dhe ...

- I rënkeni shkurt, gjeneral, - e ndërpreva.

- E çfarë t'i lëndojmë ato plagë lufte! - m'u ankua ai.

- Atehere vjen të më takosh dhe mua si mikun tend?
- e pyeta unë.

- Jo se mbi miqësinë tonë ra bresheri i viteve te shkëputjes së hidhur. - foli ai i dëshpëruar - Emrin tim e vrau shigjeta jote

- Për kë e ke fjalën?

- Për librin që ke shkruar. Atje urrejtja është mishëruar me

- Porsa u ndamë si armiq, libri me urrejtje do të gatuej e shkruhej.

- Etja dhe pasioni, talenti për të lozur role dhe intuita jote, egoizmi dhe mendja, fati dhe fama te shndërruan në gjeni djallëzor të mashtrimit të kohës sonë. Por medet për fatin e atyre që s'mundën të të njohin ligësinë tende

- Të lutem, - i thashë - mo më detyro të të godas dhe këtu me ato fjalë të librit e të përmënd, krimet e tua, në shtypjen e lëvizjes kundër zgjedhës së mbretëreshes se detrave, - i rashë atje ku e ndjente më tepër dhimbjen, mu në një plagë të hershme te tijën.

- Ne donim t'i shpëtonim ato vende nga kolera komuniste që po shpërndahej. Ajo doktrine për ne ishte utopike, për ata shpresë dhe jetë, iluzion dhe zhgënjim mburrje dhe varfëri, krim dhe poshtërim...

- Epo edhe tek ne me këtë mision erdhët, prandaj jua caktova kufirin te thana, - e ndërpreva me rrëmbim, se më doli vetë në shteg

- Jo te thana, por te fiku, se në mes te fushes se Bizes, afër çadres time, ishte një fik

Qeshëm te dy

- U nisëm tek ju e mberritem si aleate, se donim te mbarështronim taktiken dhe strategjinë e luftes se petbashket kundër bishes se eger që donte te zaptonte rruzullin mb

arë, - u mburr ai

- Bukur, - ia prita unë, - por fjalët e premtimet tuaja, për punët e mia, s'përkisnin me veprat që kryenit. Ju erdhët të peshkonit në ujrat tona të turbullta e s'ia arritët qëllimit

- Të paktën përse nuk pendohesh. Ti vetë e pe ç'gjak rrodhi nga ato plagë të kombit tënd.

- Lufta është luftë. Revolucioni s'e njeh mëshirën.

- Po përkthyesin tonë përse e vratë? - më pyeti me sy të përlotur Ai ishte bir i revolucionit e s'i duhej mëshira jote, - shtoi gjenerali.

- Të qajnë sytë për të? - u nxeva unë.

- Edhe tani që rrojmë në botën e përtejme, unë prapë për ty jam i huaj. Emrin e tij s'e harroj e s'e shuaj nga shpirti im. E nderoj si gjithë të rënët e tjerë. Më kujtohet mirë. Po ecnim krahë për krahë Pa pritur ramë në pritë. Me të shtënë e parë u plagos ai, Ndërsa po e tërhiqja për t'u fshehur në pyll, edhe plumbi i dytë atë qëlloi, - kujtoi gjenerali tepër i tronditur.

- Ai ishte "Tafari", të cilit i vinin mesazhe nga radio Londra.

- Përse di unë.

- Ju po anoni nga armiqtë tanë, - e ndërpreva - Premtimet tuaja për të na dërguar armë u kthyen në rutinë tinzare. Unë i kuptova qëllimet e errëta të atij "misioni".

- Synimi ynë ishte përqëndrimi i forcave në një front të vetëm. I ajmëruam të dy palët ta sulmonin qytetin e flamurit në një kohë të...

- Lufta për pushtet nuk pret bashkërendime e ngjatjetime. Ne vetëm e çliruam atë dhe vazhduam sulmin e përgjithshëm. Marrshuam përtej Shkumbinit për të goditur për vdekje reaksionin në Veri e...

- Jugu kundër Veriut, - u shpejtua gjenerali
- Jugu-Veriun, Lindja-Perëndimin, - turfullova unë.
- Urdhërova Divizionin e parë të fillonte betejën në këto drejtime Brigada e parë t'i vërsulej Krujës, çerdhe e Legalitytit, të shpartallonte garnizonin gjerman dhe bandat e mercenarëve; Brigada e tretë yrysh e në Pezë për të goditur "shtatmadhorinë" e trimave të maleve e për ta penguar atë të delte nga vrima ku ishte futur; Brigada e katërt do të sulmonte Mirditën, t'u vinte flakën kullave në Orosh; Brigada e pestë t'i vërvitej me mizori Lumës e të shpartallonte bajraktarin e krejt Malësinë e Dukagjinit.
- Vendin e përfshiu lufta civile e ne.
- Ju rrinit e kundronit Por në fund do të mësonit prej meje se pushteti do delte nga gryka e pushkës e jo nga diplomacia juaj.
- Në pushtet do të gjindeshin dhe krerë të nacionalizmit nga dy parti të tjera, se ata e filluan të parët luftën kundër pushtuesit të huaj.
- Gabohesh, gjeneral! Ti po gjykon si një ushtar i thjeshtë Pushteti shtetëror më takonte mua,- u lavdërova unë.
- Më parë duhej plebishiti për formën e qeverimit, (kështu u vendos në Pezë dhe në Mukje, në mos gaboj emrat), po ashtu dhe Asambleja Kushtetuese për ligjin elektoral të zgjedhjeve parlamentare pluripartiake. Përse nuk i përfillet këto? - ziente ai nga përbrënda. - Ti shtrembërove faktet, fallsifikove historinë
- Ligjet u shkruan me barot e s'patën nevojë për kancelaritë e mykura të Evropës plakë Juve ju ka lënë lamtumirën memoria, posa harçoni vendimet e Kongresit të Përmetit.
- Kur është përbindëshë trupmadh, shtrydh në të

mëngjër e në të djathtë,- seç mëmëriti ai.

- Si the, se s'të dëgjova mirë?!

- M'u përfyturua një tragjedi angleze. Secili merr çmimin që lakmon. Ty nuk të trilloi lufta, por mizoria. Kush e fillon me gjak, do më gjak.

- I thotë aktori në tragjedi këto fjalë, hë, gjeneral? - e pyeta për ta vënë në provë.

- Po, po, janë të shkruara në tragjedi. të jesh i sigurt për këtë, - u përgjigj i penduar.

- I kam lexuar kur studjoja në Francë.

- Në Francë, kur dështoi revolucioni, Komuna e Parisit, fitoren e gëzoi diktatori.

- Gabimet e ...

- Të gjithë revolucionet kanë sjellë diktatoritë më të egra. Ravolucioni anglez i viteve 1600, revolucionet në Rusi e në vendet ballkanike përfunduan në duart e tiranëve të përçmuar.

- Revolucioni fillon me kryengritje të armatosura apo ...?

- Fillimi është i ndryshëm, por fundi i njëjtë. Atje ku grisët demokracia, ngjizet tirania. Ambicja për pushtet mendon gjithmonë për vete. Robëria e errësirës është nga më të rëndat, e padurueshme nga popujt. Drita e lirisë ushqen qytetërimin. Njerëzit ëndërrojnë përparimin dhe kanë luftuar për të në të gjitha kohërat. Pra, esenca e revolucionit, në të vërtetë, është një përlëshje tragjike e përherëshme vëllavrasëse. Ne donim t'u shpëtonim nga kjo luftë e t'u pajtonim me nacionalistët, - e përfundoi fjalën e tij.

- Zbarkimi i trupave tuaja në qershor '44 do të ishte një 7 prill i '39-tës, - e godita unë. S'pranoja asnjë ndërhyrje në punët e miqve në urdhërova që të pengohet zbritja e oficerëve të Unr-85 dhe mol për të shpëtuar nga rreziku anglo-

amerikan, që më kërcënonte mua.

- Po për minimin e kanalit të Korfuzit cili urdhëroi?
-më pyeti gjenerali i nxehur.

- Më urdhëroi mareshalli i Jugosllavisë

- Anijet e flotës sonë luftarake takuan fundin e detit. Pasojat kush i pagoi? - pyeti ai me ironi.

- Në fund të fundit, gjetët atë që kërkonit - iu përgjigja.

- Jo, se ne s'kërkonim fundin e detit. Anglia kishte synimet e saj, në Ballkan, prandaj u ndodhëm në vendin tuaj në ditët më fatale për ardhmërinë e atij gadishulli që ka qenë gjithnjë fuçi baroti.

- Fati i tij ndodhej në duar të sigurta, - ia prita unë.

- O tempora, o mores! - u shkreh ai dhe iku.

I juaji përherë.

VIII

Nga biseda me të vdekurin e vitit '53. S'munda të dekonspiroj shefin e proletariatit botëror

Nuk më ngacmonte kureshtja për të takuar njerëz të vdekur nga tanët të atij viti, se vdekja një fytyrë paska. As më kishte marrë malli për ndonjërin prej tyre, sepse nëpër këmbë i pata. Por doja të zbuloja nëse ndonjëri prej tyre kishte dëgjuar të thuhej ndonjë fjalë për mua nga Gjeneralisimi i Madh. Nëse i kishin thënë atij ato sharjet e përbuzjet e mia për të, kur rashë në kurthin e kryerevizionistit.

E kërkojnë, e gjejnë e ma sjellin. I bëj shenjë të më ndjekë pas. Ndalem te caku im e pa u përshëndetur e mbys me pyetje.

- Këtu llafazanët e paskan gjuhën të gjatë. Hë, folë, mo!

- Si urdhëron. Ç'të them? Më pyet ti, të përgjigjem unë.

- Ndonjë gojëzbërthyer a të ka treguar, ndoshta, si temë kalimtare thashethemet e atij viti?

- Nuk mbaj mend.

- Thellohu e kujtohu. A përmendej emri im ato netë?

I shtriva krahët mbi supet e tij kockanjarë e, pasi e shkunda si për ta përmendur nga gjumi i vdekjes, iu hakërova

- Hë, më thuaj, të qenkan mbërthyer nofullat! A flisnin për të? Po për mua?

- Po, fjalët morën skëterrën. Tanët, e të huajt dhe dishepujt e tij, ata që ia dinin jetën dhe veprën plot me mizorira, thoshin se sillej me dashamirësi, por ishte kulmi i hipokrizisë, mjeshtër i intrigave, më i përshtatshmi e më i përsosuri i lojës së prapaskenave që i mbyti në pellgje gjaku. E tregonin si tepër dinak sa antarët e byrosë ia quanin mençuri dhe urtësi gjithë dhelpërinë e tij.

- Po ti, mo, i beson këto trillime? - iu hakërrova përsëri.

- Edhe mbi babanë e revolucionit hidhnin baltë e s'e quanin "gjeni" ndër klasikët e as "figurë epokale" por një

- Mos më trego për të, se s'më intereson ai.

- Do më lejosh të të tregoj se çfarë kam dëgjuar këtu mbarë e prapë, apo, të ngrihem e të largohem dhe të të lë vetëm? - më tha ai si me druajtje.

- Paska ndryshuar, mo! Ti më rrije si pulë e lagur.

- Me vuajtjet paguajmë fajet që kryem. Ajo që na lehtëson këtu është liria e fjalës. Lermë të të flas.

- Fol, por jo për ata. Thuaj ç'ke dëgjuar për mua.

- Do të flas, se ishin veshur me shkëlqim dreqërit e gogolët e errësirës. Ky gjeniali ishte tepër i zakonshëm. Fillimisht qe kryetar i një grupi të parëndësishëm. Aty grindej e shahej me kundërshtarët e tij. Më pas drejtoi një revistë. Të ardhurat i fitonte me forma të pa denja. Pranonte lëmosha nga partitë e tjera e filantropët borgjezë. Thoshin se Revolucionit i Tetorit s'qe meritë e tij, por pasojë e prapambetjes dhe varfërisë së masave milionëshe që luftuan për të marrë ai pushtetin.

- Po pushteti është detyra imediate e çdo udhëheqësi të kryengritjes së armatosur. A i ke lexuar klasikët,

apo jo? Po t'i lëmë këto. Tani më trego ç'ke dëgjuar të ketë thënë për mua.

- Prit të mbaroj. Thoshin se ky babai i shtetit të parë proletar po paguante mëkatet para vdekjes. Në 18-tën e mori një plumb atentati. Në 19-tën i ra sëmundja e sifilizit. Në 20-tën u shtri në shtrat në një lëngatë të zgjatur. Më 21-in e 22-in u nda nga jeta politike. Në kapërcyellin e 23-it mbeti pezull në buzën e varrit me një tufë "amanete", të shkruara në letër me ngut dhe shkeleshko. Megjithse në shtratin mortor lëshonte shkresa e shkresa që kurrë nuk shkonin në duart e pasuesve të tij, se i gëlltiste ajo shporta gojëhapur e plehrave aty në zyrën e sekretarit të përgjithshëm. Atyre u mbeti kufoma e ballsamosur atje në mauzole, se pushtetin e gllabëroi shefi i ri.

- I di, mo, i di, bile para teje. S'më interesojnë tani. Fillo e më ...

- Prit! Ithtarët e tij tregonin se nuk luajti ndonjë rol me përparësi as në Shkurt e as në Tetor por, si panterë e uritur priti të vinte ajo që ai ëndërronte prej vitesh. Ky strategu, më kupton? Se po hyj në temë... Pas revolucionit u ngarkua përgjegjës në inspektoriatin punëtprofshatarak e më vonë në dikasterin e kombësive.

- Nuk më interesojnë këto tani, të thaç!

- Por, kur dinaku i pabesë e nuhati erën e vajit të kandilit që po tymoste, filloi të intrigonte për të arritur atje ku ëndërronte. Prandaj grumbulloi rreth vetes pasuesit e tij.

- Po "amanetet", - e pyeta duke e zënë ngushtë.

- "Amanetet", në të vërtetë u lexuan, por vetëm pasi kishte pushuar lufta për pushtet. Në maj '24 u mbledhka Plenumi i Jashtëzakonshëm. Në sallën e Kremlinit kishte rënë heshtja e varrit. Sekretari i përgjithshëm, i verdhur si gjethe e vjeshtës, ndalonte frymën. Po vendosej

fati i tij. Letra kishte brënda porosinë që ai të shkarkohej e të dërgohej larg e të shmangej me çdo kusht përçarja në Komitetin Qendror... Hej, pse u përkule! Po dremit ti? - më tundi për koke.

- E?! Vazhdo, të thaç, ndjehem i drobitur.

- Mbledhja vendosi që "amaneti", të mos lexohej në Kongresin që po afrohej.

- More lanet, ti sikur ke punuar shef kuadri në Komintern!

- Jo në Komintern, po në komitet, - ma ktheu.

- Mjaft më lodhe Tashti më thuaj, ç'tha ai për mua?

- Ki durim. - Do të të tregoj më parë fatin e familjes së tij.

- E di historinë, mo më mërzit me të.

- Unë kam 40 vjet këtu e ti dje erdhe. Dëgjo, dëgjo, se ndoshta të arratiset gjumi e s'të zë kurrë më. Ky shefi i proletariatit ishte martuar me të bijën e një punëtori të thjeshtë, për të dytën herë. Me këtë grua, të cilën thonë se nuk e deshte megjithse ishte e ndershme e me ndjenja të larta njerëzore, lindi një djalë e një vajzë. Këta asnjëherë nuk i shijuan përkëdhelitë prindërore. Djalin me gruan e parë ua la gjermanëve ta pushkatonin dhe nuk pranoi ta këmbente me një oficer të zënë rob. Kësaj gruaje, zemërbardhë e plot dhëmbshuri për njerëzit që e rrethonin, i rrëfeshin e i ankoheshin për të shoqin. Ajo, e padjallëzuar, këto "shpifje e trillime" ia tregonte në mbërëmje atij para se të flinin. E kupton, mo? - më tha.

- Kujt i thua mo? - e kundërshtova.

- Më shpëtoi fjala pa dashje. E kuptoni?

- Vazhdo, se këtë nuk ma pati treguar.

- Ç'të vazhdoj, mo. Kur e dëgjoji ajo se nga instruktorët e "akademisë industriale" kishte shpëtuar gjallë vetëm

një sekretar i organizatës bazë, frikacaku i Ukrainës, ajo u lemeris, u tmerrua, u shtri në shtratin bashkëshortor e nuk u përmend më përsëgjalli.

- E ç'ka këtu, more, për të kuptuar, se na çudite?! Ajo "akademi industriale" do të ketë qenë shkollë për kuadrot e partisë. Pedagogët, për mendimin tim, duheshin varur. Gruaja është thjesht viktimë e sentimentalizmit mikroborgjez.

- Këtë e rrëfejnë dhe dishepujt e tij.

- E mo, se na plase. Më kallzo se ç'thosh ai për mua kur zbriti?

- Ajo fytyrë e ngurtë, pa shprehje gëzimi, e vrrarëlije, ai trup mesatar më ecje kolovitëse përgjatë ditës nuk kryente asnjë lëvizje fizike (në çip të buzëve i rrinte varur çibuku i rëndë), në mbremje shtrohej me anëtarët dhe hante e pinte sa dehej. Ky njeri i pakulturë, i paditur, me horizont të ngushtë, moskokëçarës e mosmirënjohës ndaj askujt, më në fund zbriti këtu i dënuar për miliona të pafajshëm që lanë frymën nën sundimin e tij gjakatar.

- Këto më the, mo?

- Po ç'të themi? Këto dëgjova, këto i thashë.

- Për mua ndonjë kritikë a ndonjë vërejtje ...?

- Mos u shqetëso. Të premtën e djegieve vijnë të atij viti dhe i pyesim në kanë dëgjuar, se s'u përmbys bota për të.

- Do të dalim bashkë, mo?

- Jam betuar të të shërbejë gjer në vdekje. Fjala jote, vepra jonë!

U ndamë me shpresë se do të takoheshim. Kurdoherë më janë gjendur informatorë misterioz atje dhe këtu.

I juaji për herë.

X

Ne kërkim të shefit të proletariatit botëror

Dëshira është e papërmbajtur kur përtërihet si në vitet e kaluara të takimeve me të.

Në përputhje me kushtetutën e këtushme iu drejtova Këshillit të Djajve me një lutje, në trajtë jetëshkrimi, për të më lejuar të udhëtoja për në zonën lindore të ferrit. Këshilli rregullisht mblidhej çdo fundmuaji. Kërkesa ime më parë do të diskutohej në organizatën-bazë. Pasi të pyeteshin dhe instancat më të larta të kësaj hierarkie demoniane, lëshohej vendimi i miratuar nga kryetari. Fetishet e ferrit bëjnë ferk në të gjitha sferat e jetës si aty.

E lexova i ngazëllyer:

"Lejohet të largohet tri net nga periferia e rajonit". Kjo e drejtë këtu quhet një liri e rrallë, që stolis jetën e një të vdekuri në këtë mbretëri të nëndheut në zi, pa gëzim, pa lumturi.

Mendime të ndryshme shkrepëtinin në dollapin zgavër të mendjes. Kohë e largët të ndarë, tridhjetë vjet pa u parë!

Prita sa u lëshua shenja ngjyrë jeshile e lëvizjeve. Kur dëgjova pëshpëritje nëpër shtigjet kalimtare, atëherë u nisa përgjatë ferrit të zjarrtë.

Tek ëndërroja se do të takoja për së vdekuri atë njeri që e kisha adhuruar fort për së gjalli, këmbët, të cilat me përtesë i tërhiqja zvarrë, më dukej se nuk më preknin në truallin e përvëlur. Si fluturoja me një fije bari? Po dale një

herë! Dyshimi s'është mëkat. Ku po vija? Si do të më priste ai vallë? Para se të përdornim emrin e njëri-tjetrit përmëndnim një fjalë përpara... Po a kishim qenë ndonjëherë të tillë?

Lajmi se po udhëtoja drejt lindjes, gojë më gojë, e mbushi skëterrën mbarë. Tek shkelja nëpër gërmadha varrezash, më hakërroeshin si zotëronjës ata banorë të plakur në mundime. Unë s'mund të sprapsesha. Qëllimet s'më pranonin fre. Ata sikur nuk i ndjenin dhimbjet e tyre. Me mua donin të bënin gallatë. S'më bëhej vonë. Unë si një qenie-huxh i uritur për jetë njerëzish (huxhi sa më tepër ha, më tepër uri ka), isha shndrruar në antinjeri. Mua, sa herë më zgjonin zërat e natës, të nesërmen do të dëgjohej zëri i kukuvajkës. Një fjalë kundër, një kokë; shumë fjalë kundër, shumë koka. Medet që nuk më ka fjala atë oshëtimë! Vinte vendi era mish njeriu. I urreja të gjithë. Edhe ata që më rrethonin i përbuzja. S'dija t'i dalloja... dhe dukeshin barabarë si të mitë dhe të huajtë. I përzjeva miqtë me armiqtë.

O errësirë, bëhu më e dëndur që të mos më shohin tek udhëtoj! Drita ka sy, terri ka vesh. Lermëni! Kam rrugë të gjatë. Përpara. Po më kot. Forcat më shterën. Mushkëritë shtrydhnin frymën me ngathtësi. Zemra rrekëinte. Tek-tuk, gjymtyrët e shkrehën vrapin. Ulem të pushoj mbi një ledhishte. Fantazia më bridhte larg. Cili nga fjalimet e mia të panumërta dëshmonte për besnikërinë time ndaj shefit të proletariatit dhe për mbrojtjen e figurës së tij? Mu kujtuan disa rreshta të shkurtëra për nder të 100 vjetorit të lindjes së tij:

"O revolucionar", ju që sollët Tetorin e kuq (do ishte ndonjëri i gjallë?), ju përket juve të kremtoni këtë jubile në përkujtim të jetës e veprës së mësuesit të ndritur të proletarëve të të gjithë botës. Në të njëjtën ditë, ju takon

juve të çoheni e të shkatërroni regjimin diktatorial që po ndërton borgjezia e re me sllogane e mashtrime! Ajo po kamuflohet nën petkun e zhvillimeve të sotme. Ju nuk duhet të vonoheni për të reflektuar për fatin e së-ardhmes suaj e të njerëzimit. Ka ardhur koha të ngriheni si atëherë me strategun e madh, që me gjenialitetin e tij, ju çoi në revolucionin e kuq. Tashti nuk duhet të qëndroni nën zgjedhën e armiqve të vendeve të vogla.

Sovkozianë e kolkozianë, ushtarë e proletarë, bolshevikë të betejave kllasore, në fund të fundit ju kini përgjegjësi e detyra imediate ndaj lëvizjes komuniste punëtore! Këtë besim që kanë tek ju popujt përparimtarë, ju duhet patjetër ta plotësoni me nder duke ndërtuar me gjak një parti të tipit të ri.

O komunistë! Mos u shndërroni në vegla të social-imperialistëve që duan të pushtojnë me agresion shtetet e tjera, të voglat.

Unë, si nxënës i denjë i shefit të madh, në këtë jubile të lavdishëm ju drejtoj këtë thirrje: Të mendoheni mirë për këto probleme jetike, për të ardhmen e kllasës punëtore. Ne jemi shokë të armëve për çlirimin e njerëzimit mbarë nga skllavëria kapitaliste, por, ama, nëse ju përkrahni revizionizmin modern në varrosjen e të katër klasikëve të komunizmit shkencor dhe vraponi verbërisht pas qerres së krerëve renegatë, unë do të shkëmbehem me një kundërshtar të vendit tuaj sot e përgjithmonë. Prandaj me rastin e këtij jubileu, zhvishuni e zbrisni në fushën e betejave kllasore për të vendosur përsëri shtetin proletar.

Mbaj veshët përpjetë Mbreteronte heshtja. Të gjithë mëkatarët gërhinin rëndë. Mua m'u zgavërua goja dy-tri herë. Po më avitej gjumi. Nën kri-kriinë e një bulkthi, fjeta gjumin e vdekjes. Kallëzuesja e tij që ëndërra që pash

Unë ndodhesha i shkarrëzyer në qilimin e asaj ode ku më pranonte për herë. Ndërkohë gërvin dera. Ç'i ngjante ajo fytyrë e ata sy të qeshur, me bisht! Veshur ushtarak, me një kapellë, gjeneralisimi i gjallë. Doja të çohesha, por mbeta si një lopë e therur e përpëlitesha, sa s'më delte xhani. "Çou, - më ulëriti i zemëruar. - Kërkon të flesh, kur ne rrimë zgjuar?!" Ai zuri vend në skrivarinë e lartë prej kockash njeriu. Ndërkohë unë u ndodha përpara tij. Pasi mbushi çibukun e rëndë me duhan të grirë imët, vazhdoi flalën. Nga vërenjtja e vetullave të harkuara, tundja e mustaqeve zverdharake, lëvizja e gishtit tregues dhe goditja e tavolinës me grusht, e kuptova se po më qortonte e po më shante si ai. (Si më kish dalë nga mendja rusionjtja e bukur?!)

"Përse më akuzoni? - e pyeta i druajtur. - S'po t'i kuptoj fjalët?"

"A kishte raboçij kllas në vendin tënd? Sa e kalitur ndër beteja ishte ajo? Sa punove ti për ta përgatitur atë për kryengritje të armatosur? Tri pyetje të drejtova po dua vetëm një përgjigje", - më tha.

Zgjohem i tronditur. Këtu shtrigat fallxhore ëndërrat i shpjegojnë në të kundërtën. Si do të më trajtojë vallë? Se këtu s'përgënjeshtrohen të thënat e atyshme.

S'guxova të pyesja ferrtarët. Por sipas shenjave, brezi kufitar me piramida, me tela me gjëmba, dëshmonte se kisha shkelur në gjysmën e perimetrit të rrethit ku dergjeshin të dënuarit e lindjes. Sapo shtriva këmbën e mëngjër mbi kalldrëmin e shtruar, dera e ndarjes muranë u mbyll prej së larti. Filloi të bridhte rreth meje një stuhi dredharake. Qielli gjëmonte e shkrepnte pa prerë. Kozmosi u elektrizua. Retë shkarkonin xixa të zjarrta.

Një alarm gatishmërie i vërtetë përpara tokës lindo-

re. Erdhën dy roje. Më lidhën e më strehuan në karakoll. Këtë pengim nuk e ka krijuar natyra, se do të kishte dy vargmale si Andet; as dora e njeriut që ka ndërtuar mure si ai i Kinës, por vetëm ne, ideollogët e ndamë lindjen me perëndimin. Këtu kundërzbulimi qënka më i zhdërvjellët se spiunazhi ynë, se të nesërmen kur më liruan për të vazhduar udhën, mua më kishin rrethuar të gënjerit e penduar të këtyre anëve. Po ecja kuturu, si kisha ecur në jetë, se nuk doja të tregoja se kë kërkjoja. Por ata e dinin e po më drejtonin në shtigje të tërthorta për tek ai. Turma formoi me nxitim një gjerdan rreth meje. Valltarët, duke dredhur valle, ndërtonin një stivë me dru e shkarpa.

Korifeti:

*Do të flakërojë flaka përmbi dru,
flaka përbi dru.
Mjerë ai që përfundon këtu,
që përfundon këtu!*

Këngëtari:

*Tek ky varr dritëshuar,
varr dritëshuar,
Një bukëshkelës është betuar,
është betuar.*

Kori:

*Zgjohu, zgjohu o kryetiran,
o kryetiran!
Një vasal të erdhi pranë,
të erdhi pranë.*

Këngëtari:

*Për t'u takuar me ty po vjen,
për ty po vjen,
Por mos e beso, se të gënjen,
se të gënjen.*

Korifeu:

*Do të flakërojë flaka përmbi dru,
flaka përmbi dru.*

*Mjerë ai që përfundon këtu,
përfundon këtu.*

Mua më sulmuan papandehur. Por, kur më përfshinë të më vërvisnin mbi zjarrin gjuhëlubi, ndërhyri skuadra e shtrigave dhe i shpërndau. Ata zemërthyer u larguan.

Djali, mbikqyrësi im në këtë hemisferë, si brirët e kuq edhe veshjen laramane, i kishte më të vetëtitura nga tanët.

Më afrohet dhe më thotë:

"Ligji ndërfejtore e lejon djegien e një të vdekuri edhe jashtë zonës së tij, kur ai nuk ka varr e nder as të të shumtët e ligj. Por ne kemi urdhër nga Fronti të të mbrojmë. Arsyjeja-enigmë".

Më ndaluan në një karakoll. Të tillë ka kudo se në të vërtetë skëterra është një burg i shpërndarë gjithandej.

Në udhëtim e sipër ju dërgoj përsëritje revolucionare.

I juaji kurdoherë.

X

Gjeneralisimi një deviator e kapitullant

Të nesërmen më lejuan të qarkulloja nëpër kampin lindor. Skuadra shtrigane, në fshehuri, rrinte në gatishmëri. Jetimët e ferrit më vërenin me kureshtje tek ecja në atë truall të zhuritur prej zjarreve dënimore pa ndërje dhimbje për ta. Zemërguri zemërgur mbetet. Ja, më në fund, para meje, nja njëzet a tridhjet hapa më tej, më fanepset silueta e një njeriu të lidhur me vargoj tërthorazi, kaluar te një gurëvarri i lartë, veçuar nga të tjerët.

Cili dergjet aty sa vjet i vetmuar?!... Fërkoj sytë. Se me kë më shëmbëllente. Balsami s'binte më erë, era shkru mb jo. I djegur po i pa shkrehur.

Bëj çapa t'i afrohem...

- Ku shkon? Lolo! Nuk preken të vdekurit e dënuar!

Ishte roja i veshur me pushtet që më pengoi.

- Lëre le ta prekë, - ndërhyri nga lart djalli, shoqëruesi im. - Shko takoje e fol me të, - m'u drejtua mua.

- Ndal po të them! Kthehu prapa! - më urdhëroi roja.

- Dëgjo, more roje,- ky i vdekshëm është në besën time,lëre të lirë... Shko e bisedo,- më tha.

Një ndër hallkat e pavdekësisë sime ka qenë dhe mbetet ai. Prandaj dua ta takoj domosdo, i detyrohem atij për gjithçka që më mësoi. Do t'i therres të zgjohet. Ka fjetur e do flerë sa të harrohet. Ndjenjat për teka dhe eroti-

kë më kishin shterur, por jo ethet e etjes për lavdi.

Eca ngadalë sikur doja t'i numëroja hapat në ishin më tepër. Një njeri i afërt përse më dukej i largët? ... Ç'po ndodhte? ... - Do ta prek. Le të zgjohet. S'e kam më frikë. Mjaft kam jetuar i përlur para tij sa as para tim eti. Ia dija thakmat që kishte bërë. Ai e urdhëroi Informbyronë të mos e njihte partinë tonë e mua të mos më pranonte si sekretar të përgjithshëm të saj. Ky plak matuf ndërthuri plane djallëzore për t'i kaluar rolin tim sllavëve të jugut. Këto intriga të tij i zbrazti pa dashur "ambasadori shetitës". - Këto bluaja në mendje në ato çaste. Do t'i thërras të zgjohet, dua të di ç'përshtypje ka për mua, i thashë vetes.

Të... Të... Të varish gjeneralisimi, milli moja! - bel-bëzova dy tri herë. Iu afrova më pranë. Spaletat mbi kapotën ushtarake qenë mbuluar nga pluhuri i furtunave të nëndheut. Sytë s'i qeshnin më. Buzët preheshin në heshtje. Në fytyrën e vjetëruar brazda të thella kaskore ishin përviuar. Flokët i ishin thinjur e rralluar. Mustaqet varur si hala thekrrë.

- Të... të... tëvarish, shef i proletariatit botëror! Kam ardhur unë. Aha, paska rënë në gjumin vdekjeshuar!

E shtrëngova atje ku fillon dora për t'i ndjerë zemrën. I regëtinte. I tunda krahun si për ta përshëndetur. Ai ngriti pak vetullën e mëngjër, picërroi sytë e më pa i habitur.

- Zdrasvuitje! - i fola për t'i vërtetuar se ndonjë gjuhë tjetër dhe do ta harroja, por rusishten e rrjedhshme kurrë. - Jam unë. A më mban mend?... Përmendu të shkëmbejmë mendime si dikur në Kremlin.

- Ç'kishe për të më thënë, m'i ke thënë, s'kanë mbetur për këtu.

- Ja të të rrëfej se si e mbrojta figurën tënde të lav-

dishme nga katërmbëdhjetë shtetet dhe e bëra tempull ku të merrnin dritë popujt.

Nga brendësia e kraharorit-zgavër, fërshëlleu një frymë ererëndë. Trokitja qe rekëtima e një zemre të plakur. Qepallat të ngjitura prej djersës së mundimeve dhe lotëve të dhimbjeve, ia çelën shikimin vetëm kur u shkëputën nga kalbja e-moteve.

Më njohu. T'i kishin thënë një gjëmë të madhe për Rusinë a Gjeorgjinë e tij apo për krejt gjithësinë, ai nuk do të tronditej më tepër se sa kur u bind se isha unë.

- Edhe këtu më shqetëson, o ngatërrestar me damkë?! Paturpësia jote s'paska anë e fund... M'i kanë thënë... - Më foli me një dialekt rus të tijin.

- Unë erdha të të rrëfej se si të kam mbrojtur nga 81 parti e nga....

- Gënjeshtar i lindur për mashtrime, - më ndërpreu. Ti një i vetëm s'mundeshe të kundërgodisje ata korifej apo atë falangë dishepujsh të cilët u turrën të më shanin e të më poshtëronin mua.

- O strateg i kohërave revolucionare, kur vdiqe ti, mua më shpëtuan lotët për gjëmën e madhe. Ky është një fakt, tjetër. I dyti...

- S'më hyjnë në punë lotët e krokodilit, - ma ktheu me mospërfillje.

- Po prit se s'qe vdekje si gjithë vdekjet. Sa e papritur e sa tragjike! - e ngacmova unë.

- Pse çfarë di ti për fatin tim? - pyeti me kureshtje.

- A do të të kallëzoj?

- Fol, se po të dëgjoj.

- Zhvillimi i kompleteve e ndodhirat në prapaskenat gjatë viteve '50 më lanë të kuptoja se të helmuan mjekët. A të bie ndër mend procesi gjyqësor i "bluzave të bardha"?

Ai e ngriti me ngathtësi dorën. Me gishtin tregues sikur donte të gërmonte në tëmth të kokës së thatë si me turjelë druri nga ato që përdornin zdrukthtarët që ta çponte kujtesën tej e përtej.

Nuk më pëlqente kjo heshtje e gjatë. Kuptova se në grackën e tij, të ngrehur me mjeshtëri të rrallë, kisha rënë kokë e këmbë.

A, more i djallëzuar, që vjen të më brengosësh me këto trillime! Në se mua më paskan zhdukur njerëzit që më rrethonin, atëherë ç'vlerë i mbetej figurës sime për ty? Kështu del e vërteta lakuriqe se ti e lavdëroje jetën dhe veprën time për të xhingërisur jetën dhe veprën tënde. Posa unë kam tridhjetë vjet i djegur, si qëndronin gjallë shtatoret e mia nëpër sheshet e vendit tënd?! Më mirë më fol për krimet e tua të cilat m'i ngarkonin mua, - m'u shkarkua ai.

M'u tha gjuha në gojë dhe nuk dija si t'i përgjigjesha.

- Kauza e përbashkët duhet të rronte dhe pas vdekjes tënde, - i thashë.

Ai, pasi shpërndau mustaqet e dëndura, verdhur prej tymit të duhanit, më tha:

- Qysh në takimin e parë e pikasa ndërgjegjen tënde të dërrit, e cila kujdesej vetëm për tulet e veta e mos m'i shit mua ato dëngla. Ti gjatë tërë veprimtarisë "revolucionare" ke punuar për "kauzën" tënde.

- Përse m'i thua këto fjalë?! - u ankova unë.

Ai si të kishte rrëkëllyer një bardhak vodkë, filloi ta lëvronte mirë rusishten zyrtare, ndërsa unë që i lajthita më të shumtat e atyre të paktave fjalë që thashë, s'po e merrja vesh se ç'më thoshte.

- A të kujtohet vizita e vitit 1951? E mban mend kur të pyeta se çfarë bëtë me ato dy qese farë misri gjeorgji-

ian që t'i kisha dhuruar dy vjet më parë? Ti nuk m'u përgjigje e nuk më pe drejt në sy. Ule kokën , se nuk dije në u mbollën apo u hodhën.

- Nuk mbaj mënd , - u shfaqësova.

- Por kur krerët e Kremlinit më akuzonin botërisht për egërsinë, dinakërinë, pabesinë, poshtërsinë, terrorin, vrasjet, burgjet, kampet e shfarosjes masive, ty përse të dilte shkumë e bardhë e deklaroje se të kisha lënë kujtime të pashlyeshme, këshilla të vlefshme, porosi të mëdha, të cilat i ke shkruar në librin "Me mua për jetë"? Cili është pikësynimi yt?

- E patëm problemin te qeskat e misrit? - ndërhyra për ta shastisur.

- A, po. E nëse misri gjeorgjian do t'i përshtatej kushteve klimatike tokësore të vendit tuaj, ai do të prodhonte sa në fshatra të mos vuante njeri prej urie e të tepronte për qytetet..., do t'ju binte begatinë sociale. Apo jo?

- S'mbaj mend, - u shfajësova prapë unë.

- Millij moja! O bijt e mi që vini të më takoni, i njëjti dënim ju pret. Përse më lëndoni plagët e hekurave?! - Klithi dhe vari kokën e zbrasur. E mundi gjumi, drobitur nga biseda e zvarritur.

Mua m'u zvordh prej asaj tronditjeje.

Elementet e dhimbjes rrinë pezull mbi ne e zbresin në këtë moçalishte posa ndizen zjarret e para. Thirrjet e ulurimat e mëkatarëve të dënuar i shtien drithërima zefirit frymëlehtë. S'munda të largohesha prej tij, se ngjashmëria qëndronte e pazgjidhur ende. Lidhja e rrënjëve vaditur me gjak qenka më e qëndrueshme se kjo e fisit apo e fatit.

Këtu do të fle, - thashë. Shpërndava eshtrurinat e vjetëruara andej-ketej. Një kafkë vura nën kokë. Më vjen të

çmëndem me këtë plak matuf. Më përmëndka farën e gjeorgjianit si magjinë e begatisë dhe harron se varfanjakët formojnë shtresën e të nënshtruarve. Mua nuk më duhej fara, por fronti. Cilët janë elmazet, inxhitë, dhe xhevahirët që e stolisin atë? Pa zhvishe atë prej intrigave, vrasjeve, varjeve, burgjeve, nga komplotet, terrori, tmërri, lemeria, uria; Ç'mbetet? Ç'i mbeti frontit të tij? Ç'do t'i mbetet frontit tim?

Ky u ngrit i madhërishëm si shef i proletariatit botëror e tashti kapitullon para akuzave të thjeshta, të kota. Këtij i paska shteruar pasuria dialektike e materies trunore.

Duhet të flas përsëri me të. Do t'i mbush mëndjen se si dikur Romën e shpëtuan patat, ne popujt. Po kapitulluam ne, edhe ata. Po fundi turma njerëzish janë popujt, proletariati, kllasa jonë punëtore, fshatarësia jonë kooperativiste, gratë heroike, rinia revolucionare, organizatat me grupimet femnore do të më kenë vetëm mua pas tijë. Më duhet pavdekësia me çdo kusht.

Këtë mendim mbi të ardhmen e lëvizjes komuniste, ma këputi në mes fërshëllima e rojes së veshur me pushtet, që përzuri dy a tre bredharakë nate. Këta të zdërhalur s'e di se ç'lezet kanë të rrinë pranë meje.

Nën firomën gulçimtare të tij kaloi kjo natë vjeshte pa fjetur.

Udhë e gjatë e dredhuar

I juaji kurdoherë i paharruar.

XI

Shefi i përgjithshëm donte harrim të përjetshëm

Tringëllimi i zileve të djajve që kapërcyen revan mbi mua, më lajmëroi se lejohej lëvizja e të dënuarëve.

Mugëtira ndante natën e errët nga dita e murme. Nuk po dalloja më nese ai tundte kokën e sflitur, apo koka ime e rëndë rrëshkiste nga kafka. Si t'i jepja të kuptonte se po e prisja zgjimin e tij si një fajtor që pret në qelinë e burgut dënimin me varje në trekëmbësh?!

U çova përgjysmë. Isha i vetëdijshëm se ajo armatë që valëviste flamujt e kuq, ishte zvjerdhur e ishte venitur përgjithmonë. Por doja të ndahesha me të prapë si mik, se ai zemërak, kur tërbohej, të urrente për vdekje. Ishte tmerrësisht i tmerrshëm.

Ndërkohë u ngrita. Ai ktheu kokën e shtangu.

-Të ... tëvarish, millij moj, unë po nisem.

- Këtu qënke ti kodosh fjalaman?

Duke mbajtur shpresë se herë-herë ai sillej si babaxhan, doja të vazhdoja bisedën. Le të më shante, mjaftonte ta zbusja më në fund atë egërsirë.

Ai iu lut rojes ta zgjihte nga gurvarri, shtrati i tij i pamortshëm. Zinxhirët e ndryshkur prej avujve të nxehtë e penguan të ectë kur i ranë te këmbët. Shefi i proletariatit i kërrusur, zgjati dorën e më caktoi vendin. Vetë u ul përballë meje. Dy frona të ngurtë, pjesë e shkëmbenjve të thërmuar nën dhe, të veshur me vellon e gjelbër të lëmyshkut, qëndisur me

pafta likiene të përhimta, rrinin përkundruall natyrshëm, ndërsa ne, pjellë e revolucionit, vëngër njëri-tjetrit e vëreni, si dy armiq të betuar. Sot dukej më hijerëndë, se rrudhat e ballit, presa e kohës brazdare, i a kishte thelluar.

Doktrina, ideatori i saj dhe nxënësi i tij. E dija se do më godiste atje ku priteshe, por doja ta provoja shansin. Dashuria ime s'e ka njohur dhimbjen as në ndarjen e më të afërmve.

I pari foli ai.

- Ç'djall të solli deri këtu?

- Djalli im më pruri te ty. Përse më pyet?

- E di se yti, po përse të solli tek unë?

- Desha të të rrëfeja se si rrodhën punët pas vdekjes

sate.

-Dreq o djall! Po ç'më duhen ngjarjet e atjeshme tani?!

Mua më kthyen në hi e pluhur së bashku me famën, lavdinë, intrigat, brengat, mendjen, zemrën e ballsamosur. Më mbeti vetëm shpirti që po dergjet këtu tek kjo pllakë varri, e sendërtuar me mallkimet e miliona frymëve të pafajshme.

Ti ç'do prej meje tashti?

- Unë megjithëse i vetëm ...

- Këtu më lind dyshimi, se porsa mua trupin ma dogjën të mitë e shpirtin ma vërvitën në skëterrë, atëherë si e sa teproi edhe për një të vetëm siç ishe ti?

- Tepruan kolkozet dhe zovkozet, - e trillova përgjigjen.

- Të pata porositur. Çdo vend ka kushtet e veta dalluese. Ndërtimi i socializmit nuk është një mbrëmje vallëzimi. A e kupton? Ai është luftë për jetë a vdekje. Receta lëshon mjeku e jo unë. Prandaj të mos i bashkoje fshatrat. Katundarët marrin pjesë në kryengritjen e armatosur, por ata kanë frikë nga komunizmi, se ai u shtetëzon çdo pasuri veç sh-

pirtit. Miliona dhanë frymën në stepa.

- Ose lufta jote me deviatorët .. - u përpoqa të arsyetohesha.

- Shkëndia e atij zjarri, kur u dogjën të gjithë ata të gardës së vjetër, nuk qeshë unë, por "babai" i revolucionit...

Të shtënat e Aurorës i përshëndetën gjeneralë e ushtarë, ideologë e mendimtarë, por secili ëndërronte të zbatonte modelin e tij të socializmit. Mua ai s'më përfillte në ato punëra. "Gjeniali" bënte emër më 18-tën. Pasi shpërndau parlamentin, pushtetin ia kaloi komisarëve dhe këshillave. Shteti ishte ai. U krijuan rrymat. Ai, kur iku, më la armiqtë e "amanetet". Unë zbatova "amanetet" për të luftuar armiqtë, në rrethanat që u krijuan. Ti nuk kishe "amanete" për të lexuar. Letrat që përdornin "dishepujt" e tu, të orientonin kë të godisje e ku të shpartalloje.

- Si the, se s'të kuptova?

- Panjimajet, harasho. Mua më kanë thënë shokët e tu, kur vinin tek unë.

- E pranoj. Unë a duhej të dija gjithshka? Partia mbi të gjitha. Ata përse nuk m'i thoshin mua drejtpërdrejt, por i shkruanin njëri-tjetrit mendimet e tyre?

Ai uli kokën dhe qeshi duke bëlëzuar.

- Doje të zbuloje komplotet? E?!

- Mua kudo e kurdoherë më ndërthurnin komplotë. Më lajmëronin të besuarit e mi, pa i zbuloja tradhtarët e çështjes sime.

- Do të shpjegoj origjinën dhe natyrën e tyre, si e kuptoj unë tashti, edhe synimet e mizantropëve tanë që, në të vërtetë, ishin lakmitarë të etur, xhelozët e postit. Secili përpiqej të arrinte vende sa më të larta në hierarkinë time duke shtytur shoku-shokun në greminë. Edhe kur i akuzoja për tradhti të lartë, ata pranonin me ndershmëri fajësinë e shkonin

në vendin e pushkatimit sikur dilnin për një shëtitje të shkurtër, pa përtuar. Këta ishin nga garda e bolshevikëve, gjeneralë, oficerë, komandantë e komisarë që tregoheshin të gatshëm të dëshmonin pjesëmarrjen e tyre në komplete dhe vetëakuzoheshin si armiq të partisë e të popullit. Në të vërtetë këta të vetpaditur qenë të dërrmuar e të torturuar, qenë degraduar shpirtërisht dhe të droguar mendërisht. Ato, gjyqet e panumërta kundër antipartiakëve, dëshmojnë përmasat marramendëse që kishte komploti i madh kundër meje, kuptohet e kundër teje, për të na përmbysur fronin. Uzurpatorët rrëzonin njëri-tjetrin e s'është e vërtetë se revolucioni ushqehet me bijtë e vetë. Ata hanin vetëveten nga lakmia për pushtet, jo për triumfin e tij. Se cilët ishin ata, ti i di. Ata ishin njerëzit tanë më të afërt, si kishim qenë ne për të tjerët, jo borgjezët e as të huajt, se s'u përzjenë në punët tona të brendshme asnjëherë.

Ai duke u mbështetur mbi shkëmb, u ngrit në këmbë. Unë nuk po gjeja forca, sikur kockat të më ishin ngulur në gurë.

- Këtë të vërtetë mos ua thuaj të tjerëve, - i thashë - se merr fjala dhenë.

- Ne, të katër klasikët, jemi shtruar për zbavitje në bashkëbisedime. Dy të parët na kanë qortuar terrorin që është ushtruar në emër të revolucionit e të luftës së klasave. Ata thanë se ndërlikimi i formave të terrorit me ato të shtypjes, nga të dy, ua kalonte mizorive më të dhimbshme, nga kohërat më barbare e deri në ditët tona. Mishërimi i kultit të individit në zbatimin e ligjit në një shtet të diktaturës së proletariatit, ishte sekreti i pazbuluar për vegjëlinë. Ne e quanim "vija e masave".

Pasi i pushoi gulçima uturimtare, mbushi çibukun, e ndezi dhe më ktheu shpinën e kërrusur.

- Gjeneralisim, po iki i dëshpëruar, por do të vij tjetër

herë të flasim shtruar.

- Paçjemu? Njet! Njet! - u përgjigj e u nis për te pllaka e varrit të tij të vetmuar.

Unë doja ta urreja atë plak të shushatur që kishte kapitulluar e kërkonte harrim, por s'më lejohej, se shpirtrat tanë zjenin në një ingjir. Udhëtim i kotë deri në skaj të skëterrës ku nderte dreqi brekët. Atij i ishte zhgarravitur etja për lavdi, por jo mua. Pa atë për mua më mirë. Sa për kohën e humbur dhe për qortimet e tij as më bëhet vonë. Atij, tek e fundit, i është neveritur pavdekësia, se të tijët ia gremisën truporet, ju m'i ngritët. Ashtu, ju lumtë! Megjithatë aty truporet e tij mo i prekni. Bukë a u kërkojnë? Le të jenë atje ku janë!

Dëgjomëni! Mbillmëni në buste e bunkerë, se mbij. Kjo quhet pavdekësi. Në ma përmbushni këtë amanet, hallall qumështin që keni pirë nga gjitë e nënës ...Parti!

I juaji me shpirt e zemër.

Më pafshi përherë në ëndërr.

XII

Takim "inkonjito" me të dërguarin e mareshallit

Kini përpara ato fletë historike të shkëputura nga një kapitull i tërë ku shtjellohen konturet e përpjekjeve të mia të ashpra e dramatike për të dalë fitimtar në fillim me krerët e grupeve, me rivalët e pushtetit, më pas kundër "miqve" të ftuar, më në fund i mbetur vetëm kundër të gjithëve.

E për ç'tu shkruaj më parë, mo! Janë ca allasoj figurash që më vërdallosen në zgavrën e kafkës:

Një malazes, i cili, u dërgua me shërbim për të na ngarkuar neve detyrën të lironim nga burgu një serb (kuadër udhëheqës i tyre). Një element tjetër, anëtar i K.Q, i cili solli në dhjetor të vitit '42 direktivat e Internacionales Komuniste dhe të "falat" e plakut nga Moska. Me "ambasadorin shëtitës" të mareshallit (i cili m'u bë burri i nënës), i ardhur në mars të vitit '43 me një tufë plane nën sjetull ku projektoheshin "Shtabi" dhe "Federata Ballkanike". Një "ekip" i kolonelit, shef i misionit të tyre ushtarak, dhe me të ndihmësi i tij. Njëri erdhi në verë, tjetri në vjeshtë të vitit '44, me synime të paramenduara, tepër armiqësore për mua. Me agjentë e diversionistë të panumërt, të cilëve, për një nënligj të këtushëm, pengohem t'u përmënd emrat, të gjithë elementë të rrezikshëm që do të më turbullonin një ditë ujrat. Ata, me poza "strategu" hijerëndë, "seriozë" "të mëdhenj" e "mendimtarë", më ndërhyjnë në çështjet parimore e në vijën time ideologjike të sprovuar në luftë me të mijtë. Me këta "instruktorë" të mareshallit u përlesha vend më vend, në

prapaskenë të '44-ës e gjer më vonë. Më fatthëna qe përplasja e parë me të mitë në grindjen për pushtet. Atëherë mua më duhej të kafshoja në të mëngjër e në të djathtë për të shpartalluar grupazhet e komplotet që ndërthureshin kundër meje. Pushteti më takonte mua dhe askujt tjetër.

I vdekur jam, por prapë kam frikë.

Dëgjoj të trokitura... dikush hyn...

Po ky përse vjen? Ç'kërkon të mësojë prej meje tani?!

Më ra shorti të vij tek ti - dha shpjëgim i sapoardhuri.

- S'keni ardhur ndonjëherë me short tek unë, or mik i vjetër. Shkonim e vinim...

- Më dërgoi mareshalli për të pyetur lidhur me...

- S'i jam trëmbur ndonjëherë atij as atëherë, sepse ne i ndamë ç'kishim për të ndarë, e i shkruam ç'kishim për të shkruar për njëri-tjetrin.

Ai po kridhej në të thella. Unë kërkoja në dollap të mendjes në mund të gjeja shkakun e ardhjes së tij të papritur. Për ç'do të më pyeste vallë? ndoshta do më më ngarkonte vrasjen e kuadrit udhëheqës të krahinës? Në s'kishim dijeni për atë atentat. Atë e vranë atje, nën hundën e tyre.

Binjaku im ishte sigurimi i fshehtë, lindur në një natë, sy-zgjuar në një shtrat. Por vrasja e tij është për mua një enigmë edhe sot.

Të flisja unë më parë? Jo. Ç' më duhej? Mirëpo ai s'kishte ndër mend të fliste. S'mund të prisja më gjatë.

- Mos mareshalli do të mësojë në di unë se kush e vrau kuadrin e shenjtë? Atë e vratë ju tek kapërcente kufirin!

- Ne?! Përse ne?! - ndërhyri ai i nervozuar.

- S'pajtohej me veprimtarinë tuaj, më përsëriste shpesh:

- "Kombësitë kanë të drejtën e vetvendosjes për fatet e tyre."

- Mos fol në tym. Ai vetë tregon se, pasi u kthye në krahinë tek shkruante në tryezë, e goditën në befasi me tre

plumba.

- Atëherë, më thuaj, përse më kërkon ai mua? Ç'do të më pyesë?

- Ti, po të dish t'i çmosh vlerat tona në paracaktimin e fatit tënd, s'duhet të çuditesh përse të kërkon mareshalli në takim.

- S'është e vërtetë që fati im që dora juaj. Atë e themelova unë dhe mua më përkiste e gjithë ajo lavdi dhe ajo parti.

- A të kujtohet veprimtaria jonë në ato vite të stuhishme të luftës? - Ndërhyri ai me takt. - Ne të premtuam drejtimin e partisë, ndërsa ti krahinën.

- S'më kujtohen, se këto janë vogëlsira, - iu përgjigja ftohtë.

- Një ditë e shënuar si ajo nuk t'u kujtuaka?!

- Më kujtohet, xhanëm, por nuk i mbaj mend gjërat një për një. Megjithëkëtë, ç'na duhen tani? Ato i kemi kapërcyer, - i thashë me gjysmëzëri.

- Do t'i kujtoj unë, - u lavdërua ai si e kishte zakon. - Ne të dy dhe ti tre mbërritëm të parët në vendin e caktuar për mbledhjen. Ti tepër i tronditur na u përgjërave që të formonim më parë partinë e më pas të lejoheshin përfaqësuesit e grupeve të proklamuarin platformën e tyre. Ne e dinim se, duke përkëdhelur ambicjen tënde, shkeleshin parimet. Mirëpo përfitimet e këtyre lëshimeve na zhytën në ingjirin dredharak të intrigës së përbashkët. Ti, për të mënjanuar kryetarin e përfaqësuesve të grupit në të cilin bëje pjesë, ngarkove për të drejtuar punimet atë farkëtarin. Ai, i porositur prej teje, s'pranoi por të propozoi ty. Zhurma dëgjohet më mirë në heshtje. A më kupton?

- Të kuptoj. Ju heshtët, por dhe unë heshta. Ç'kërkon tani mareshalli prej meje?

- Dale! Po kur u zbulua "teknika" e trakteve, a dolën

emrat tanë aty? A të kujtohet alarmi i gazetave ato ditë të rrezikshme? Në grupet tuaja ideatorët ishin intelektualë të përgatitur. Ata vepronin me përkushtim nën dritën e udhëzimeve të Kongresit të 7-të të Kominternit. A e përmbysen qeverinë në qershor të '24-ës?

- E mo, lërmë tashti, e pranoj. Më fol për mareshallin.

- Ai do të dijë përse e shkrove librin kundër tij? - më thirri në rrëzë të veshit dhe u largua pa më ngjatjetuar. Kuptohet, biseda mbeti e hapur...

Në të vërtetë udhëzimet dhe orientimet, vërejtjet dhe këshillimet e mareshallit për ne ishin të pagabuara sepse, në gjëndjen tonë kaotike të krijuar nga padituria ime, ato na tregonin kjartë veprimet për të ardhmen e përbashkët. Unë isha i bindur se sukseset apo dështimet e mia lidheshin pazgjydhmërisht me praninë e serbit dhe të malazezit, të parët që shkelën tek ne, sepse për çdo parim ata do të pyeteshin patjetër.

Byro nuk kishim. Ishin ata të dy. Komitet Qëndror s'patëm ngritur. Prapë ata të dy. I pari s'i përfillte fare kuadrot tona. Fillova dhe unë të mos i përfill si ai. Çdo thënie e tyre ishte ligj e do të vihej në jetën e brendshme të partisë. Më dërgonte një letër nga Peza: lajmëro filanin e filanin dhe eja këtu, se do të bëjmë konferencë. Në të vërtetë nga ajo konferencë doli vetëm një trakt...

Më vonë u zhvillua konferenca e "Vendit". Ne ende nuk dinim strukturën e forumeve të partisë: ç'ishte komiteti qëndror, çdo të thoshte plenum, ç'ishin anëtarët e kandidatët e tij. Na gjeti si në Pezë. U hëngrëm për referatin... S'mbaj mend kush e lëçiti... Këto i përkasin të kaluarës...

Tashti cilin vallë do të dërgojë mareshalli? Ta di se vjen tjetri, biseda do të rrjedhë shtruar, sepse do të kuptohemi me të si dikur. Besimi që kishte ai në veten e tij, ia bleva edhe

unë. Ai i merrte fenomenet në sipërfaqe. Po ashtu edhe unë. Ndërsa fitova dashurinë e tij, humba besimin tek shokët e mi. Por nuk më bëhej vonë për të mitë.

Po sikur të vinte ideatori i "federatës ballkanike"? Ç'më mbytën kujtimet! Kur mbërriti ky tek ne, mua m'u duk se vinte PKJ. Sepse, pa dyshim, ai vinte me një letër të shkruar nga dora e mareshallit vetë. Ato ditë zgjodhëm KQ dhe Byronë. Mua më caktuan sekretar politik. Më përfytyrohet si tani: ata të dy, serbi dhe malazezi e njëra nga tonat, në një mbledhje më parë, më kishin propozuar mua. Kjo gjë më ra si nga qielli, u tregova se gjoja nuk e bëja dot e se, për më tepër, s'kisha punuar më tepër se ata, të tjerët.

Vjen radha e formimit të shtabit. Dhe kjo u bë sikundër të tjerat. Unë u emërova komisar (megjithëse nuk e kisha kryer shërbimin ushtarak). Në atë mbledhje unë dhe "intelektuali" ynë thamë nja katër a pesë fjalë dhe dakort.

Kur u takuam për herë të dytë në Gur-Kucak me të "dërguarin" e mareshallit, ata shtruan çështjen e nacionalistëve dhe qëndrimin që duhej të mbanim ndaj tyre. E kam fjalën për mbledhjen në Mukje, që unë e mora për një ballafaqim formal, ku do të vinim t'i thoshim të katër të vërtetat në fytyrë Ballit Kombëtar dhe t'i laja duart për veprimet që do të kryeja më vonë për të shtirë në dorë pushtetin shtetëror.

Po fluturoja në ëndërrime. Mendimin e mëparshëm për nacionalizmin e përplasa prapë. Më gudulisnin të tjera tundime. Ndërgjegjja dëgjonte të tjera zëra të brëndshëm. Atje më s'shikoja vlera për fatet e Kombit, por si ta dënoja doktorin për oportunizëm.

Në këtë polemikë me "misionarët" nuk më duhej ardhja e asnjërit. Por sikurse thashë, ajo mbeti e hapur...

Po pres se kë do të dërgojë mareshalli.

I juaji përherë.

XIII

Mareshalli i shqetësuar ka dërguar të gjithë "ekipin" e tij

Dihet se natyra është nëna e të gjithave, por nuk ndërtuaka njësoj të gjitha, sepse këtu ka frymorë dhjetra e dhjetra vjet të vdekur dhe ende nuk janë tretur. Atyre nuk u ka lëvizur një rruazë, megjithëse bredhin bythën e dreqit. Tërë natën janë mbi majë të këmbëve, ndërsa mua qysh në vitet e para më lëviznin eshtrat tëmthore. Nga këto plasaritje mua më derdeshin mendimet tek shkoja, se ndryshe nuk do të përtoja t'i përmëndja të dërguarit të mareshallit atë letër që i dërgonte atij komandanti i Brigadës së Parë më 9 shkurt '44.

"..Letra më ngushëllon, më përkëdhel, më këshillon, më ndihmon, më mëson; po e ruaj atë e do të më shërbejë si fotografia jote, si një kujtim. Ah, sikur të dezertoje e të na vije prapë! Do të të mbanim komit, kontrabandë..."

E në se ai do të më dredhonte e do të më përdridhej si zakonisht, do t'i rikujtoja letrën tjetër, atë të 22 prillit të po atij viti, ku midis atyre ditrambeve që i thurte atij, shkruante:

"O mik, kujt do t'ia besosh këtë mision special?! Komunistët tanë janë bashibozukë, një turli me zarzavate të hidhura, o mësuesi ynë!"

Do t'ia numëroja këto për t'i treguar se unë i kuptoja pllanet e tyre, sepse, megjithëse llogaritë i kishin shtruar me mua, shpresat e tyre tek ai i mbanin varur.

Tri net ai larguar, mareshalli tre të tjerë kishte dërguar. Në fillim u dëgjuan çapitje, më pas pëshpëritje e në fund të thi-

rrura, dy-tre zëra përnjëherë:

- Hej, druzhe, druzhe moja!

Çohem nga shtrati e ulem aty ku kisha caktuar vendin për vizitorë të largët. Ata të tre, pasi më nderuan me grusht, u sheshuan ballë për ballë.

- Edhe juve për çështjen e librit ju dërgoi mareshalli?

- Ashtu. Por, me sa mbaj mend unë, - foli i pari i tyre, - gjithë veprimtaria jonë gjithmonë të është dukur si goditje kundër teje. Përse kështu?

- Po, e vërtetë, vetëm se çështja ndërron drejtimin, goditjet tuaja kundër meje shndërroheshin në kundërgoditje mbi agjentët tuaj, - iu përgjigja ngacmimit. - Miqësia me ju s'ishte magji, por një tragjedi që loznit me fatin tim. Ju e përjetësuat ndarjen tonë në rrethanat e mëvonshme.

- Rrethanat herë-herë dalin jashtë rrethit, qendra mbetet në mes tij, - tha "ambasadori shëtitës" me ton të prerë.

- Ne donim t'ju afronim vijën tonë e t'ju shpëtonim nga injorantët sovjetikë, nga kolkozet e sovkozet e tyre, - foli ish-atasheu ekonomik.

- Unë nuk prisja shpëtim nga ju, - ia ktheva shkurt.

- Prandaj çmëndeshe ti pas majorit rus?

- S'e mohoj, krahëhapur e prita e me nderime të mëdha, të cilat s'i meritoi kurrë. Në të vërtetë ai përfaqësonte Ushtrinë e Kuqe, por unë e kuptova vonë se ky finok kishte ardhur me "mision special", sepse rrinte tek shkallët tërë ditën, se të priste ty, kolonel, t'i thoshe ndonjë fjalë, se vetë nuk dinte të deduktonte në asnjë aspekt. Si rrjedhim i të metave në punën e tij, sovjetikët më kqyrnin mua nëpërmjet gjyslykëve të tua dhe syve dhelparakë të atij tjetrit.

- Mos e çeno atë tjetrin, se ishte më i mënçuri nga ne. Sa kishim ardhur deri atëherë, - tha i nxituar koloneli.

- Po është e vërtetë. Ato që dinte, ndryshe nga ju, i

dinte mirë dhe i thoshte saktë. por ishte tepër i pabesë, se gjatë komplotit në Berat na u dashurua me një anëtare të Plenumit të KQ, duke i premtuar se do të martohej me të. Por, pasi ia vodhi të dhënat tona, iku dhe e la pa pikën e turpit. Ne na mbeti nusja në derë,- i qartësova unë.

- Këto janë vogëlsira, - ndërhyri përsëri koloneli. - E patëm fjalën te majori rus.

- Po mirë. Ç'të them për të?!... Unë, i nisur nga konsideracioni më i lartë dhe i padiskutueshëm që ushqeja për shëfin e proletariatit botëror, nuk krijova rezerva e nuk shfaqta asnjë shenjë pakënaqësie ndaj tij, megjithëse ai erdhi nga Greqia, me një radio në sup, vetë i dytë.

- Je mosmirënjohës. Ty ambicia për pushtet t'i errësonte sytë dhe mendjen.

- Pushteti mua më takonte, prandaj nuk lejoja të tjerët të zgjasnin duart drejt tij. Ua prisja kokën. Punët e mija i dija vetë.

- Dëgjo! Te secili nga anëtarët e byrosë së këtyre, - Tashti koloneli ishte kthyer nga kolegu i tij, i cili nuk kishte folur deri atëherë e po i shpjegonte, - (me sa mbaj mend unë), çonte krye rivaliteti për pushtet personal e për poste të pamerituar. Do të theksoj në veçanti "gjeneralin", emëruar sekretar organizativ e më vonë ministër i brendshëm, që e thërrisnin "ndërgjegja proletare", se vinte nga një familje punëtore, e cili ishte i etur për lavdi. Tjetri... A të kujtohet autori i letrës konspirative drejtuar mareshallit? Këta nuk lanë intrigë e komplot pa kurdisur sa edhe ne nuk dinin se tek cili ta mbështesnim besimin për planet tona të detajuara për t'i zbatuar në vendin e tyre.

"Ambasadori shëtitës", të cilin e hijeshonte mjekrra e bardhë që i zbriste e valëzuar tatëpjetë, që, me sa kuptohet, e kishte lënë fjalën për në fund, u ngrit e tha:

Ne kuadrot e lartë e vlerësuar revolucionin, këtë dramë të njerëzimit, nga këndvështrimi politik, duke u nisur nga besimi, nga frymëzimi deri në flijim të gjësë më të shtrenjtë, si një epokë historike që do të sillte një kthesë në formën e pushtetit. Tashti e kuptojmë se ajo doktrinë ishte plotësisht e gabuar se s'gjeti zbatim.

- Edhe në gjirin e partisë suaj pati kuadro të sëmure nga etja për lëndi e pushtet, - e akuzova unë.

- Eshhtë e vërtetë Në partitë komuniste të gjithë krerët të mëdhej e të vegjël e adhurojnë pozitën dhe ëndërrojnë për pushtet.

Ti, bre druzhe, përse të na cilësoje ne si renegatë të klasikëve (duke vërvitur letrën "shpëtimtare"), vetëm se ne kishim zgjedhur një rrugë tjetër që ndryshonte kryekëput nga kursi i sovjetikëve? - më kundërshtoi ai.

- Jo vetëm kjo. Ju arritët gjer atje, sa në esencë, na detyruat t'i dëbonim këshilltarët rusë e të prananim "komisionin ndërrepublikan". Kjo ishte ndërhyrja në punët e mia, apo jo? - u mbrojta unë.

- Aha, moja draga, ti edhe tani këtu bën sikur nuk i kupton gabimet, - m'u afrua më pranë. - Komunizmi është utopi politike, ndërsa socializmi vetëm një projektion i materializmit i zbatuar në jetën e shoqërisë njerëzore. Ne harruam se njeriu qëkurse u krijua si qenie e përsosur e evolucionit, synon të jetojë, të mendojë e të veprojë i pavarur. Mirëpo, çdo sistem shoqëror, i cili nuk e përfill këtë cilësi të tij, është i detyruar ta mashtrrojë atë. Ne u gjendëm para një dileme. Zgjodhëm vetëqeverimin, për të gënjyer më pak. Të drejtat dhe liritë e tyre i përkundëm në djepin "bashkim dhe vëllazërim" të popujve dhe kombësive.

- Po klasikët përse i revizionuat? Doktrina e shkruar prej tyre qe busull...

- Prapë me klasikët ti? Ne lexuam veprat e klasikut të parë, "Kapitalin" dhe "Manifestin", dhe s'gjetëm ndonjë ide me vlerë që të delte nga vetë klasa proletare. Sipas teje, ne, për mënjanimin e dogmave dhe skemave zyrtare, që pengonin përparimin dhe zhvillimin, duhej të quheshin renegatë? - ndërhyri ish-atasheu ushtarak.

- Zhurma, që nuk shterrte asnjëherë për demaskimin dhe shpartallimin ideologjik, ishte për mua një mburojë kalorsiake që më shpëtonte nga vringëllimat e shigjetave tuaja, të cilat donin të më gremisnin. A jeni të kjointë?

- Më se të kjointë. Dhe kemi qënë të kjointë. Po ç'ti themi mareshallit?

- Mareshallit t'i thoni se ai s'ka asnjë arsye të zemërohet për një shkak të thjeshtë, se ideologjia, e cila na bashkonte, s'tundej nga një libër.

Një gjeneral armate nuk qëndron më lartë se një mareshall, prandaj i takon atij të dijë më tepër se unë, se prej historive të dinastive dhe mbretërive, duke filluar nga Xhingis Khani, apo më në lashtësi e deri më sot, cili qe ai që dhuroi gjysmën e trojeve të vendit dhe firmosi me vetëdije ndarjen e kombit të tij?

- Lënia e trojeve nuk qe lajthitje internacionaliste, as sfidë për çështjen etnike, as mospërfillja ndaj asaj krahine të pafat, as zemërgjerësia jote, por një kontratë e pashpallur në një tram të heshtur. Këtë fakt ne s'e harrojmë kurrë.

Më lëshuan nga një përshëndetje të thatë e u larguan.

- Dale, po dale! Pse kështu flasin internacionalistët?

Patjetër mareshalli ka për të dërguar "misionarë" të tjerë, se s'i mbushet mendja kokëmadhit.

E dija se s'më donte, por unë s'kisha arsye ta urreja, megjithëse, si një hanxhar i tmerrshëm më rrinte mbi zverk ky buall i Ballkanit.

I juaji kurdoherë.

XIV

Bashkëbisedimi merr përpjestime dramatike

Vrazhdësia në ndeshjet e pandërprera me armiqtë dhe kundërshtarët e mi, të çdo ngjyre, më kishte shkathtësuar në renditjen e fjalëve. I zbrazja ato me gurgule të madhe.

E ndërsa po mendoja për polemikën me krerët që do të vinin, aty ku udha gungëzohej si zverk demi, po vraponin shtatë silueta. Shtatë net kaluar, shtatë "misionarë" të dërguar.

U ulëm nëpër vende dhe zjarr për zjarr plasi debati.

I pari fola unë:

- Ju gjithnjë kini vuajtur nga komplekset e megalomanisë e të arrogancës dhe nga mania për të më diktuar mua ato parime të cilat unë kurrë nuk i kam pranuar e s'i kam përfillur.

- Unë kisha në kokën time një ide të madhe, katër shtete, një federatë, - e filloi bisedën "ambasadori shëtitës", i cili përsëri kryesonte grupin.

-Mua s'më interesonte as ideja jote as federata jonë, - e ndërpreva unë mjekërrthinjurin.

- Natyrisht ty të duhej e "vogla", londinezja, se sa e "madhja", ballkanikja, - ndërhyri koloneli. - Ti e kishe frikë federatën si djalli temjanin, se shtohej shansi i formimit të një shteti të vetëm në trojet ku banonte një komb i ndarë në pesë shtete.

- Kjo ishte arësyeja e parë: Unë nuk mund të pranoja një bashkim etnik "ushtarak". Së dyti, si komunist dhe internacionalist i devotshëm doja të ngrihesha mbi fërkimet to-

na dhe të mënjanoja pakënaqësitë që mund të krijoheshin midis nesh.

- Fole drejt. Mendimi yt ishte i çmuar për ne në ato vite.

- E po ndryshe nuk mund të gjykoja e të veproja, sepse do t'i drejtoja vetë punët e mia. Ajo që ishte imja do të mbetej vetëm imja.

- Unë s'e mbaj mend se ç'dredhi përdore për këtë manovër, - më pyeti ambasadori. - Megjithëmend ne na befasoi atëherë, se s'e prisnim.

- Si qe pyetja, se nuk e kuptova? - u përpëlita unë.

- Ku i mbështete këto lëshime, të cilat dëmtonin bashkimin e kombit tuaj? - më pyeti atasheu ushtarak.

- Fare thjeshtë, te Vendimi i Kominternit, i cili urdhëronte shpëputjen e partisë maqedonase nga komunistët bullgarë dhe bashkimin e tyre përsëri me partinë tuaj.

- A, jo jo, çështja ndryshonte kryekëput, - kërceu përpjetë "ambasadori shëtitës", - sepse maqedonasit, serbët, sllovenët e malazezët janë popuj të një kombi, megjithëse të ndarë nëpër trojet e tyre e nuk krahasohet...

- Po të prisja sa të bëheshin krahasimet, do të isha tepër i vonuar në atë betejë për pushtet, - e ndërpreva unë. - Mua më duhej një zgjidhje e shpejtë e atij problemi madhor për të siguruar të ardhmen time. Prandaj

- Ti po veproje me kokën tënde, kështu? - më ndërpreu koloneli.

- Po fundi i fundit le të bëhej ajo krahinë, (mollë sheri e qëmotshme), një gurëprove për miqësinë tonë e t'i kallëzonim botës borgjeze se partitë komuniste i kapërcenin me urtësi e mënçuri ngatërresat që u la e kaluara e errët dhe e hidhur.

- E po ç'ndodhi në të vërtetë? Unë të pata thënë në 43-in se kombi i atij trualli po bëhej rezervë e nacionalizmit. A e

tonë në Konferencën e Paqes në Paris për denoncimin e marrëveshjes së grekëve me krahinën e gjer të pajisjet industriale... Unë e ndërpreva duke i thënë të më shikonte në kisha bizhdil në sy.

- Denoncimin the?

Ata u befasuan. Mjekërbardhi dha shenjë.

- Ne po nisemi tani, se shkoi gjatë ky muhabet.

- Daleni, mo daleni, se vetë u lavdëruat, - i dola përpara kolonelit që po u printe. - Ju na dërguat fabrikën e litarit. Ajo përbëhej nga disa vegla artizanale, mbeturinë qysh nga mbretërimi i knjazëve, ca si rrumbullake e ca si boshte prej druri dhe një tambur për të rrahur kërpin, që nuk u montua kurrë as për litarë as për ushkurë, - iu shkrehu unë.

- Ne po dalim tani, - tha prapë koloneli. - Tako nema je družhe, e ç'ti themi mareshallit, se ai të pret në takim

- Mareshallit i thoni të presë. Dëshira e tij do të plotësohet pasi të kthehemi nga ballafaqimi me shefin e proletariatit, jo më përpara. Ndërkohë, ai le të vlerësojë heshtjen time për vendimet e AVNOI-it, ku, në krijimin e federatës, u përfshinë trojet e vendit tim. I përmëndni memecërinë time në vlerësimin e vendimeve të Bujanit, ku u shpалos me tërë gjallërinë e saj tradita luftarake e atyre anëve, etja për liri e pavarësi.

- Po për librin çfarë t'i themi? - pyeti "ambasadori".

- Në se ai, pasi t'i numëroni këto, prapë do të nxijë si një kërcu, atëhere kot po e nderoni si një kokë e madhe me përmasa botërore, që shquhej ndër krerët e partive të kampit tonë. Ç'kërkon ai më tepër? Franca nuk përfitoi asnjë pëllëmbë tokë të huaj nga luftat Napoleoniane. Ai ka përfitur nga mefshtësia juaj, se s'e dinit se cili ishte idhulli juaj që e lusnit ditë e natë.

- Pse, ç'ke dëgjuar ti për të? - pyetën përnjëherë.

- Këtu ka thashetheme të panumërta që mbulojnë me mister jetën e tij. Një delirant më thoshte se ai, që ishte mareshalli i vërtetë, u vra në 13-ën, ndërsa ky ishte një çifut hungarez.

- Ne e dimë se ishte rus, - tha "ambasadori shëtitës".

- Rus jo se jo, por as sërë, se nuk e zotëronte mirë gjuhën. Një tjetër më tha se ka qënë i biri i adjutantit të Dukës që u vra në Sarajevë, se e zotëronte gjermanishten.

- S'kanë rëndësi thashethemet. Ti a je ai që je? Se më tepër ka të ngjarë të dyshohet për kombësinë tënde, - më fyeu ai.

Shtatë vetë kokulur numëronin çapat tek ecnin në atë gungimë si zverk i një demi të shtrirë.

I paharruar.

XV

Vetë ferri tregon të vërtetën!

Eja e zeza muzë sy verbër që s'sheh altaret në varreza pa arkivole, shpërndarë gjithandej nëpër terr. Ti me mua u shpalle, me mua zbritë këtu, me mua do të shuhesh. Pra eja, më qëndro pranë, e më frymëzo ashtu si frymëzove zuzarët poetë e prozatorë që të shkruanin antologjinë e atyre ditrambeve thurur për mua. Në këtë katakomb-varrgremisur, mauzolenë tënde do të gjesh mbushur me eshtra e kokallet tona. Të më bindësh bushtër! Je skllavja ime. U shurdhosh në s'i dëgjon ato këmbana që po bien!

Ja! Ndjeva një uturimë tërmeti. Shkërzehen djajtë? Por jo nuk është zhurma e tyre. Po më dridhet nëntoka nën këmbë.

Mua m'u rrotullua mendja. Ulem e mbështetem mbi gjunjë. Si fërfërimë gjethesh të thata kur rrëshkasin në to gjarpërinjtë pyjeve. Përmëndem i trëmbur. Çohem në këmbë, më kishin rrethuar nga të katër anët.

- I përshëndeta me krahun lartë e u jap të kuptonin të më dilnin të gjithë përpara e sa më larg, të uleshin e të rrinin atje pa lëvizur. Ata u rregulluan si mundën, të bindur si gjithmonë.

- Këto drithërima i kini nga dhimbjet apo ...

- I kemi nga entuziasmi. Kjo natë e zezë sterrë do të mbetet e shënuar dhe e paharruar- thanë ata, të afërmit.

- Unë ju kam dashur dhe ju dua - fola i tronditur.

- Dëshirojmë të kemi kurdoherë midis nesh. Marrç nga

ditët e mia - tha njëri.

- Në fakt, ju meritoni më tepër - i ngroha unë me frymën time.

- Këto merita duam t'i ndajmë bashkë me ty - thanë ata si me qesëndi.

- Të gjithë ju ishit fondi im, unë isha sfondi juaj.

- Po, është e vërtetë.

- Ashtu ju lumtë - i miratova unë. Ne mbi armiqtë që vramë nuk do të shpërndanim dafina, por prapë plumba.

- Po është e vërtetë, ata ishin kundërshtarët e tu, - foli nga fundi tjetri.

- Ashtu ju lumtë mos mbani dert për ta.

- Jo, tani kemi dertet tona - u përgjigjën të gjithë sa ishin aty.

- Unë do t'ju them vetëm dy llafe: Ju jini heronjtë e heshtur.

Dëgjohen britma të dhimbshme.

- Këtu nuk na lënë dhimbjet të heshtim, - prapë ata.

- E di ç'keni ju? I ktheni dhimbjet në forcë, e nuk do të ndjeni muqdimet, vuajtjet e vjetët e këtushme.

- Ne s'na lënë të flemë, na shfaqen hije natën, e na lidhin me zinxhirë e na zvarrisin, na përplasnin nëpër burgje e na mbyllin nëpër kampe, - u ankuan.

- Froni mbi burgje dhe varre ngrihet më i patundur, vërtetë u derdh gjak por lëshuam rrënjë të thella dhe të pashkulura.

Dëgjohen ulurima.

Kjo tregon se sa forcë kishin idealet tuaja!

- Ne nuk kuptuam dot se cilët ishin idealet tona?

Tre të qëndrës më ishin afruar fare pranë. Unë e kuptova se ata do t'i jepnin tjetër ngjyrë bisedës. Situata po më rrëshkiste nga duart.

- Idealet tuaja thatë? E pra, çështja e partisë, më në fund komunizmi. Tani flini të qetë e kini besim se partia vigjëlton, përgjon e mbron fitorjet tona mbi armiqtë.

- Ne e përjetuam atë vigjëlím nëpër prita në netët e errta e në stuhi, luftuam e u përgjakëm me ta.

- Ju ishit heronj të heshtur, prandaj qëndroni përsëri të heshtur, sepse këtë detyrë ju ngarkoi partia.

- Jo, ne tani do të flasim - tha ai që kisha përballë.

- S'kini ç'të flisni, ashtu ju donte revolucioni.

- Jo, jo! Tani duam të flasim edhe ne - foli tjetri - se ne jemi të detyruar të vuajmë dënimet e skëtërrës, por të paktën të dimë të vërtetën? Këtu jemi të njëlojtë dhe kemi fituar lirinë e fjalës.

- Ç'liri, mo? Lufta është luftë. Çdo hero duhet të kuptojë heroikën e heroizmit që kryen dhe të ndërgjegjësohet për heroizmin e tij... Ju, nëse jeni penduar, do të thotë se nuk keni të kjiarë heroikën e asaj epopeje që shkruam me gjak. Juve s'duhet t'u brejë ndërgjegjja kurrësesi.

- Unë isha i inkuadruar në brigadën e parë. Në një përpjekje luftarake na u dorëzuan 184 nacionalistë ... Atyre u mbërthyem patkonj nëpër këmbë, i rropëm të gjallë, pastaj i pushkatuam e i varrosëm në një gropë të përbashkët të cilën e kishim hapur vetë. Ku qëndron heroika e këtij krimi të shëmtuar? - pyeti ai i nxehur.

- Unë e kisha ngritur në politikë urrejtjen kllasore, kjo duhet të na paraprinte kurdoherë dhe pa kompromis - iu përgjigja i rrëmbyer.

- Unë kam shërbyer në veri - foli tjetri - komandoja skuadrën që pushkatoi 174 djem të dërguar prej trojeve tona përtej kufirit si për të kryer shërbimin ushtarak. Ne ...

- Si the more? Çççç'do të thuash? - ...doja ta ndërprisja.

- Kujto vitet e para. Ne në vend t'i vishnim ata me rroba ushtari i xhveshëm me plumba kraharorët e tyre në lulen e djalërisë. Ka heroikë kjo vepër makabre e pashëmbull? - më pyeti mua.

- Oho, ata ishin pinjollë të dyerve fisnore - thashë qetë-qetë, i shfajësuar - Urrejtjen klasore dua t'ia lë vendit si një mallkim. Përçarja është vegla më e përsosur për të sunduar.

Midis tyre ngrihet njëri i hakërryer e thotë:

- Grekët vranë e prenë burra, therën gra e fëmijë, por ne heronjtë e heshtur u urdhëruam të heshtnim përgjithnjë edhe për ata që zhdukëm vetë me armët tona. Heshtja paska qënë heroika jonë? Dua përgjigje!

- Kujtoni ju ato heroizma që treguat në shpartallimin e zbarkimeve anglo-amerikane, atë "radiolojën" - i ndërpreva si për të ndërruar temë.

- Po! Për këtë do të flas unë që e drejtoja atë "operacion" Ja, këtu si para gjyqit të fundit, të dëshmojmë të vërtetën - u ngrit njëri midis tyre

- Ç'ke ndërmend të rrëfesh more? Jeni betuar të mos ia tregoni as varrit! - iu kërcënova unë.

- Në fund të fundit vdekja, pas jetës, është një dëfrim shëtitës, por të vdesësh i mashtruar qënka mjerimi shpirtëror më i madh. Na trego të vërtetën!

- Ja, po u shpjegoj! - Sigurimi i Shtetit që arma më e dashur për mua, partishmëria ishte kushti themelor për fitorjet tona. Armiku i kllasës duhej sulmuar çdo orë, çdo ditë, çdo muaj, e përgjithmonë dhe në çdo situatë. Unë isha brumi juaj, ju ishit mburrja ime.

- Po, është e vërtetë - u dëgjuan zëra të mbytur.

- Ashtu ju lumtë!

- Ashtu.... ashtu po ne këto i dinim, tani na rrëfe ato që

nuk i dinim.

- Ç'doni të dini të tjera? - fillova të shkumëzoj unë.

- Më trego të vërtetën për "radiolojën" se është derdhur gjak nga të dy palët.

- Tani s'mbaj mend, ç'të them, - doja t'i qetësoja.

- Je i detyruar të thuash gjithshka se ne jemi vrarë në tokën tonë, vëlla me vëlla, për interesat e të huajve. Ferri rrëfen! - m'u kanos e donte të më mbyte.

- Prit mo, lëshomë të them, se do të rrëfej. Largohu, mos më pengo.

- Na e shpjego kuartë se ç'ishte kjo "radiolojë"?

- Ajo nuk ishte "radiolojë" por "radiodramë" me përmasa botërore e cila luhej në disa skena. Personazhi kryesor, për vetë rrethanat, isha unë. Diplomacisë perëndimore i duhej një Jugosllavi e federuar, një Ballkan i ekuilibruar dhe një Gjermani e rrethuar. Shefi i shtetit sovjetik, kur ia thanë këtë, pasi përdrodi mustaqet hijerënda "e pranoi" lojën. Ai, për t'i detyruar amerikanët të mbanin në këmbë federatën, e ndërtuar nga anglo-francezët, e përjashtoi PK nga informbyroja për një "grindje" ideologjike. Ky ishte prologu në planin e parë. Dëgjoni se do t'ju shpjegoj "radiolojën" tek ne. Përse pikërisht tek ne. CIA dhe SIS-i e zgjodhën vendin tonë si avampost i imperatorisë ruse, për t'ju kundërpërgjegjur politikës agresive të strategut të madh të përdorur mbi satelitët e tij.

- O ferr, rrëfe më kuartë, - u egërsuan ata të dy.

- E mirë, mirë, uluni, përse rrëmbeheni? Agjentët e Inteligjenc-servisit gjatë Luftës II Botërore i tradhëtuan synimet e elitës qeveritare angleze për të më ndihmuar mua të shtija në dorë pushtetin shtetëror, megjithëse ishin të sigurt se do të isha armiku i tyre i ardhshëm. Punë për ta. Po kështu shtabi Ekzekutiv i Operacioneve Speciale e tradhëtoi provën

anglo-amerikane për rrëzimin e regjimit tim, duke lajmëruar me një nga agjentët e tij, shtatëmadhërinë sovjetike. Këtë copëz informacioni KGB-ja e dërgoi te Sigurimi ynë.

- E përse gjithë këto skena e prapaskena, si lozeshin drama dhe tragjedi në kurriz të një kombi për të shpëtuar një federatë? Apo një fron? Ti na paske qënë i garantuar në Lindje dhe në Perëndim,... po ne ç'ishim vallë, mercenarë të pansllavizmit apo kavië të anglo-amerikanëve? Djall o punë kjo. Sa thellë je kredhur sa s'del dot nga ay gjiriz i ndyrë.

- Po dale mo dale, qenke gjaknxehëtë, - mundohesha ta gënjeja.

- Përgjigju! Ne ç'ishim? Po largohemi të zemëruar. Do të kundërpërgjigjemi.

- Po prit mo, më pyete, prit të them përgjigjen.

- E kuptova përgjigjen, ne paskemi qënë veglat e satanait. Ti dhe këtu po na godet e po na vret por do të përgjigjesh në gjyqin e fundit për të dy jetët e tua o frymë gjëmitare kriminale, - dualën të tre.

Për një çast ra qetësia. Ata që mbetën u tulatën.

- Çfarë po flisni ju? - i pyeta unë.

- Jo ne nuk na lënë mallkimet të flemë.

- Prit kush fërshëllen ashtu si kacek i shpuar?

- Ai ashtu është i dënuar, se të burgosurit, nga frika e tij, e pyesnin njëri-tjetrin, nëse ishte ky aty, duke nuhatur ajrin nëpërmjet buzëve gjysmë të mbyllura.

- Afrohu këtu, afrohu, po ai me gjysmë koke të xhvatur?

- Ai ka punuar si operativ i sigurimit në marinën kufitare dhe të arratisurve u priste kokën me elikën e motobarkës, i linte t'i hanin peshkaqenët e thellësive Joniane e s'i linte t'i qanin e t'i varrosnin të dhimsurat nëna të bregdetit.

- Po ai që troket në atë pllakë shkëmbore?

- Ka qënë komisar politik, i çmëndte ushtarët e padisiplinuar në s'mësonin në format e edukimit e pasi i vishte vetëm një kapotë të leshtë të vjetëruar, i linte para portës së tyre ku trokisnin e trokisnin tërë natën, se nënat dëgjonin, por nuk guxonin.

- Po kjo erë mo, ç'është kjo erë? Na kundërmoi!

- Mua më zhsyin në kanalet e zeza, jam i dënuar të kundërmoj përjetë.

- Përjetë the, mo? Pse i pavdekshëm je ti?

- Ti ende vuan nga deliri i madhështisë sa pranon të mbash këtë erë e të jesh i pavdekshëm, kurse unë jam i dëshpëruar e dua të më djegin tani e të zhdukem përgjithmonë.

- Po ai me gjuhë të mbërthyer në dhogë?

- Ou se më lodhe me pyetje!

- E mirë, zini vendet se do t'ju them dy fjalët e fundit apo të mos zgjatemi se na shkoi vonë, shkoni e flini tashti!

- Po ne rrimë zgjuar, nuk flemë.

- E po, po shkoj unë atëherë dhe mua më trembet gjumi i natës, nuk fle si ju.

- Këtu thonë se dhe Juda s'fle.

- Po Juda pse s'fle? - i pyeta unë.

- Juda mendon për tradhëtinë, - u përgjigjën ata.

I juaji përherë dhe kurdoherë.

XVI

"Kufiri" i internacionalizmit tim mbaronte atje ku fillon kulti im

Carët e Kremlinit, të cilët erdhën një e nga një e vdiqën njëri pas tjetrit dy e nga dy, si me porosi, gjithmonë i shqetësonte fati i atij zinzhiri me katër hallka: Moskë-Beograd - Paris - Londër, i farkëtuar në fshehtësi, për të rrethuar një ndër shtetet e mundura në Luftën e Dytë Botërore.

Unë e përfytyroja atë zinxhir - barikadë si një pakt jetëshkurtër proslav, i cili si për ironi të historisë, që nga 8 Nëntori i 41-shit kalonte nëpër zorrët e mia. Prandaj tek lindte e tek perëndonte, të gjithë politikanët më merrnin me të mirë.

Edhe këtu në skëterrë, e njëjta politikë, e njëjta taktikë. Ata duken sikur kujdesen për mua, por në fakt, duan të freskojnë miqësinë e vjetër në rrethana të reja pas vdekjes sime.

Ata janë nisur, po le të vijmë, do t'i presë si prita ata "misionarë" të mareshallit.

Grykat e topave janë të po asaj baterie, kalibri ndryshon e zjarri më i shpeshtë, arsenali i municionit është po i atyre llogoreve, baroti ndryshon më i thatë; gjëmimi më zhurmëmadh, tymi më i dëndur, sepse deri tek momenti kur do t'i dilja ballëpërballë kreut të tyre, do të kalonin procese të ndërlikuara, me zikzake e tërë dredhi, plot lëshime e zëmërimë, me kundërshtime e pretendime, sipas lëvrimit të shklopit të dirigjentit. Ideologë ishin shumë, ideologjia ishte një, i vetmi emërues i përbashkët për mua.

Doktrina e katër klasikëve, më tepronte edhe sikur të ndeshesha me 144 revizionistë sovjetikë dhe botërorë. Le t'i numërojmë njëherë:

Me kryerevizionistin, i cili duke vepruar me konspiratorë të regjur kundërrevolucionarë, kreu puçin për të shtirë në dorë drejtimin e shtetit sovjetik. Prapë me atë, se pasi kurdisi orën e xhepit me mareshallin, e shpalli tradhëtinë e madhe ndaj literaturës së kllasikëve, po prap me atë, se na la në të varrosim sekretarin e përgjithshëm të një partie punëtore motër e po bisedonte tek e tek me flokëverdhën, mbështetur në një pemë, (të dy pranë e pranë) si të donte t'i mbërthente të puthurën e parë. Por nuk qe punë dashurie ajo, se dy-tre muaj më vonë, Polonia po vinte era kundërrevolucion, si në Hungari, pa pritur shpërtheu pështjellimi e kaosi sa nuk u muar vesh nga u rrokullisën truporët e shefit të proletariatit të shkultura prej një turme të çmëndurish.

Me ministrin e brendshëm (i dekoruar me katër yje të Heroit të Ushtrisë së Kuqe) i cili, pasi u pompua për "merita të mëdha" në luftën patriotike i ra shorti të përçmonte figurën e gjeneralisimit; megjithëse pasi u përdor si puçist, u akuzua për bonapartizëm e u la mënjanë si një kufomë e gjallë e bolshevizmit.

Me një fytyrë-verdhë (si të kishte vuajtur tërë jetën prej etheve malarike) i cili s'donte t'i quante kryengritësit kundërrevolucionarë; nejse, për mua ka rëndësi se kur u ngrit në rytbe, ky agjent i KGB-së, me "etiketë diplomati", luajti një rol të poshtër ndaj meje.

Me intrigantin me damkë, elementin më negativ (nga gjithë sa ishin në presidiumin e tyre), i cili mbllaçiste si kau plak gjithë ato plane djallëzore, komplotiste, kundër meje.

Me vetullë-kaleshin (që nuk i lëviznin kurrë si t'i kishte mbërthyer me gozhdë patkoi) i cili u ngrit në post për meritë

se shpartalloi grupin "antiparti" të gardës së vjetër, dhe u suall më vonë në krye të partisë e të shtetit si një "modus vivendi" për të lozur një tragjedi agresioni mbi vendet e orbitës ruse.

Me mjekërbardhin syshpëlarë, i cili bashkë me kolegun e tij, u treguan qorra, sepse të verbuar nga etja për pushtet, ranë pre e gardës së re.

Me ambasadorin e fundit, i cili gjithmonë i zbehur, shkonte e vinte (si ato gratë kur i zënë të prerat) se synonte të më kthente mendjen mua të largohesha nga parimet e kllasikëve.

Po s'mund të numërohen armiqtë e mi, më bëhen pirgje-pirgje, më erren sytë e nuk di t'i rreshtoj të gjithë këto mumje të sajuara, po dua të përmend ekipin e mareshallëve të cilët fodullë të mëdhenj, (sidomos kur bëheshin xurxull me vodka), ngrinin gotat për miqësinë midis dy ushtrive tona.

Nuk më premtton koha për të përmendur këtu krerët e partive punëtore e motra me të cilët (veç e veç në KNER, apo në mbledhjen e 81 partive në Moskë) u hëngra dhëmbë për dhëmbë në mbrojtje të çështjes së revolucionit botëror.

Po përmend vetëm një rast, me hungarezët, se kur unë i porosisja të mbyllnin menjëherë "klubin" në qendër të Budapestit e të delte në bulevard kllasa punëtore e armatosur, të vrisnin pa gjyq frymëzuesit e kundërrevolucionit, ata më thanë duke shkyer bebet e syve me një zë:

- Ke lojtur nga mendja?

Këta socialdemokratë, kuptohet oportunistë, si shtiza të shumë flamujve, politikanë të piruetave koniunkturale, marioneta të vjetëruara, qolje të vçgla e pavlerë për vendet e tyre, dhëndurrë e kumbarë me partitë borgjeze, e kishin tradhëtuar kauzën e përbashkët dhe mua njëkohësisht.

Prapëseprapë ata më donin më pak, nga sa i urreja unë; po ndërsa atyre ua donte strategjia të lidheshin me mua,

unë taktikisht doja të ndahesha nga ata, sepse në fitorjen time s'kishte pjesë asnjëri prej tyre, në të kundërtën, ato vende vasale, i kishte çliruar ushtria e kuqe. U zgjata në hyrje të letres. Nejsë.

Kreu i Kremlinit dërgon dy "kaponjtë e qyvezit" për të përgatitur takimin me të e pasi u ulën ata të dy, i pari fola unë, pasi vura re se atyre u ishte kacavarur lafsha e rrinin si pula të lagura.

- Për ty - i u drejtova të parit ruaja kujtime të mira se e adhuroja shefin e shtetit tënd i cili të vlerësonte si një bolshevik i vjetër e i aftë, por kur erdha në krye të një delegacioni, për të kërkuar një kredi ekonomike e ushtarake, më priti rëndë-rëndë, me një sjellje aspak shoqërore. A të kujtohet?

- Po më kujtohet, - e pati gati përgjigjen ai, - ne donim të të jepnim të kuptoje se ai idhulli ynë, kishte vdekur përgjithmonë dhe se ne po ndërronim kursin.

- Përse nuk më thirrët mua?

- Nu, nu, ne të derdhëm mbi kokë një qerre me vretje se ju kishit një aparat burokratik të fryrë, se çështjet financiare ju delnin me humbje, se nuk dinit të bënit tregti, se fshatarët tuaj vuanin për bukë e ujë, se nuk kishin asnjë pulë, se...

- Po pulat e mia kush i numëroi xhanëm? Unë po u them se ju ishit për vete kripë në diell.

Qeshën të tre.

- A të kujtohet këmisha ukrainase e qëndisur, që të dhuroi "miku" yt.

- Këmisha më pëlqeu, por jo sulmi i shfrenuar kundër shefit të proletariatit botëror e strategut të madh të shtetit të lavdishëm të sovjetëve.

- Pravilno, ne ta falëm atë kal të ngordhur, e merrje, - kërceu përpjetë tjetri, - ne duhet të lironim të burgosurit e të prishnim kampet e përqëndrimit, partinë bolshevike dhe push-

tetin sovjetik ne duhej, ta deklaranim të "të gjithë popullit"

- Ky është gabimi i juaj fatal, se e shuat luftën e kllasave pa mbërritur në komunizëm.

- Ne kërkonim zgjidhje të tjera në ndërtimin e ...

- E socializmit, por nuk ka rrugë të mesme, - ia preva fjalën, - dhe ky mohim do t'u kushtojë shtrenjtë popujve që duan të çlirohen nga shtypja. "Bashkëekzistenca paqësore" apo "gara ekonomike" midis të dy xhunglave është teori kapitullante. Luftën e ashpër që zhvillohet në mes këtyre dy kampeve shoqërore, për jetë a vdekje, e zgjidhte vetëm revolucioni botëror.

Ata mbetën nofulla-shqyer, se ajo e poshtmja i zbriti tek dërrasa e kraharorit kockanjar.

- Dëgjoni këtu: provokacionet, insinuatat, sabotimet, presionet dhe shantazhet e luftës, na e kthyen vitin '61, në gurë prove.

Do përballonim goditjet tuaja të pamëshirshme duke ju kundërvënë zjarr për zjarr, apo do të ulnim kokën e të nënshtroheshim. Jo, kurrën e kurrës! Ne manifestuam pjekurinë tonë se vitaliteti nuk është vitrinë por shqetësim, pagjumësi, alarmuam masat punonjës për rrezikun që na kanosej, denoncuam Traktatin dhe mbanim në gatishmëri ushtrinë.

- Ne donim t'u ndihmonim e t'u shpëtonim nga dështimet, - foli i qetësuar kaposhi i parë i qyomezit.

- Jo, kjo nuk është e vërtetë, se kur unë i parashtroja pllanet tona për zhvillimin e industrisë së rëndë, vetë kreu juaj më këshillonte të mbillnim pambuk, të mbarështronim lopën e delen, peshkun dhe agrumet. Kur ne donim të hynim të thyenim bllokadën e urisë na u përgjigj vetëm Franca.

- Ne blinim grurë për vete - u shpejtua kaposhi i dytë i qyomezit.

- Franca ishte një detaj i aksit, prandaj do t'ju ndihmonte t'i qëndronit të papriturave, po ashtu dhe Anglia, detyroheshin për të ruajtur interesat e tyre në Ballkan. - u përpoq të mbrohej kaposhi i dytë i kotecit

- Këto i dija para se t'i dëgjonit ju, por e patëm fjalën te mosmarrëveshjet të cilat ju i reflektuat dhe në lidhjet ushtarake e më vonë në ato shtetërore, - e kundërshtova përsëri.

- Ne erdhëm një delegacion me gjeneralë, komandantë e shefa të shtatmadhorisë për t'u mirëkuptuar për bazat tona atje, se e kishim Mesdheun në pëllëmbë të dorës prej Bosforit e gjer në Gjibraltar. Ti nuk na e shite ne për njëqind rubla. ata që do të vijnë do e shesin për pesë dollarë.

- Vendi i juaj është i vogël, prandaj... - u shkund kaposhi tjetër.

- Ambasada sovjetike u shndërrua në një çerdhe të KGB-së ku dirigjenti i orkestrës revizioniste deshifronte pentagramet që mbusheshin në Moskë për të diskredituar udhëheqjen tonë, për të më goditur mua dhe për të dëmtuar nyjet nevrologjike në naftë e në minerale.

- Pravilno. Ne bazat ushtarake do t'i vinim nën komandën e Traktatit të Varshavës - ngulte këmbë ai, sikur fliste për arat e të atit.

- Asnjë pëllëmbë, - i'u përgjigja prerë, - ju s'shkelët më me këmbë.

- Harasho. Ti nuk doje të humbje në lodrat e të tjerëve atë që kishe grabitur për vete, se fundi i fundit, një bllokade e shpartalloe me një pllakatë, - foli rëndë-rëndë ai, - por na thuaj tani prej teje ndonjë fjalë për "ministrin e kukuruzit" që u zgjodh shef.

- Mua më përfytyrohet sikur ai ka veshur lëkurë të murrme çakalli, në kokë dy sy të venitur, një hundë mishtake.

me dhëmbë të ngrehur për kafshim, përleshet me ujqër laramanë në pyllin revizionist e s'gjen derman.

- Ehë, edhe këtu bëkan emër ligjet e xhunglës, këtë mendim t'a pranojmë, - folën të dy përnjëherë.

- Kanjec, kanjec u ngrit duke ecur shtrëmbër si e kish zakon kur ikte vjedhurazi, kaposhi i parë.

Në ardhhtë vetë ai, do të kërcasë polemika dhe debati.

Sado i madh të ketë qënë atdheu im internacionalist edhe kufijtë e tij pa anë e pa fund, kanë një cak. Caku jam unë, fundi i tij, kulti im.

Unë posa fillova ta shqiptoj fjalën internacionalizëm e dija se ai çonte ujë në mullirin e shovinizmit serbomadh e të nacionalizmit rus.

I juaji përherë.

XVII

Sa më e madhe "motra" aq më e madhe tradhëtia

Unë u përlesha me fenomenin jugosllav, u kacafyta me korrentin sovjetik, më prisnin grindje të tjera. Këto ndeshje më përgatisnin më mirë dhe më kalitnin për beteja me tradhëti të reja edhe në çinë-e ma-çinë të ndodhnin ato. Se paska qënë e thënë që partia jonë të mos ngjeronte një ditë të bardhë!/? Ashtu si isha i alarmuar në grindje me armiqtë e klasës e të revolucionit unë nuk ngurrova të ngrihesha në sulm frontal edhe kundër një varianti tjetër që po nxinte çerturinat e para te motra më e madhe.

Liderët kinezë, të fandaksur, s'është se e lajthitën teorinë e klasikëve nga currufosja në pleqëri, as se roitën nga trutë prej zhvillimeve kohore, por ata ashtu do të kenë qënë ende pa u dalë leshtë, pasi ato fraza parimore kishin patur, dhe më parë vetëm se i adaptonin në rrethana të kontradiktave antagonistë e joantagoniste.

Ata më dërgonin diktate e më urdhëronin si të mendoja e si të veproja, të përulesha e të puthesha me renegatë sipas tempit të tyre të gërvëlisur. Këta "ideologë", botëkuptimi idealist i ngatërronte, pandaj s'nxirrnin gjykime të drejta për ngjarjet lidhur me fatet e lëvizjes komuniste botërore, kurse mua botëkuptimi materialist më zgjonte e më armatoste në atë luftë për jetë a vdekje:

* Me "timonierin e madh". kryetarin (i cili thoshte se ai ishte një majmun që u bë mbret se nuk kishte tigrë në mal),

sepse lejonte dy vija në parti e guxonte të më deklaronte se kishin divergjenca kardinale me mua!?

* Me "teoricienin", i cili përgatiste referatet pa një thërrime baroti brënda, me një ton pajtues e tolerues dhe me dy gjer në tre variante zgjidhjeje. Turp i madh për ata!

* Me kandidatin e KQ, i cili proklamonte doktrinën borgjeze të "qarkullimit të lirë të ideve e të njerëzve". - Sa turp! E humbën torruan.

* Me një neglizhues "deviator" i cili gjatë revolucionit të madh kulturor proletar na vërviti idenë e unifikimit të partisë me shtetin.

* Me një tjetër "kuadër", i cili, megjithëse kishte gabuar tërë jetën e tij bërtiste (sa i pështillte gryka) nga tribuna e kongresit VIII-të të tyre: "Amani o shokë më kritikoni, se unë do të gaboj papë".

* Me "ideologun e komunizmit kinez" i cili vazhdonte të thellonte vijën e përhershme të partisë për bashkëpunim me borgjezinë e kulakërinë. - Ç'janë këto gjepura?!

Me "oportunistin" i cili s'lidhte dot dy fjalë nga druajtja se mos lëshonte ndonjë guriçkë në kopshtin e kryerevizionistit sovjetik, frikacaku. - Ç'gabime trashanike!

Me gruan e "kryetarit të madh", e cila na shpjegonte aforizmat e tij: "Ajo gjë që zgjatet, thërmohet lehtë", "Sa më lartë të ngrihesh më tepër vritesh kur bie". "Sa më tepër të rritet lavdia, aq më të vështirë e ke të jesh i denjë për të". - Për mendimin tim, të marra së bashku, këto s'vlejnë asnjë jen.

Me ambasadorin i cili deklaronte se si rezident i shtetit kinez ai duhej të dinte çdo gjë nëpërmjet agjentëve të tij të rekrutuar tek ne. - Kjo është një lodër e rrezikshme!

- Të marrshin të keqen.

- Kush foli? cili je ti aty?

- Jam unë, unë, - më qetësoi ai.

- Ashtu të lumtë! Çfarë, aty po flije ti?
- Jo nuk po fle, po marr një sy gjumë.
- E mirë, unë po vazhdoj.
- Po të gjithë do t'i përmendësh, se ata nuk mbarohen!
- Ja e lashë, nuk po e bëj dysh fjalën tënde.
- Edhe ne nuk e bënim dysh fjalën e partisë - më tha e

prapë po gërhiste.

S'më shqetësonte gërvëra ritmike e tij, mund të flija dhe unë të madhin gjumë por këtë radhë ndryshonte kontradita, se ato koordinata të cilat tendoseshin për në Beograd apo për në Kremlin po përplaseshin në Pekin. Ç'po ndodhte me motrën e madhe? Galloshja kineze-këmbe amerikane.

Ata domosdo kanë reflektuar ndaj vërejtjeve të mia. Të shoh se kush e kush do të jenë në përbërjen e delegacionit për të mbrojtur këtu nderin e tyre.

Ja në brigjet e qeta të gjolit ku rriteshin zhukat gjetheshpatë, posi ato rosat e trembura prej një qeni që kërkon të përrallet me to, herë grumbullohen e herë rreshtohen, u dukën shokët kinezë, këmbëshkurtërit. Për mirësjellje më përshëndetën dhe u ulën përballë meje.

I pari fola unë, i papërmbajturi:

- Ato shkëndija që na shkrepën në Bukuresht, Moska na e ktheu me ura zjarri, hë mo e kuptuat ju? Kjo ishte e keqja më e vogël.

- Cila paska qënë e keqja më e madhe sipas teje? - pyeti rumbullaku si top llastiku, tashmë i fishkur.

- E keqja më e madhe ishte se udhëheqja juaj nuk po shqetësohej më për fatet e botës së tretë, por përpiquej vetëm, sa për t'i thyer kreut të Kremlinit, shkopin e dirigjentit.

- Ku e mbështesni këtë trillim? - prapë topi i llastikut që po fryej ca e nga ca si i pa çpuar që ishte.

- Sepse fjalimet e "teoricienit" tuaj unë i quaja "limonadë" dhe diplomacinë tuaj "një taktikë pa eshtër" - ia mbylla gojën si me shtupë.

- Ne e donim motrën e vogël, prandaj të orientuam të vendosje në ushtri komitetet e partisë, komisarët politikë, t'u shkuleshin gradat oficerëve madhorë, sepse përgjegjësia e hierarkisë ushtarake qëndronte tek funksioni i kuadrove e jo tek gradat si e mendoje ti, vetëm kështu rritej niveli i ndërgjegjes, shpirti luftarak, ndjenja e disiplinës dhe lidhja me masën - referoi atasheu ushtarak.

- Ne e nderonim idenë e apogjeut tonë, i cili shkëlqente mbi katër klasikët kur thoshte se "ushtria është partia" - kështu e mbështeti ish-ambasadori te ne.

-Prandaj i udhëzuat gjeneralët e mi që të tërhiqnin ushtrinë tonë në male?

- Ky ishte mendimi ynë, po t'u pëlqente e vinin në jetë, nëse jo, okej.

- Unë i kuptova planet tuaja për rrëzimin tim dhe ua preva kokat gjarpërinjve që kishin helmuar me teorinë tuaj.

- Ne, e vogla motër, tepër shumë na duhej, - mezi i lidhi fjalët shefi i agjitpropit.

- Ti mos u lavdëro kot, se në asnjë organ të shtypit nuk dhatë të paktën një njoftim për vëllimet e veprave të mia ku mbroja partinë tuaj, lëre më pastaj për kushtetutën tonë të re. Ju duhet të kishit lajmëruar masat milionëshe për këtë dokument politik e historik, ideologjik e administrativ, një punë e përsosur universale e komitetit tonë qëndror, ndërsa ne mbushnim fasadat me telegramet tuaja sa një jorgan vendi për pajë.

- Ç'komedi, - tha e po hingëllinte ambasadori.

- Si the mo, komedi? Ju ndodheshit në kaos e nuk e kuptuat se ajo ishte tragjedi për motrën e madhe, - iu shkreha unë.

- Nga tërë ata sekretarë të partive motra ti ishe më cmirëzuiu se kur montuam ne fabrikën e armëve në Rumani dhe ju do të merrnit pushkët e fishekët atje, na u zëmërove kot.

- Më se e drejtë zëmërata, - i'a preva shkurt, - ishim shokë armësh me ju, përse nuk e montuat tek ne atë vepër?

- Ne te ju do të sillnim krenarinë e industrisë sonë të rëndë, të shkullurin, - prapë ai, e po hingëllinin të gjithë.

- Domosdo se po merrnit të tjera nga borgjezia amerikane e nga revanshistët e Bonit, nga armiqtë numër një të popujve, të revolucionit e të komunizmit.

- Ju e shtini bisedën në ...

- Aha, ndoshta donit të më pajtonit dhe mua me ta pa u erdhi e thartë përgjigja ime se ne nuk do t'i falnim kurrë agjentët e komplotit ushtarako-ekonomik!

Unë ua pata thënë se për të pastruar krejt bazat dhe rrënjët e revizionizmit tek ju, duhej luftë brenda partisë, disiplinë e hekurt, vigjilencë dhe gjak, për më tepër ju fola se si e shpartallova çerdhen e elementeve antiparti në konferencën e kryeqytetit.

- E kjartë, për ty dhe për ne, ti u rreshtove në llogoret tona për të ruajtur veten tënde.

- Ja ju jini në mes të oqeanit pa busullë. Dihet botërisht se unë e mbrojta partinë tuaj me principialitet në komplotin e Bukureshtit, sepse edhe ju u dënuat për saktarizëm e dogmatizëm si dhe ne.

- E, po hë,- tha ai i shpejtuar.

- Si e po ë? - e pyeta unë.

- U sulmuam si dogmatikë dhe sektarë, - ndërhyri ish atasheu.

-Lëreni ato dhe pranojeni hapur se dhe ju u pickoi me thumbin e tij helmues "centrizmi", - i akuzova prapë.

- Motra e madhe e donte dhe kujdesej më tepër për

motrën e vogël se sa...

- Prandaj na shpallët bllokadën? - u shpreha pa e lënë atë të lllomotiste.

- Jo, ju edhe me vendet vëllezër përdorët politikën tuaj të njohur izolacioniste - më sulmoi ai.

- Ne më mirë hanim bar e s'gjunjëzoheshim as te imperializmi as te socialrevizionizmi.

- Juve, ndoshta, ju tepronte bari por ne as kashta nuk na mjaftonte megjithëse përdorim çdo gjë që rron e vegjeton në tokë, që noton në ujë e që fluturon në ajër, a e kupton?

- Prandaj më gostitët me qumësht pele?

Më qeshën të pestë.

- Ne të dhamë edhe qumësht dele, por kujdesi ishte i kotë

- tha shefi i agjitpropit qetë-qetë.

- S'ishte punë qumështi, ju po luanit me të ardhmen e botës së tretë.

- Mirë na pati thënë i dërguari sovjetik se ata ju humbën juve por nuk humbën gjë të madhe, dhe ne që ju fituam, s'fituam gjë të madhe.

- Të gjithë krerët e partive më kërkonin largim nga parimet, kompromise, unë isha ai që isha, por i detyruar të lozja rolin tim, e s'mund të bëja lojën e të tjerëve.

- Roli yt ishte fataliteti i vendit tënd. Prandaj as radiogramet, as letrat, as bojkotimet, as zemërimet, ty nuk të tundën e s'të shkundën.

- Kush ua dëshifronte këto shpjegime? - e pyeta i tronditur.

- Dielli që shkëlqente botën. Po ty kush të shpjegonte?

- Mua m'i dëshifronte shpirti im.

U ngritën e u kthyen nga kishin ardhur, por jo si patën ardhur. Më dukeshin tek ecnin buzë liqenit si rosa të lagura se-

pse iu tregova edhe një herë si dhjetra vjet më parë se unë, i gjithëfuqishmi i motrës së vogël, ua kisha shpërbërë atë ëndërr të lezeçme të ekspansionizmit kinez në përpjekje për t'u bërë superfuqia e tretë botërore duke patur një bazë ushtarake në brigjet e praruara të Mesdheut.

Ja cili jam unë me dëshifrimet e mia misterioze.

I juaji përherë e i paharruar kurdoherë.

XVIII

Orët e Kremlinit s'tingëllonin më për mua

- Sepse po më rëndojnë kapakët e syve - e theva unë qetësinë.

- A e di se ka kaluar mesnata? - u përgjigj ai.

- Pa dëgjo sa herë do të tingëllojë ora?

- Thuaj orët, se ato janë nëntë e bien përnjëherë të nënta.

Unë rashë në mendime të thella, u kredha në kujtime të largëta.

- Përse mendohe, hapja zemrën kolegut, - më përmëndi ai sikur donte të më ngacmonte.

- M'u kujtuan orët e Kremlinit edhe ato binin bashkë.

- Tashti mos u sandis as për orët e Kremlinit, as për çangët e Pekinit.

- S'më le të shlodhem, më duket sikur i mbaj mbi supë si një hamall.

- Aman më trego një kujtim nga ato që po të rrjedhin pa pushim, - m'u lut ai.

- E mirë, mo, se po të kallëzoj, - vendosa t'ia plotësoj dëshirën.

- Popujt derdhën lotë të nxehtë për vdekjen misterioze të shefit të proletariatit, krerët e atëhershëm, gjetën ditën e ëndrrave të tyre të thinjura për të ndarë portofolet. "Pantera" donte të gëlltiste nga preha e saj dy-tre viktima përnjëherë, ose sa t'i mbyste me kthetrat e saj.

- Ty të ftuan në ceremonialin e varrimit?

- Jo, unë shkova në qershor për të kërkuar kredi ekonomike dhe ushtarake.

Ndërkohë ndieja një zhurmë që përshkonte hapësirën midis meje dhe atij.

- Çfarë, po fle ti mo? - e tunda për koke.

- He ku je, ç'ke? Kush je? - u përmënd i trëmbur.

- Ç'më pyet se ç'kam. Kështu flije në organizatën bazë e në plenumë, po në kongrese gjumë bëje?

- Po.

- Si po?

- Jo.

- Si jo, porsa po fle këtu në momentin më tragjik të njerëzimit, kur vendin ku shpërtheu revolucioni e mbërtheu tradhëtia. Sa pashë tymin, aty do të dilte dhe flaka. E këmbyen gardën e vjetër me të renë sa të hapësh e të mbyllësh sytë.

- Po te ne u këmbyen gardat, - jo? - tha si i druajtur.

- Mos më ndërpre, rri e i vër vesh fjalës sime, - e porosita.

- E mirë, a shkove përsëri, apo ç'do kërkoje, shefi kish vdekur.

- Vajta pas një viti, shefi i ri më la përshtypjen e një babaxhani, plot gjallëri e dashuri. Mirëpo mua nuk më merrte gjumi natën për ato që vëreja ditën. Më brente fakti se si ky "muzhik" ngjiti me shpejtësi shkallët për në fron. Qorrat. Padyshim kishim të bënim me një komplot të përgatitur. Puçi ishte kryer me përsosmëri nga mjeshtër të intrigave. Bollshevikët e vjetër i mbyti syleshëria, matufët!

- Të më pyesje mua nuk të lija të shkoje përsëri, - tha ai me mburrje.

- Isha i shtrënguar se në Janar '56 u mblodh KNER-i. Ne ishim një vend i varfër, pa bujqësi e pa industri, por krerët e Kremlinit i kushtëzuan ndihmat që u kërkoja me pranimin e

gabimeve të shefit të vdekur.

- Ti më duket pranove të hidhje ca baltë mbi ...
- Ç'thua mo, - s'mbaj mend vogëlsira si këto.
- S'të shkeli më këmba kurrë pastaj? -donte të dinte ai.
- Më thirrën për të kaluar pushimet.
- Hiç mos shkonje, ti kishe vilat e tua, nuk plase për

to. Pse të tërhiqnin për hunde.

- Mirëpo ata i shtronin në pllanin politik pushimet verore dhe dimërore. Po pushime u thënçin se nga limani në liman duheshin 8 ditë, nëpër detra. Vapori nuk të linte zorrë në bark, dy ditë të mbufatej koka me tren, më në fund me avion. Sa ditë udhëtim u bënë kështu?

- Plot 13, - i llogariti ai.

- Shto dhe trembëdhjetë të kthimit, plus ditët e mbledhjeve. Kur një ditë nga ditët më pritën shëndeverë e krahëhapur e më detyruan të përqafohesha me "ambasadorin shëtitës" duke u hedhur pupthi e duke thirrur:

"U ça akulli, u ça akulli!"

- Për cilin akull thoshin ata? - pyeti ai.

- Të çahej akulli, të ngrohej moti, të vinte pranvera që ëndërronin. Ata donin të më shtinin në dhokan.

- Të morën të keqen.

- Ashtu të lumtë!

- Po përse nuk pushoje nëpër demokracitë, ato ishin më afër?

- Kam shkuar dhe tek ata, nuk e mohoj. Por pas vdekjes së bolshevikut të madh kudo më prisnin ftohtë, me përbuzje, sikur të isha hija e tij.

- Ku ke shkuar, po të pyes kot, për muhabet?

- Po nuk ka rëndësi xhanëm se bisedë po bëjmë. Kreu i Kremlinit solli në poste drejtues të partive motra ata që i duheshin atij, prototipa të mediokritetit politik

- Te shokët e parë them, të shkoje tek ata! - ngulmonte ai.

- O te të parët! Tre nga ata vdiqën në Moskë, i groposi gripi, thoshin, (kjo pikë e zezë!) në Bullgari mbeti "shkëmbi i ngrirë", tek gjermanolindorët, megjithëse tepër fodullë e prepotentë, ai më kryesori, kur vajta në '59-tën nuk fliste, i kishte rënë paraliza; ndërsa në Çekoslovakia ku shkova disa herë (si më dukej mua), hija e fantazmës time ishte më e zbehtë, sepse me thjeshtësinë e tyre më krijonin një ambient të ngrohtë krejt ndryshe nga ajo frymë e rëndë e vetmitare te sovjetikët, të cilët më izolonin në periferi e nuk më linin asnjëherë të lirë duke më rrethuar me informatorë të Komitetit Qëndror të veshur si "çinovnik", të sigurimit.

- Po përse shkoje xhanëm?! - ngulte këmbë prapë.

- E po doja të shkëputesha pa më kuptuar, se njëra nga antaret e byrosë tonë kakariste e nuk pushonte duke thënë për kllounin, sharlatanin dhe renegatin e kllasikëve: "Ai është babai ynë".

- "Babai ynë"? Po sa baballarë na bëhen kështu?!

- Prit mos më ndërpre, se nuk i mbaj mend. Përsëmbull ti i mban mend se sa janë veprat e mia, jo nuk i mban, - i thashë.

- I mbaj, të betohem për ideal, i mbaj mend, - lavdërohej ai.

- Cila të ka pëlqyer më tepër? Hë më thuaj! Të paktën një episod të vetëm më përmënd.

- Më tepër më kë lënë mbresa të pashlyera ajo pjesë letrare ku përshkruan trimëritë e atij sekretarit të parë kur e detyron mbretin të abdikojë nga fronin për të shpëtuar kokën e tij.

- E mirë, por faktori vendimtar i çlirimit të atij vendi dhe likujdimi i atyre mbeturinave të rrezikshme për pushtetin e

ardhshëm të punëtorëve e të fshatarëve ishte vetëm ushtria e kuqe. E kuptove mo? Më vonë koha na tregoi se ai (si të gjithë sekretarët e tjerë të partive motra) s'e kishte për turp të ulte e të ngrinte çdo flamur tjetër. Punë agjentësh. Prandaj nuk kisha se ku të shkoja për pushime.

- Të gjitha këto agjentura të huaja të çdo ngjyre e të çdo rryme, si thua dhe vetë, as të tundnin e as të preknin. Si e shpjegoni? Këtu dua ta di.

- Kur t'i hedhin njerëzit një sy këtyre letrave, atëherë do të dalë në dritë e vërteta e madhe përse s'më prekën e përse s'më tundën, jo më parë.

Enigma është kokolizur me një nyje shtjegëzë.

I juaji përherë.

XIX

Vendi ynë - Kështjellë e pathyeshme

(Më duhet të mbaj mbi supe fatet e revolucionit botëror, prandaj me të mbërritur këtu, lajmërova me anën e agjentëve se do të organizoja një seminar apo një bashkëbisedim me krerët e partive (të rindërtuara)

Ata u mblodhën si korbata pas kërmës.

Pyet i rindërtuari brazilian:

- Ju jeni i vetmi teoricien, fanar ndriçues që muarët çështjen e çlirimit të vendeve koloniale dhe e çuat atë tej e më tej. Unë dua të di cilat janë tri kardinalët e katër klasikëve?

- Kjo pyetje parashikohet në temën e sotme.

Kardinalët janë:

Revolucioni proletar dhe diktatura e proletariatit;

Roli i masave dhe kulti i individit;

Ndërtimi i socializmit dhe Lufta e Klasave;

Pyet i rindërtuari uruguajan:

- A ka mundësi të na freskoni trutë me citate nga katër klasikët?

- Pyetja qëndron me të dy këmbët se ata janë aktualë edhe për të ardhmen.

Klasiku i parë ka thënë: "Antagonizmi ndërmjet borgjezisë dhe proletariatit do të mbetet luftë klase, e cila, e çuar deri në shkallën më të lartë, është një revolucion i plotë".

Klasiku i dytë: "Arma me të cilën borgjezia përmbys feudalizmin kthehet tashti kundër saj. Ajo krijoi dhe farkëtoi ata njerëz që do të drejtojnë këtë armë, - proletarët". Besoj se

më kuptoni?

- Vazhdo se na kënaqe, e kjartë! - u përgjigjën ata.

- Po mirë, klasiku i tretë ka thënë: "Detyrat e diktaturës janë një mijë herë më të vështira e më të kokolisura, të ngatërruara e të ndërlikuara, se sa detyrat e "opozitës" e cila kërkon të shtrëmbërojë aqë shëmtuar detyrat e kllasës pararojë".

- Të lumtë se na freskove memorien.

- Mos më ndërprisni! Kllasiku i katërt tashti: "Socializmi ndahet në tri rryma: në reformizëm, anarkizëm e klasizëm shkencor. Reformizmi mohon luftën e kllasave dhe revolucionin, ndërsa socializmin e quan qëllim tepër të largët. Guri themelor i të parit është çlirimi i individit si kusht kryesor i çlirimit "të masës", ndërsa guri themeltar i të dytit, është çlirimi i "masës" si kusht kryesor i çlirimit të individit.

Doni citate të tjera nga doktrina ngadhënjimtare e kllasikëve?

- Jo, jo ...ata kanë perënduar, kanë vdekur e kanë shkuar. Duam nga ty të zhveshësh shpatën dhe të na tregosh situatën!

- Mirë mo të drobitur, shpata është vërtitur.

Pyetje e të rindërtuarit haitian:

- Ajo shpatë e xhveshur kujt duhet t'i presë kokën më parë?

- Armiku numër një i njerëzimit është imperializmi amerikan, prandaj demaskimin e revizionizmit modern do ta fillojmë atje. Ata nën pretekstin, gjoja, të ndryshimit të kushteve historike dhe të zhvillimeve të sotme të lëvizjes punëtore, i shpallën klasikët të vjetëruar. A plaken ata? Asnjëherë. Teoritë e tezat e tyre i quajnë si një sistem dogmash pakuptim dhe skema të ngurtësuar. Po fikin flakën e antagonistëve kllasore.

Dëgjohen duartrokitje frenetike.

Partia jonë dhe të "rindërtuarat" tuaja, duhet të ruajnë parimin bazë se përsa kohë që në barkun e shoqërisë njerëzore do të lëvrijnë frymorë të kllasave të kundërta aty pa tjetër do të zhvillohen beteja të ashpra e të armatosura. Ky bark i mbarsur do të pjellë revolucionin botëror.

Duartrokitje të zgjatura.

Mos më ndërprisni ligjëratën, se sipas atyre, socializmi lindka nga ndonjë fatkeqësi e madhe apo nga ndonjë katastrofë. Ata duke injoruar dialektikën deklarojnë se komunizmi na qënkërka amerikanizimi i shekullit të XX-të. Revizionistët e këtij kallëpi na lëshojnë thirrje që t'i braktisim të katër kllasikët.

Dëgjohet zhurmë dhe fishkëllima të pandërprera.

Pyetje, delegati i "rindërtuar" ceilonas:

- Më tutje ku duhet ta drejtojmë majën e shpatës?

- Revizionizmi më i rrezikshëm është ai sovjetik, sepse është ideologji sunduese e një partie në pushtet. Denigrimi i tyre erdhi si pasojë e kalimit të detashmentit pararojë në "parti të të gjithëve" dhe shndërrimi i diktaturës së proletarëve në "shtet të të gjithëve".

Pyet i dërguari i rindërtuar anglez:

- Kë do të godasi tehu i shpatës së xhveshur?

- Revizionistët trupshkurtër kinezë deklarojnë me mburrje se ideja e tyre është kinezimi i të katër kllasikëve të marrë së bashku. Ata thonë se kalimin në socializëm s'e bejnë pa u sosur një etapë kalimtare e ekonomisë së tregut të lirë.

Të qeshura dhe fërshëllima.

Mos më pengoni, prandaj paralel me sektorin shtetëror ka ndërrmarje vetiake. Atje lulëzojnë njëqind ide, njëqind e një shkolla, e njëqind e dy kurse.

Dëgjohen të qeshura.

Pyet i rindërtuari i dërguar nga Kongo:

- Pa e ngjeshur shpatën, kundër kujt të godasim më parë në Ballkan?

- Do të godisni revizionizmin jugosllav, i cili mohon rolin udhëheqës të partive komuniste dhe punëtore duke likujduar ato nga të gjitha fushat e jetës.

Ata ngritën frontin mbi partinë dhe ...

- Kjo është e qartë mos e lodh frymën kot, - tha Kongolezi.

- Duam të godasim me top jemi që jemi në Evropë. Kë më parë?

- Vërejtje me vend më të lumshin mendtë - iu përgjigja unë.

Kur carët e Kremlinit hidhnin baltë mbi kapotën e kapelen e shefit të proletariatit botëror, revizionistët italianë qenë të parët që brohoritën atë gjest të shëmtuar. Ata ngrenë lart një flamur të grisur të integritit paqësor, kurse çështja e triumfit të revolucionit kërkon terror; kryengritje të armatosur, ta merrni pushtetin me dhunë.

Pyet i ardhuri i "rindërtuar" nga Srilanka:

- Tjetër fushë demaskimi në Evropë, ja me shpatë, ja me top.

- Partia komuniste Franceze, krerët e së cilës jetojnë në një ambient politiko-ideologjik, borgjezo-revizionist po përkëdhelin kompromisin historik. Kjo parti duhet numëruar social-demokrate, sepse u kthie te pozitat e vjetra të 20-ës duke braktisur me dashje revolucionarët të Komunës së Parisit. Të përsëriten ato kohëra të lavdishme. Kjo është çështja!

Pyetje: Unë jam i rindërtuari tanzanian e dua të di për P.K.Spanjolle?

- Komiteti Central i saj formuloi një platformë të paj-

timit Kombëtar pa kaluar as 20 vjet. Të kalonin të paktën dyqind e dyzetë.

Duartrokitje!

Ata bashkuan dy formacionet kundërshtare duke gjetur oportunitizmin më vulgar ndaj partive të tjera borgjeze.

Poshtë oportunitizmi! Trokasin këmbët.

Pyetje, me gjithëse je në moshë të thyer as këtë herë s'ke për të na gënjyer, unë dua të di se sa e ashpër duhet të zhvillohet lufta kundër eurokomunistëve? Jam shumë i shqetësuar.

- Cilën parti të rindërtuar përfaqëson ti që më shqetësohesh për Evropën?

- Të rindërtuarën e Kamerunit - u përgjigj ai.

- Eurokomunistët valëvisin flamurin e rreckosur kundër kllasikëve gjenialë, duke deklaruar me mospërfillje se i kanë kapërcier.

Për ata proletariati botëror ka hirë në vrimën e historisë sepse "shoqëria e konsumit" nivelon kllasat. Shtetin borgjez e prokllamojnë si mbikllasor. Për më tepër kanë trilluar teorira qesharake me lodra fjalësh:

- A bën pjesë arti në strukturë apo në superstrukturë? A është letërsia ideologji? A është internacionalizmi apo jo racizëm klasor? Nejsë.

Materia e tyre trunore thotë se po, sepse të sundoka partia në art e në letërsi do të thotë se atje sundon ideologjia, mungon krijimtaria, frymëzimi dhe liria.

Dëgjoheh të qeshura.

Pyetje - jemi që jemi në Evropën perëndimore a se zbrazim dhe një bombë dore?

- Kur terrori shpërthen e kuqja ngadhjnen. E kuptoni?

- E kuptojmë. Ne do të shtrihemi në të pesë kontinentet. A kini fonde të na mbuloni?

- Parti e gjithë bota! Shtrirja e terrorit-vigjilja e revolucionit!

Kuçedrat, të cilat dëgjojnë uturimën e të gënjerëve të pënuar na shpërndajnë; nga sytë këmbët, ia mbathëm ne.

I juaji përherë.

XX

Po prekët presjen, do tronditen truporet

Mitologjia e luajtjes së kokës së buallit, (si shkak për rënien e tërmeteve shkatërrimtarë) nuk është gjë, në krahasim me shkatërrimin nga luajtja e një presjeje, prandaj mo, e luani atë!

Lëreni atje të pluhuroset, le të kërruset më tepër, sepse një presje e prekur mund të tundë një fronë, një mbretëri, një dinasti, një imperatori apo tërë rruzullimin!

Po në qëntë thënë, që të digjet ajo bashkë me shkrimet e mia, u bëftë hi; por ju me dorën tuaj mos e luani, lëreni të rrudhet e t'i dalin thinjat aty ku e lashë unë. Në të kundërtën, dënimi rëntë sot mbi ju! Do ta kujtoni këtë fjalën time. Kështjella është prej rëre dhe bie po luajtët kokërrizat e saj. Mos gërmoni themelet e përgjakura të ngritura me zverqe të armiëve tanë!

Teoricienët, historianët e fillozofët e mij në situata të ndërlikuara, të mbështeten te veprat e kllasikëve.

Mbrëmë, sapo u shuan zjarret e ulurimat dhe s'ndiheshin gjallë të dënuarit, më avitet një i vdekur s'avan pa xhveshur. Unë i jepja shenjë të më afrohej se e njoha me të parë.

- Edhe ti këtu? Kur paske zbritur?

- Atë javë që u shëmbën statujat e shefit të proletariatit borëror, - më shpjegoi me një frikë të dyfishtë.

Ai u zbeh e po dridhej si purtekë, kockë e thyer përgjysmë.

- Ç'më thua more? Në s'pe ëndërr, më thuaj saktë ç'di? Apo të mbërthyen ethet e je në përcartje? Ç'ka ndodhur? Ç'po ngjan sipër? Foll!

- Në të gjitha vendet e lindjes, pa përjashtim, partia mëmë e të bijat i ndërruan programet dhe mbiemrat e tyre.

- Më parë më kallëzo për partinë tonë, nuk më duhen të tjerat.

- Po prit, më lërë të flas...

- A e kupton se ç'po më thua? Rrëzimi i truporeve të tija është një paralajmërim për rrëzimin e monumenteve të mia. A e ke menduar këtë të vërtetë?

- As më ka shkuar mendja tek të tuat.

- A e ke kryer shkollën e partisë? - e pyeta.

- Siurdhëron, e kam kryer.

- E ke kryer dhe s'më di t'u bësh një analizë të thjeshtë këtyre fenomeneve?

- Jo, se mbi pllakën tënde është shkruar një datë e vetme. Përse ndjell ters? Ti je i pavdekshëm dhe përtej varrit.

- O molomën, po ç'vlerë ka data kur fluturon pllaka?

- Po pse të shkon mendja tek të tuat, ato mbrohen me dekret. Kush guxon t'i prekë ato? As me pupël as me daltë.

- E di ç'ke? Shko e fli se je trullësuar nga pagjumësia e nuk të kuptoj se ç'po flet. Pupla dhe dalta - lufta e dy të kundërtave.

- Po pse të fle? S'dua, s'të le vetëm. Kë ke këtu veç meje?

- Po ndoshta je në hallucinacion. Ti vuan nga somnambula e po më fjalos fantazi të trurit tënd të sëmurë. Shko fli e pastaj më rrëfe ç'di dhe ç'ke parë. Ndoshta më sheh mua në ëndërr e ma tregon nesër i qetësuar.

- Tani që të pash nuk kam mall të të shoh në ëndërr as kam dëshirë të të tregoj ëndrra, por do të rri zgjuar pranë teje.

Përse s'ke besim tek unë? Jam yti sot e përgjithmonë.

- Do të të besoj një detyrë, për çështjen time ose të partisë. Një është.

- Jam betuar të të shërbej deri në vdekje e mbas saj deri në gjyqin e fundit.

- Ashtu të lumtë! Je bir i denjë i partisë. Dëgjo! Shko vrap te portali i skëterrës dhe të parin të vdekur nga tanët këtu ma sill. Bëhu erë. Partia ju lindi, ju rriti, ju edukoi, nëpër shkolla ju mësoi. Ajo sot ka nevojë për ju.

- Po vetëm të të lë? - S'i ndahej shpirti nga unë.

- Kjo detyrë është detyrë mbi të gjitha detyrat që të janë ngarkuar ndonjëherë në jetën tënde si ushtar i partisë.

Më nderoi me grusht e më s'e pashë. Por fjalët e tij më oshëtinin. Kanë rrëzuar statujat e tij?! Analizoj: dy opsione për një subjekt. Jo, s'është lajm i vërtetë ky! Ndoshta do të kenë luajtur ndonjë presje pasuesit e mi nga parimet Universale të kllasikëve? S'ka tjetër shpjegim. Kjo bela na duheshe!

S'po vjen ndonjë vdekësirë tjetër të mohonte këtë të thënë.

Sa të gjata qenkan orët e pritjes! S'dua ta besoj! O djaj, më largoni këto mendime të errëta. Si më gënjeu ai fjalaman-gojëzbërthyer? E? Po si s'e rrëmbeka vdekja me thonjtë e saj ndonjë nga kuadrot, se tek ata s'do të dyshoja. Në këto çaste tragjike edhe një të gjallë të më kishin dërguar, e vlente. O forca të errëta më ndihmoni si gjithmonë! Po ç'flas kot? Zëri im është një uturimë në shkretëtirë. Askush s'më dëgjon këtu.

U ula, e mbështolla kokën e rëndë me duart që më dridheshin, e rashë në meditime të turbullta nga lodhja. Nëse do të jam atje, siç jam tani këtu, punët do të venë ca më keq se dikur, prandaj duhet penguar me çdo çmim rrëzimi i monumenteve të atij. Përse shtangën shtabet? Ç'vlen fitorja

jonë po ta humbasim kur e dimë se s'e fitojmë dot prapë? Kjo është çështja.

Me vdekjen e themeluesit, trashëgimtarët fortifikojnë themelet. Le të dergjen të mundurit në verigat tona. O grykë e varrit tim! Lësho një ulurimë! Flaka të flakërojë.

Fryn stuhi e xixave, dëgjohet muzikë, afrohet grupi i këngëtarëve:

Një tirani i shkrepri në kokë,
Të ngrejë një kështjellë prej letre;
U gërmuan tunele nën tokë,
Dhe bunkerë si gunga-breshke.
Nëpër sheshe ç'na nxirronte,
Idhull'i tij në bronx derdhur;
Toka dridhej se më s'duronte,
Sot nga piedestali e paskan hedhur.

Ja mbërijnë rojet e nëntokës, e i shpërndajnë.

Dale! prit, ç'më dëgjuan veshët? Si është e mundur? U plotësuan parashikimet e shtrigave. I paskan sheshuar truporet e Atij! Sot e kanë hedhur?

Si s'po vjen ky vdekësirë? Ja, dëgjoheh çapa të shpejtuara, jo kaloi, nuk paska qënë ai. O humbëtitirë e shkretëtitirës. Ku m'u shpife ti ngathësirë!

- O skëterrë. Strehë e streseve të mia, pa më vështro njëherë drejtë. Dyfish i egërsuar jam, prandaj të kërkoj të m'u japësh ndjenjave zemër dhe zërit kumbimin e dikurshëm, se sot është një natë e kobshme! Ndizi zjarret e shuar e të përvëllojë flaka gojëlubi anë e mbanë.

Në këmbë të mitë. Detashmenti në rrezik, zuska e zuzarë, horra e gënjeshtarë, gjithë ç'janë, përse heshtën sonte? Le të rreshtohen përsëri, partia në ballë!

Por ah medet! Unë s'e kam atë gjallëri që të më ndizte lakmitë e reja. Mortja m'i shteri ato para kohe, prandaj kërkoj

pavdeksinë. Dua t'i bashkoj shtatë tmerret e ferrit e të kthehem në kufomë-fantazmë shtatë net mbi dhé. Fatit dhe famës time prapë t'i jepja jetë!

Mua kjo s'më besohet. Ç'janë këto gjepura të paqëna? Monumentet e Atij janë të paluajtura. Shpifarakët! Dora e reaksionit të brendshëm është paniku.

S'i s'më sollën një lajm xhanëm. Elementë të paformuar! Të mos u bëhet vonë për mua?

Në të vërtetë, sipas gjurmëve, ai ishte kthyer pas mesnate, por mua më kishte pushtuar gjumi i madh për të mos u zgjuar kurrë më. Natën e dytë vjen i kërkuari që përpushej e përdridhej. Ai heshte se s'guxonte të më tregonte.

- Tashti hapja zemrën nënës par...

- Ou! È? Pse këtu qënka nëna? - më pyeti i befasuar.

- Cilën nënë kërkon, këtu? përpara meje?

- Atë, nënën time! Ajo më ka lindur, - u përgjigj i magjepsur.

- Këtu mos kujto atë që të polli, po atë që të rriti e të edukoi me gadishmëri të lartë, - e qortova aty për aty, - sa shpejt i harrokeni mësimet e mia!

- Jo se i kam harruar, por më janë ngatërruar duke udhëtuar për në këtë të përtejmen e shkretë.

- Ai korrieri tjetër, përse nuk u kthye këtu?

- Gjer te rrethi i gjashtë rrugëtuam bashkë. Aty na i preu udhën një i çakërdisur, i veshur me një xhaketë austriake me komça rumbullake, mbi kokë një kësulë të errët pa strehë. Na vërente nga koka te këmbët ma ata sy që i lëviznin të shqetësuar, nën vetulla të zverdhura. E kur iu lëkundën ato mustaqe të zgjatura dhe ajo mjekrra e shpupuritur, na mbërtheu për gryke.

Po përse ju pengoi? - më shtyu kërsheëria.

- Posa këtu nuk përdoren emra, ai as tregonte se kush ishte,

as se kë kërkonte, por kuptuam se pyeste për ty.

- Ç'donte nga unë? - iu përvësua papritur.

- Atij i kërkonte Këshilli i Djajve të rrethit një deklaratë prej teje, me anë të së cilës të dëshmonte se ai nuk kish qënë një boshibozuk xhonturk që ish dënuar për vrasje, djegie e plaçkitje, por një udhëheqës i shquar ushtarak popullor i kryengritjes më përparimtare të fshatarësisë sonë për liri dhe tokë. Thoshte se me atë posullë ai shpallej i pafajshëm nga gjyqi i fundit dhe menjëherë, dilte që dilte nga skëterra, hynte në histori përhera.

- E marr me mend se kush do të jetë ai. A ia treguat adresën time?

- S'e besoj. Ti dhe kur ishe gjallë këto strategji e taktika përdorje për t'u mbrojtur nga armiku, ndërroje pseudonime, profesione e vendqëndrime.

- E,e,ç'i numëron heroizmat e mia. Mua tashti s'më lënë zilet e mia të dëgjoj këmborët e të tjerëve. Por, po të rishikohet ndonjëherë historia që shkruam, do të na mbeten vetëm dëshmorët e luftës çlirimtare. Ku mbeti ai tjetri? - e pyeta.

- Epo ja ndërkohë, drejt nesh po nxitonin dy nga ata rebelët. Unë ia mbatha po më larg ndalova, se po më shterte fryma. Ktheva kokën dhe pashë se atij po i hipnin në shpinë dhe e fishkëllonin nga koka e nga vithet.

- E, se vjen kur ta lirojnë, po hë na fjalos tani: Ti vdiqe nga frika apo të preu malli për mua?

- Ç'të të kallëzoi më përpara, as unë vetë nuk e di se si vdiqa, s'e përcaktoj dot, por di të them se po ndodhin ndryshime të ndërlikuara në vendin tonë, në të gjithë partitë motra e të vendeve vëllezër.

- E mirë, i kam dëgjuar këto. Të kam thirrur për të raportuar për truporet, - e shkunda sa munda.

- Siurdhëron. Prandaj erdha me qefin krahëve, me një frymë nga porta e skëtërrës e gjer këtu.

- Hë se ke kohë të shlodhesh. Më kallëzo, për statujat. A u dëmtuan apo shpëtuan?

- I çpuan çaçkën me daltë, e mbushën me dinamit brenda, në qafë i varën gjerdanin ndezës. Ata kaluan matanë. Prej asaj një mijë copa u shpërndanë...

- E, mo, se do kenë qënë huliganët e hipitë, rezerva të armikut të kllasës.

Midis nesh ra heshtje varri në atë natë të pasosur.

I juaji i paharruar.

XXI

Lemza: Fiziologji, telepati apo bestytini?

Bebet i këput lemza kur janë në djep. Kush i kujton? Ndoshta gjyshet e largëta. Nusët e reja gjithashtu i nget lemza sa i turpëron. Kush i kujton? Ndoshta njerëzit e saj. Mua, atë natë, m'i zbërtheu brinjët lemza. Kush më kujtonte vallë? Vrisja mendjen ta gjeja në se qe një ngacmin i gypit tretës. Ndoshta do të ketë dalë nga lukthi ndonjë shuk bargulli që trokiste të kthehej përsëri brenda? Apo ishte një sinjal që vinte nga përmendja e emrit? Përse më kujtonin? Kush më përmendte?

Në se vërtetohet, njëra nga këto thënie, atëherë bestytinitë nuk paskan asnjë vlerë, mbeturina nga e kaluara e errët e njerëzimit. Mirëpo gruri i krimbur zjerë e pa zjerë, u blua dhe u tret, ndërsa lemza s'po më pushonte. Vendosa të rri zgjuar duke pritur gjer në pisk të asaj nate, për të vërtetuar të dytën, në se më kujtonin.

Por për çudi, më kishte zënë gjumi i parë, i rëndë si i vdekjes që ishte. Më tund e më shkund, zgjohem, çohem, i afrohem. Ai më largohej. Ishte tepër i alarmuar. Ç'të kishte ndodhur vallë?

- Hë mo fol. Kush të dërgoi tek unë që më vjen pa më lajmëruar, me qefin mbuluar?

- Po përmbysët bota komun...

- Bota dhe Europa u përmbystë, partinë ta kemi të patundur në parimet e saj.

- Po ndodhin ndryshime të mëdha e të ndërlikuara. Ti na le në kapërcyell të asaj epoke dhe re për të mos u ngritur më kurrë.

- Kush ra? Nga ra? Kush e rrëzoi? - e pyesja kot si për të larguar lemnën.

- Nuk e kuptuam se kush e rrëzoi, por e pash se ti re, - më shpjegonte ai gjithnjë edhe më i alarmuar.

- Po mirë mo, le ta ngrenë prapë. Për këtë vjen të çmendësh skëtërrën në mesnatë?

- Ky nuk po më kupton, qënka matufepsur më tepër, si t'ja them si mos t'ja them... - po mëmëriste ai më i alarmuar tek s'mbante më.

- Fol me zë të lartë, se nuk të dëgjoj mirë. Ç'po pëshpërit ashtu? - iu afrova më pranë. - Se sa vjet i vdekur ç'bëra unë pa u tretur?

- Sa u trete ti për gjashtë vjet, unë jam tretur për gjashtë net, sepse as guxoj të të gënjej e as kam gojë të të rrëfej.

- Trego ç'ka ndodhur. Mos është sëmure ndonjë nga të byrosë?

Fol! Mos më rri si mumje allçie se ke qënë militant partie. Unë e di se pas humbjes sime s'ka mandatë më të hidhur për partinë.

- Jo, ata shëndoshë janë të gjithë edhe të kujtojnë, - më thoshte me gjysmë zëri.

- Më rrëfe se ç'u ka ngjarë? Përse më mundon? Kush më përmënd?

- Të gjithë të përmëdin. Ata sikur mbinë nga dheu. Mijra e mijra u grumbulluan, djem e vajza, burra e gra, pleq e plaka, nga të gjitha shtresat e shoqërisë dhe thërrisnin: "E hodhëm! E hodhëm! E hodhëm diktatorin!"

- Endërr po rrëfen mo, ë? - me syhapët e pe?

- Jo s'qe ëndërr, qe një revolucion i vërtetë.
- Ç'më thua, revolucion? Ai është i papërsëritshëm.
- Epo të them kundërrevolucion? A e pranon?
- Si? Qe kundër revolucion? jo, jo, se s'mjafton.

Jo jo, s'mjafton një thirrje për të hedhur përtokë një emer një famë, një lavdi.

- Për ideal, vetëm një thirrje. Brohoritën të gjithë:
"Poshte diktatori!"

- Si s'dha mesnata kushtrimin e të kumbonte alarmi i luftës, të dëgjohej buçima e topave e kërkëllimë e mitrolozit dhe pa përmëndur ylli i mëngjesit ushtarët të mblidhnin kufomat e djemve kokëkrisur!? Le të qanin nënat, motrat. Sytë e partisë të mbeteshin pa u përlotur. Në pellgje gjaku le të rrënoqethej turma e hutuar.

Të gjithë ata që psherëtitën për vdekjen time të vajtojnë për truporet e tija se s'qe lodër kalamani ai strateg.

Ndërkohë ia mbërritën të gënjerit e penduar, kori e valltarët. Filloi muzikë:

Kori:

Në kult një sharlatan, sharlatan,

Valo, valo kazan.

Rrethuar me zemër katran, katran,

valo, valo kazan.

Ujq e ulkonja ulërijnë, ulërijnë,

kazan valo, valo!

Kryekopukun e kërkojnë, e kërkojnë,

kazan përvëlo!

Bjer tërmet anëmbanë, anëmbanë,

valo, valo kazan.

Buçit me tërbim Oqean, Oqean,

valo, valo kazan.

Nga dhimbja qajnë me lot, me lot,

kazan valo, valo.

Shëmben idhujt përtokë, përtokë,

kazan përvëlo!

Vijnë kuçedrat me uturimë dhe i shpërndajnë të gënjerit.

- A e dëgjoje vargun e fundit? - më pyeti ai. -
"Shëmben idhuj përtokë".

- S'dëgjoj mirë nga veshët. E kanë fjalën për kllasikët?

- S'di ta shpjegoj, po monumentin tënd ...

- S'po të pyes për të mitë po për ...

- Po s'qe punë për katër kllasikët. Një gjigand i vetëm i pa përballuar e i papërmbajtshëm iu vërsul monumentit dhe e rrëzoi për tokë sa të numërosh një, dy, tre. Pasi e qarkuan me kavo, e lidhi te kamioni dhe e goditi me leva e çekanë sa teproi vetëm koka, të cilën e varën te qyteti i studentëve.

- Paska qënë ëndër e gjatë mo, - u nervozova unë.

- Jo nuk qe ëndërr. Për ideal e pashë me sy çelët.

- Po përse koka e shefit të proletariatit botëror nga tekstilistët të varej tek studentët?

- Ai që mendon ti, është shkukur më parë. Koka nuk qe e atij, qe koka jote, - më tha e u përmallua sa s'qante.

- Mu zhduk këtej o drej, o djall, do të të godas a të shqyej të gjallë.

I ngula thonjtë në grykë i pikëlluar, se pasi t'i zbrazja mushkëritë nga ajo pak frymë, t'ja nxirrja atë shpirt. E xhvata prej qefinit dhe e vërvita jashtë në hapësirën e zezë që sterronte atë natë si penda e korbit.

S'ka rënë deri më sot ndonjë lis pa iu kalbur rrënjët. S'ka mbetur shkretë ndonjë kështjellë para se të kthej në gërmadhë; as ndonjë anije nuk ka humbur në det të hapur pa iu grisur velat; a një vabor të jetë mbytur në oqean pa iu çarë

barku. Unë s'di ta shpjegoj këtë Katastrofë të papritur.

Lemza tani më kishte pushuar, por, xhindet më kishin pushtuar. Doja të shkyeja vetëvehten. Statujat e mia, të madhërishmet, ishin thërmuar.

I juaji i paharruar.

XXII

Primitivët ngulmojnë të më dënojnë për shfarrosjen e fiseve pasardhëse

Në jetën e përtej varrit qëlloka herë pas here një përputhje me zakonet e atyshme të vendosura ndoshta gjatë shekujve. Këmbimi i banimit të vjetër me shtëpinë e re edhe këtu paska ogur të caktuar. Një natë nga netët e panumërta mua më muarën nga banimi i mëparshëm e më sollën pranë portalit gdhëndur si shtylla në shkëmb. Aty qëndronte themel-patundur ky simbol i errësirës dhe nuk fliste, po heshte. Për të flisnin ceremonitë festive që bënë kur shkela për të parën herë pragun e shkretë.

Vendi shëmbëllen me një kaush anë e mbanë në tunxh derdhur. Gërhitja e derës-zgarë, e metaltë, zgjonte të fjeturit. Ajo më trëmbi gjumin e rënduar.

- Çou! Jam ngarkuar nga Komiteti Qëndror i Djajve të të njoftoj se do të qëndrosh treqindetridhjetë e tre net i vetmuar larg nga frymët e mekura. Kështu kaluan netët e pafundme të vetmisë ... pothuaj një vit.

U dëgjua shkrehja e shulave të ndryshkur në plogështi... Njëri nga rojet më lajmëroi, kurse tjetri qëndronte tek hyrja me një pishtar në duar.

- Ngrehu shpejt, shpejt se duam të fitojmë kohën e humbur. Mbështill mirë hartallet e tua dhe eja me ne.

- Ku do të më dërgoni? - e pyeta i tronditur.

- Nga të na shpien këmbët e nga të na thotë koka.

Ashtu ngjau vërtet. Në mes të tavolinës zyrtare u ngrit

krye-gardiani, ndërsa të tjerët s'ndiheshin gjallë përpara tij.

- Të gjithë ata, që trumbetojnë lartë e poshtë nëpër skëterrë, e ëndërrojnë, sajojnë apo kërkojnë me paturpësi pavdekësinë, ne jemi të gatshëm t'i nisim për gjykim në të gjitha etapat e shoqërisë njerëzore jashtëkohore, larg prej këtej.

- S'pranoj gjykim. - kundërshtova unë.

- Vendimi ynë ka formën e prerë, - tha kryetari i nxituar.

I dyti foli shefi i sigurimit:

- Dëgjoni: sa herë të përshkojë ferrin ta mbërtheni me zinxhirë por me eufori zhurmuese. Të tremben atentatorët dhe komplotistët se na e vrasin apo na e rrëmbejnë e pengohet gjykimi i tij historik.

Më kthyen përsëri në qelinë e shkretuar, të akullt, ku provova një përdëllim të thellë që s'e kisha ndjerë kurrë në jetë. Mua, sapo u përmënd fjala histori, m'u filmuan tërë ato përplasje të ashpra me egërsirat e xhunglave partiake, lufta e egër për pushtet shtetëror, ato gëzhoja të dashurisë së shtirur për ata që më lavdëronin me pekule të rralla. Më përfytyroheshin gjithë ato grindje me klikat tradhëtare revizioniste me ata farë burra plot grada e dekorata. Ato tronditje kur prisnim e përcillnim delegacione të cilët me siguri vinin për të gëdulisur agjentët e yshtur në çdo sferë të veprimt të tyre, apo ethet e dyshimit kur shkoja jashtë shtetit se mo më punonin rivalët ndonjë rreng. Maskimi nëpër role, qe historia e një libri të gjaktë.

Pas 130 netëve në ankthën e nisjes për gjykim, erdhën, më lidhën me pranga e më dorëzuan te porta e daljes nga ferri. U ndodha i lirë në një botë të panjohur, e cila s'përkonte me të dytën as me të tretën. Një zë më përmendi nga kjo shtangie.

- Je në botën e parë burimore, në zanafillën.

Dhjetë vjet në errësirë, në dritë, nuk mund të shihja mirë. Kthej kokën djathtas dhe majtas: dy djem shtatëlart, unë ndodhesha në mes tyre. U nisëm për udhëtim. Trupi i tyre ngjyrë bronxi mbulohej në pjesën e poshtme, me rripa prej lëkure kafshësh të egra që ia përshkonin kryq e tërthor, në duar mbanin sëpata të gurta, mjekrra e flokë të gjatë i hijeshonin këta njerëz të lashtësisë. Udhë gjarperonte nëpër kodrina të blerta. Njëri i tha tjetrit:

- Duhet të sosim në sinoret tona para se t'i mbledhë të artat rreze kalorësi qiellor.

U gjuhëzuan në drejtim të diellit duke përshpëritur lutje. Ata sa s'fluturonin, unë mbeta. Pushuam. U nisëm përsëri. Në muzgun e murrme, mbërritëm. Qentë e tufave më ndjenë erën e filluan të lehin, u afruan e donin të më shqenin. Qëndruam përpara një kasolleje të banuar. Prej saj doli menjëherë shoqëruesi im. Ai më lidhi me zhukë duar e këmbë pas një lisi buzë përroit gurgullues. Xixëllonjat lajmëtare më treguan stinën.

Nata s'kishte të sosur. M'u kujtuan vuajtjet e luftës, megjithëse ndonjëherë më këmbë s'kisha fjetur. Agimi po zgjonte majat e zbardhura të maleve e u dëgjuan zërat e kthjellta mëngjesore.

- Ku do më shpini, more djem?

- Te sheshi i kuvendit të bashkësisë fisnore.

- Të kisha shlodhur gjunjët të paktën, të ulesha.

- Do të të ulim në një gur të caktuar, po eja pas, se pak udhë është deri atje.

Anëtarët e komunës i kish pushtuar vrulli i punës e nuk më diktuan. Unë s'e konceptoja dot këtë lloj komunizmi. Burrat rrëmihnin arat me vegla të gurta, gjahtarët kishin thërrur një dre e po e rripnin, tre gra të cilave vetëm flokët ua fshohin sissat e bëshme, po shinin me shkopinj kallzat e grurit, një zej-

tar po gdhendte një kockë shpendi në formë grepi; më afër meje një djalkë po pikturonte një enë qeramike me degë të kuqërremta e fletë të gjelbërta, ndërsa më plaku, rapsodi i këngëve, melodinë e një motivi me gjethe ulliri fërshëllente ëmbël.

Kuvendi lajmëroi fillimin e mbledhjes sa po të gjithë u gjendën aty. Ra heshtje. I pari foli kryeplaku i bashkësisë:

- O gjind të nderuar, burra të lartë e gra të urta, o djem e vajza të mira dëgjoni ç't'ju them. Gjyqi i historisë ka dërguar ndër ne këtë turp të racës tonë lavdiplote. Ky makut ka kryer gabime të pafalshme e krime të përgjakta mbi pasardhësit tanë të denjë. Ne në mbështetje të kanunit tonë do ta dënojmë rëndë këtë vepër të shëmtuar që të mos përsëritet ndër brezat e ardhshëm.

Midis tyre, pa grada e stolira, u ngrit mendimtari i fiseve:

- A i di ti cilët janë paraardhësit e tu ?

- Paraardhësit tanë janë majmunët, se shoqëria njerëzore e ka origjinën nga kopeja e tyre.

- O i paudhë, vepër e lugatit të mallkuar-thirrën njëherësh e u vërsulën duke tundur në ajër sopatat e gurta drejt meje.

Urdhëri i kryefisnorit i qetësoi, ulën armët e qëndruan nëpër vende.

Mendimtari vazhdoi: - Ti o rrenacak ke mashtruar atje, por këtu nuk t'i pranojnë ato gënjeshtat.

Lidhja me majmunët është thjesht natyrore./Epërsia jonë shpirtërore është frymë hyjnore/Ne lindëm pa përvojë e pa trashëgim/atëhere si ndërtuam vetë bashkësinë?

Unë mbeta i mahnitur. Si t'a shpjegoja? Ata shpreheshin në vargje:

I treti foli historiani: - Ja psraardhësit tanë pellazgët.

bashkë me lelegët, kaukanët më vonë me aljanët e më pas helenët, herë qëndronin, herë shtegëtonin në këto hapësira ballkanike prej ujrave adriatike e gjer te pellgu i Egjeut. Pellazgët ishin fise më të rëndësishme ndër ta, për këtë të vërtetë dëshmon "Iliada" ku ne përmëdemi si banorë të Thesalisë, të cilët luftonin me trimëri në krah të trojanëve, por edhe te "Odisea" janë kretanët e paepur në kërkim të Itakës. Bashkë me muret e këshjellave lanë trashëgim qytetet e begata si Larisa, Agro, Tyrenë, Gortuna. Këto shpjegime i kam nga gjyshi i cili jetoi më se 120 vjet. Zbulimet do të flasin më saktë.

I fundit më pyeti gjykatësi:

- Në një dritë qiellore nga hyu na vjen,
secili lumturinë në votër e gjen.

Ti përse i shkatërrove familjet? Fiset e mëdha e lidhjet e tyre?

- Familja ishte idil i kotë, i mbetur nga e kaluara. Fiset pengonin shtetin e proletariatit.

Dëgjohen të bërtitura, vërtitja e sëpatave. Prap prapësohen.

Gruaja, zemra e shtëpisë punonte ditë e natë,
ti i mbylle vocrrakët nëpër konakë.

Me sa kemi dëgjuar, ti kudo shkoje, gjithmonë
shkatërroje e i vetëm sundoje.

Paria e bashkësisë caktoi prijësin ushtarak për të dhënë
vendimin e gjyqit:

*Trupin nga varri t'ja kërcejnë,
Me perona në shkëmb t'ia mbërthejnë!
Kthejeni sërish në skëtterrë,
dënuar me vuajtje të pandërprerë.*

Rruga e ardhjes në qeli m'u duk më e gjatë. I tronditur
fjeta gjumin e madh, të molisurin.

I juaji kurdoherë.

XXIII

Kërkojnë të më dërgojnë si kryepronar i tre milionë sklleverve

As netët, as muajt, as stinët e vitet nuk më shlodhnin, qetësia kishte marrë arratinë. Më lajmëruan për udhë. Erdhën rojet e pushtetit nëntokësor më lidhën me hekura këmbët e duart dhe më dorëzuan te portali i skëtërrës ku më prisnin të dërguarit prej rendit skllavopronar.

Si në vegim pashë dy trupa ngjyrë bronxi, rripa të stolisur me kopsa u kalonin kryq e tërthor me lëkurë laramane. Mbi flokët e derdhur një lloj përkrenareje, mbanin nëpër duar rrahtë metalikë e mbas shpine rrinin pranë e pranë në harmore, të shkrehura, harku dhe shigjeta majë vezulluese.

Rruga ishte e shkurtër, me thertore që lartësoheshin përherë e më tepër: aty ku ralloheshin pyjet, dëndësoheshin banimet e hershme të kësaj treve. Ju kërkova pushim sepse nuk mund të ecja më tutje. U ulëm e pushuam në një qëndër zejtarie të punimit të hekurit e të bronxit, në Sesaret, përmëndet si qytet në këtë periudhë. Të varura para punishteve dukeshin harku dhe shigjeta, të çdo madhësie, heshta të çdo gjatësie dhe të rreshtuara më poshtë mburoja, pazmore, përkrenare kallçik me tokëza dhe më në fund pranga për sklleverit.

Sikur dilte nga gryka e një tuneli dhe jehonte maleve goditja e daltave; nxirrej mineral atje. Më andej një formim këmbësorie stërvitej për mësymje, zhvilloheshin gara mundjeje dhe vrapimi, hedhje gjyleje e shigjete, që përçanin ajrin e rrimtë.

Më i shlodhur kur filluam të ecnim, përsëri nëpër një luginë. Perëndimi po zbehte ngjyrën e trëndafilte shpërndarë nëpër retë puplore në atë kupë qiellore. Mbërritëm para errësirës në një kryeqendër ilire. Mua më dërguan në një shpellë të pabanuar, te dera lanë të lidhur një qen të egërsuar që nuk përmbahej, sikur donte dhe ai të më shqyente.

Të nesërmen, kur dielli kish ndriçuar dhenë, unë u ndodha para një pamjeje krejt të papritur. Skllavopronarët të veshur me cohëra të purpurta, kapërdisur nëpër poltronë të drunjtë të gdhëndur me mjeshtëri nga artizanët; atje ku mbaronin këmbët e tyre rrinin anëtarët e thjeshtë nëpër stola të ulët ndërsa të sheshuar mbi një shtresë gjethesh, skllavërit.

Më i madhi skllavopronar i fiseve ilire u ngrit e tha:

- Skëterra na ka dërguar për gjykim këtë sersële të fisit tonë pasardhës.

- U dëgjuan të thirrura : Na tregoni për ç'gabime e faje do ta gjykojmë? Do të dimë t'i japim dënimin e merituar!

- Më pritni pak. Te ne s'u ndje krijimi i rendit tonë shoqëror as do të kuptojmë shkatërrimin e tij, sepse ekonomia vazhdon të mbështetet po në punën prodhuese të bujqve të lirë se sa te skllavërit të cilët u zëvendësuan doradorë me kolonë. Ky makuti këtu në emër të një rendi të ri përmbysi gjithshka që e quante të vjetër.

E vlen të përmend lindjen dhe zhvillimin e vrullshëm të qyteteve tona si Amantia, Bylis, Antigonea të cilët bashkë me kolonitë përjetuan një lulëzim si pasojë e forcimit të shtetit Ilir. Në të kundërtën ky e pengoi zhvillimin sepse ndërtoi degë të panevojme industriale, si i thonë fjalës dhe e bashkoi token bujqësore. Shteti u pasurua, skllavërit u varfëruan.

- Ta dënojmë, ta dënojmë! - ngritën shigjetat lartë.

- Lërmëni të flas deri në fund. Ne qeverisemi prej këshillit ligjëvënës që del prej kojlonet, të cilat si bashkësi që

janë edhe këto vetë zgjidhen çdo vit në mbledhjet qytetare. Tek ne zbatimi i vendimeve rregullohet prej zyrave prytane. Kryetari është strategu i caktuar nga krerët skllavopronarë.

Qysh herët në traditën tonë, familja, gjinia, fisi apo lidhjet e fiseve apo të principatave, e gjer te shteti, i besohej një njeriu që i printe me ndershmëri. Në të kundërtën, ky me dredhi e tradhëti, doli vetë në krye dhe me veprën e tij barbare shkatërroi vendin e begatë dhe vlerat e kombit tënë.

- Të dënohet pa mëshirë, për krime e tradhëti, të kthehet me njëherë në skëterrë përsëri. -Vringëlluan armët drejt meje.

- Porositni në farkë një palë pranga të rënda - urdhëroi skllavërpronari.

I dyti foli historiani:

- A e ke mësuar historinë e të parëve të tu?

- Për mua historia e këtij vëndi fillon në vitin '44, - ia dhashë përgjigjen.

- O ç'poshtërim! O gënjeshtar! - e u vërsulën në drejtimin tim me harqe të tendosura e i shkrehën shigjetat që më vërshelejnë anëve.

Një i moshuar hijerëndë u ngrit midis tyre e tha:

- Historia nuk fillon tek ti dhe s'ka për të mbaruar as aty. A ke dëgjuar për mbretërit tanë: Bardhylin e Enkelejve, mbretin Alketa, Arriba e i biri mbreti Kliti trashëgimtar i Bardhyllit, Glauku, mbreti i taulantëve, Bardhyli i ri dhe miku i tij Pirrua i Epirit, mbretin Mytil. A ke dëgjuar për mbretin e Lidhjes së fiseve Mollose, i cili rridhte nga fisi i Ajakidëve, për Lidhjen e Epirotëve e drejtuar nga Këshilli i fiseve të barabartë me në krye tre strategë? A ke mësuar për mbretërit e Ilirisë, Ardianin, Agronin me Teutën, Skerdilajdin, Pleuratin e Gentin, mbretëri të trashëguara?

Roma donte të nënshtrohte botën dhe e nënshtroi por

jo Ilirinë, tre luftëra detare, por u mbuloftë me turp, emri i njerit nga komandantët e flotës ilire, i cili tradhëtoi.

Oshëtiu ajo luginë grykëgjërë:

- Poshtë tradhëtarët e kombit, poshtë, poshtë! - vringëlluan armët.

- Në trojet tona u dyndën më pastaj plaçkatarët Gotë dhe Hunë, por rreziku më i madh qenë plaçkatarë të tjerë, fiset sllave, që mbërritën në vitin 610. Kështu shkruhet historia e vërtetë!

Më në fund ligjëroi zbatuesi i kanunit i veshur në të bardha:

- E gjej me vend të të kujtoj, o Diktator i Tmerrit, se edhe më vonë kur në shtetin Ilir, Dardan dhe të Epirit u kthyen përsëri mbretërit, pushtetin e mbretit e kufizonte Këshilli i Parisë, i cili përbëhej nga skllavopronarë të zgjedhur. Qytetarët paguanin tribute të caktuara, shërbenin nën armë ndërsa bujqit e lirë paguanin taksa në natyrë dhe angarira, punët e rënda nëpër miniera i kryenin skllavërit sa të përmbushnin dënimin tre deri në pesë vjet.

Pra në mbështetje të padive nga gjyqi i skëtërrës përfundojmë se ti i ke shndërruar pasardhësit tanë në skllavë, i ke varfëruar, i ke lënë pa të drejta, ndërsa vetë ke jetuar si kryeskllavopronar i gjithpushtetshëm.

- Poshtë mashtruesi! Të dënohet, të dënohet! - dhe trokitnin shtizat mbi harqe e mua më fërshëllente ndonjë shigjetë majëmprehtë mbi kokë.

Këshilli gjyqësor u mënjanua për të vendosur dënimin tim. Ndërkohë në kulm të dëshpërimit, unë po sodisja atë qytet - shtet përrallor. Më mahniti përshtatja e atyre ndërtesave me kushtet natyrore të asaj kodrine, rrethinat përputheshin me krijimet. Mure të ndërtuar me gurë të skalitur me mjeshtëri përforcoheshin me tabje e bedena të shumta. Aty

ku lartësohej porta qemerharkuar dhe në sheshin publik ku po zhvillohej gjyqi, ngriheshin madhërisëm statuja mermeri (medet për ato të mijat, të coptuarat!) Këto s'i kish prekur asnjëherë suva e kohës dhe s'kish për t'i prekur kurrë porsa rronin dhe sot që po i admiroj unë por s'ka për t'i prekur as varreja. Nga sytë tanë humbkan vetëm figurat, historia mbetka. Këtë, më mirë se kudo, e mësova këtu.

Zhurma fjalamane u ngjit në ajër, heshtja e rëndë ra nëpër rreshtat e të pranishmëve. Unë i drobitur u ktheva të ulem te guri i dënimit në qendër të Akropolit. U dha vendimi:

Trupin nga varri t'ja krrejnë,

Me perona në shkëmb ta mbërthejnë.

Ta mbërthejnë përjetë në skëterrë,

Ta kafshojnë gjarpërinjtë gjithë vrer.

Më lidhën me pranga e muarëm udhën e kthimit për në banesën e fundit.

I juaji kurdoherë.

XXIV

Duan te me denojne si kryefeudal i mijëra e mijëra bujkrobërve

Të tretën natë, sikur të mos më mjaftonte frika nga ëndrrat që më xhingërisnin, erdhën më përmendën, më lidhën e më nxuarën tek portali i përhimtë. Aty më prisnin dy fshatarakë të veshur me mëngore e me xhamadanë, me tirqe e me xhidike të leshta, në këmbë mbathnin opinga me rretra, belin shtrënguar me brez ngjyra-ngjyra ku vareshin jataganët, në kokë kësula të bardha mënjanuar mbi sy.

Udha e dystë përshkonte qilimin e blertë deri aty ku fillonin kodrat veshur me ullinj e drurë frutorë; Përfund arave të porsa korrura nga thekrra ngriheshin në barikada mullarët trashalugë të kashtës , mulliri buzë përroit gumëzhinte nga blorësit, gomarët pëllisnin, e qentë lehnin pas karvanit. Pasi kaluam dy-tre katunde para meje u shpalos me tërë hijeshinë e tij natyrore qyteti Banjë, qendër artizanale. Në anë ndeheshin punimet qeramike, prej shajaku, pëlhura të pambukta dhe cohëra të mëndafshita; në krahun tjetër punishte të armëve nga delnin shtëllunga tymi erërendë...

Qe ditë panairi, te tregu në qendër shiteshin pushkë me strall e kobure me çark; vegla pune bujqësore, zile e këmbonë.

Gjatë udhëtimit për në kryeqendrën e principatës, takuam me dasmorët, nusja mbi kalë e mbuluar me një duvak flamur - shqiponje. Njerëzit e dhëndërrit, që kishin dalë për ta pritur, filluan - këngë e valle, si folklori i sotëm, por më burimor.

Udhë, përsëri udhë. Nga maja e minares kuptova se qyteti ishte afër, kisha e ndërtuar mbi shkëmb më bindi se më në fund mbërritëm. Mua më dërguan në bujtinën e karakollit. Të nesërmen më shoqëruan për tek amfiteatri tre qehallarë të veshur për të kremte. Çifligarët rinin me salltanet të madh në shkallaret e sipërme, më poshtë zanatçinjtë, në dy skajet bujkërobërit. Në këtë kuvend i pari foli kryefeudali:

- Të nderuar të moshuar, burra e gra, që kini ardhur këtu, ju bëjmë të ditur se jemi mbledhur për të dënuar një farë nga fisi ynë, i cili ka masakruar pasardhësit tanë e ka tradhëtuar çështjen e shtetit të Arbërit.

Dëshirën për mëkëmbjen e një shteti të fuqishëm e të pavarur nëpërmjet bashkimit të fiseve të Vranajve e të Skurajve, të Blinishtëve, të Topijave, të Jonimëve, të Arianitëve dhe të familjeve të dëgjuaara të Balshajve, të Zenebishtëve, dëshirë të cilën s'mundën ta shuajnë as pushtimet e huaja, si perandoria Bizantine, mbretëria serbe, republika e Venedikut e sundimi bullgar, e mbreti i Napolit, por ky e shoi, ky e shkatëtoi, ky e përvëloi si shtetin dhe kombin.

Të dënohet pa mëshirë shkatërrimtari i shtetit dhe i kombit - u dëgjuan thirrje e vringëlluan jataganë e u zbrazën armë.

- Fal përpjekjeve të arbërve, ky rend te ne përbën një pikë kulmore për zhvillimin shoqëror sepse kristalizoi tiparet tona me rritjen dhe forcimin e principatës së Arbërit. Ndërsa ky e nxirrte këtë periudhë historike duke e quajtur të rëndë e të errët.

- Të dënohet i paudhi, sepse paska shtrëmbëruar të vërtetën, dënim, dënim! - e u vërsulën drejt meje me shpata të xhveshura e kobure të ngrehura.

Dihet historikisht se shtetin tonë të Arbërit e drejton

një kryezot i zgjedhur nga kuvendi, ndërsa ky që një kryebandit i vetëshpallur si zot i vendit. Kur u zgjodh? Kush e zgjodhi? Për sa vjet vallë? S'e dinin shtetasit se s'pyeteshin.

- Dënim më të rëndë për shtypjen ndaj pasardhësve tanë fisnikë.

Në majat e heshtave valëviteshin flamujë me shgabonjën dy krenare.

I dyti ligjëroi historiani mjekërrthinjur:

- Ti vlerësove vetëm atë luftë vllavrasëse nëpërmjet të cilës rrëmbeve pushtetin shtetëror të pamerituar dhe mohove luftrat tona trimërore. A ke dëgjuar për kryengritjet tona kundër pushtimit Osman? A ke dëgjuar për trimëritë e Gjergj Arianitit, për Depo Zenebishtin, për Nikollë Dukagjinin, Gjon Kastriotin, Andrea Topinë... për Kastriotin tjetër, Iskënderin, i cili shkroi epopenë më të lavdishme të kombit tonë, të kurorëzuar me ngritjen e flamurit legjendar në kështjellën e Krujës kreshnike.

- Epokën më të lavdishme e shkrova unë e askush tjetër...

- O i pa tënëzonë, o i pabesë, të shporret që këtej se qënka i sëmurë nga etja për lavdi e të kthehet në ferr përsëri, ky mohonjës i krenarisë së të parëve tanë.

Oratori vazhdoi pasi u qetësua: - Ti e ke pas gjykuar rendin tonë por po ta krahasojmë atë me "epopenë" tënde të errët, zor se quhen shekujt e mesjetës errësirë. Tek ne s'kaloi inkuizicioni, atë e solle ti me pasuesit e tu.

Ne, në rrafshin ideor, nuk na mungonte ndjenja e lidhjes së brendshme të cilën ti me çdo kusht arrite ta shpërbëje, se ishte frika e bashkimit mbarëkombëtar, rreziku numur një për ty dhe për të tutë. Edhe këtë ta theksoj se në etapën tonë u mbrujt e u farkëtua ndër beteja madhore lavdiplote, si në lëmin politik e shpirtëror, idea e një fisi, e një

gjaku dhe e një gjuhe, e cila solli si dhuratë Rilindjen Kombëtare.

- O i sterrosur! në skëterrë, në skëterrë! - u dëgjuan të thirrura dhe armë.

Në fund gjyqtari u ngrit e tha:

Prijësi ynë legjendar e thirri kuvendin e Lezhës për të kapërxyer përçarjen e princërve të Arbërit. Aty ia mbërritën vetëtimthi Gjergj Arianiti, Andra Topia, Gjergj Balshaj, Pal Dukagjini me Nikollën, Teodor Korona Muzaka, Lek Zaharia, Pjetër Spani, Lek Dukagjini e sa e sa të tjerë për të lidhur burri-burrit besën për shpëtimin e Arbërisë, ndërsa ti në Përmet, pasi mblodhe tërë zullumin tënd e dekretove përçarjen.

- Ti e shkatërrove traditën e këtyre trojeve legjendare ku u zhvilluan luftëra për liri e pavarësi, për nder e për drejtësi, si dëshmohet në tre kanunet, të cilët ti i dogje me zjarr e hekur për të veshur vetë rrobën e gjithpushtetshmërisë! - përfundoi ai.

- Të flasi, ç'ka për të thënë, si do të mbrohet? - e vringëllinin jataganët.

Për mua ligji themelor i shtetit është kushtetuta e 46-ës - iu përgjigja me gjysmë zëri.

- Ky nuk njohka as traditë e as kanune, prandaj t'i japim vendimin e të kthehet nga ka ardhur - tha kryeplaku e vendosi përsëri bastunin midis këmbëve. Ndërkohë trupi gjyqësor u mënjanua për të caktuar dënimin.

Në podium të amfiteatrit, i cili ishte ndërtuar në qëndër të kësaj kështjelle mesjetare, dualën grupe folklorike:

Ai që vë popullin nën thundër,

Ooooooooo nën thëmbër,

E goditë plumbi mu në zemër

Ooooooooouuuu... mu në zemër.

(dëgjohe zbrasje armësh)

Një rapsod i veriut.

*Ooooo eeeeej! Ne për kombin,
Kena lind e do vdesim,
Atdhe, flamur, besë e nder,
Kurrë nuk i shesim - Oooooeeej!*

Heshtja ra anembanë. Kreu i trupit gjykues lexoi vendimin:

*Trupin nga varri t'ja krrejnë,
Ë me perona në shkëmb ta mbërthejnë
Ta mbërthejnë me perona në sketerrë,
E kafshofshin gjarpërinjtë gjithë vrer.
Gjarpërinjtë gjithë vrerë ta kafshojnë,
Korbat e zinj mbi kokë t'i fluturojnë.*

Mua më ngritën, më lidhën e më nisën në rrugën e kthimit ku
më priste skëterra nëmëmadhe.

I juaji kurdoherë.

XXV

**Më dënojnë për luftë klasore, një barbari
e paparë në historinë e kombeve.**

Portali këtë radhë më dukej më i zymtë. Rojet e nënëdheut më dorëzuan te një togë gjindarmësh të veshur dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Mua nuk më lodhi udhëtimi se rruga ishte e shkurtër; një shëtitore gjithë gjelbërim me selvi shtatëlarta, fanarë të vendosur mbi shtylla të memerta në të dy anët, pasuri të pjellorisë mendore, por më drobiti si një lengatë fakti se do të më gjykonin ata që kisha dënuar pa mëshirë.

Mbërritëm, oborri ishte i shtruar me pllaka të bardha, përmendore të një arti të rrallë ngriheshin madhërishtë në sallonet e pallatit, afreske ngjyra-plotë i'a shtonin bukurinë kësaj parajse magjepsëse.

Ndërkohë mua më lanë te pragu në hyrje, aty ku përplaseshin rryma ajrore marramëndëse. Eca tre - katër hapa më përpara për t'iu shmangur disi asaj.

Një zë dëgjova: - Ndal! Ku shkon? Lolo, a s'e kupton se po shkel një limit të shenjtë? Kthehu prapsht!

U prapësova. Suferina qefinin ma fërfërinte me tërbim.

Nga lozhat e praruara flisnin oratorët:

- Sundimi yt gjakatar mbaroi. Shpirtin tënd e paskan dërguar për ta dënuar ne. Ti me vetëdije e zell të zjarrtë shkatërrove çfarë ndërtnuan këngët e kanunet, nderin dhe trimërinë, mirësinë dhe bujarinë. Ti mbulove me turp historinë e një kombi, krenarinë e një shteti.

- Shtie sytë bota e tmerrohet kur sheh se ç'mbiu nga fara që mbolle ti me dorën tënde vrastare në shërbim të armiqve tanë shekullorë. Me zjarr i shkumbove bukuritë e cilësitë e larta të shpirtit njerëzor. Ti këpute ëndrrat e djalërisë, dëshirat e nusërisë, mallin e nënave, përvëllove tokën, sulmove qiellin.

- Ne kërkonim zgjimin, ti kërkoje nënshtimin. Unë jam nga të luftës. Ne s'erdhëm pas teje për të fituar grada e trofe, jo, as si banditë e plaçkatarë por ishim të lirisë luftëtarë. Nga emri yt i nëmur, o tiran i përgjakur, tokës mëmë i shkojnë të dridhura tmerri.

- Fjalët e aleatëve qenë fluturake. Tradhëtia e kishte emrin Evropë. Ajo nuk e dinte se ti do të vije bashkë me terrorin, e as të vrisje jetën, as të përtërjje luftën që të rridhnin gjak plagët e kombit; as të përlulje veteranët që të rrëzoje flamurin. Kështu, ambicia e sëmure, edhe kur ia arrin qëllimit, nuk shërohet, por vdes e nëmur nga lëngata e saj.

- Ne do të falim (po të na e lypin të falurën) ata që nuk dinin ç'bënin por jo ty, kurrësesi. Krimet e tua prej përbindëshi i përgjakur akuzojnë për genocid. Tradhëtia e çështjes kombëtare do të mbetet përjetësisht një njollë e pashlyeshme për të cilën do të dënojë historia. Këtë tradhëti të lartë shekujt do të kalojnë e nuk do ta shuajnë. Shkrepetima do ta godasin e nuk do ta verbojnë, brezat do ta kujtojnë e nënat do ta mallkojnë!

- Emri yt do të përmendet si një blanë mënxyre. E vërteta historike do ta përzërë nga rreshtat e shkruara kalimthi, si një rrangalle pa vlerë. Ndërsa atë vend të mjerë do ta përçmojnë gjersa t'i kthehet fati i vet i paraluftës.

- Liria është një ndjenjë e brëndshme të cilën ti nuk mund ta vrisje. Ne për atë u ngritëm dhe për atë ramë. Të tjerë trima do të ngrihen dhe të tjerë martirë do të bjenë, se nuk thy-

hen zemrat e luftëtarëve gjer sa të triumfojë demokracia. Si një nëmë lemerie bredhtë hija jote pa pushim.

- Ti, o i pafë, rrafshove altarë të kultit, se i përfytyroje si "çerdhe" të reaksionit. Ne i kuptuam synimet e tua demoniane që kurse ngrite dorën mëkatore për të goditur për vdekje trashëgiminë shpirtërore. Ti u zhduke shpirtërisht e u ngjalle në kufomë, prandaj e humbe çdo ndjesi njerëzore. Jeta nuk është dukuri e jashtme; ajo nuk përkon me dogmën e një fronti të zvetënuar. Vetëm krijuesi i gjithësisë mbretëron, e qiellin ka për fron.

- Ti iu lejove të "mësuarëve" ato dituri që do t'u shërbenin atyre sa për të vlerësuar paditurinë tënde. Thoshe se ishe "filozofia" dhe "moral" por ti ishe ujku, ti ishe çakalli. Thoshe se ishe shteti dhe gjykata, por ti ishe errësira, ti ishe nata. Ti ishe shtypi, letërsia. Ti ishe burgu, ishe robëria.

Sa kohë që trupi gjykues u mënjanua për të prerë pretencën e prokurorit në plate, oratorët proklamnin poezitë e tyre:

*Jetën dhuruan trimat,
Lotët derdhën nënat,
Vejushat "veshën në zi",
Vashat thyen ëndrrat.*

*Në të njëzetën pranverë,
Plumbat e tradhëtisë,
Më qendisën krahërorë,
Isha biri i trimërisë.*

*Qante nëna pa derdhur lot,
Mbushur zemra dhimbjeplot;
Ne këpusnim përditë vargonj,
Të ngrinin lartë atë shqiponjë,
E dhamë jetën për lirinë
Se s'duronim tiraninë.*

Më në fund u lexua vendimi nga Gjyqi i Lartë

Të mbërthehet në shtyllën e turpit në jetë të jetëve!
Emri i tij; si bir me cenë i skëterrës, u ndryshktë nga bastra
kohore e mbetët përgjithmonë simbol i ligësisë satanike.

Më kthyen përsëri në ferr.

I juaji.

XXVI

Vdekja e një diktature nuk përjashton "Lulëzimin" e një doktrine të dështuar

Muza ime ngordhi.

Mua m'u sos frymëzimi. Kjo është letra e fundit me proklamaten e lëshuar prej Shtabit Qëndror të Fallëve të këtushëm:

"Rrëzimi i Tiranisë më të egër, më barbare e më të urryer që ka kaluar ndonjëherë rruzullimi do të ndodhë në muzg të datës
9 qershor 1991.

Atë ditë do të perëndoje një herë e përgjithëmonë sundimi totalitar i një antinjeriu i cili simbolizoi për një gjysëm shekulli regjimin e mjerimit, të varfërisë e të gjakut.

Kjo mandatë e pashmangshme është e lidhur pazgjydhmërisht me prologun e kësaj tragjedie të pa shëmbullt nga dhimbja.

Ky fund është vetë fillimi.

Po ju mos iu besoni këtyre pallavrave të kota!
Qëndroni grusht bashkuar!

Ti përse mendohesh? Përse mendoheni ju?

Ju porosis të ktheni kokën gjithnjë prapa. Ju takon juve të evokoni kohën e lavdishme të partisë.

Mos më turpëroni se ju kam nderuar.

Tregojuni vendin bandave vandaliste që shkulën truporët e mi. Kundërshtarët më të rrezikshëm janë ata që harrohen: të mundurit!

Përse mendohesh ti?

Ju përse mendoheni?

Në se do t'u duhet të kthehet shikimi nga perëndimi, linja të mbetet në lindje.

E pranoj se kohërat ndryshojnë por fushat e betejave kllasore s'ndërrojnë. Në se vjen sinjali prej përtej kufirit, si na erdhi në ato ditë të furishme të luftës, ju i vishni këtij trualli përsëri qefinin e kuq, të përgjakurin! Mos çani kokën për pasojat. Le t'i paguajë ai që do të paguajë.

Në u zhduktë qeveria dhe shteti, ndoshta edhe kombi, partishmëria le të lulëzojë si një botëkuptim fillozofik revolucionar.

Prandaj mos i kapërceni monumentet e mia, të thyerat, por i mblidhni një për një, si cifla hajmalie, e ndërtoni me to një SFINKS të stërmadh, të duket nga larg si një përbindësh gjigand, i cili të tmerrojë mbarë botën armike.

E unë, ndërkohë, po shkoj të shlyej dënimin.

Ju doni të dini cili është dënimi?

Eh, jam i detyruar të dëshmoj:

Për mua fillimi i dënimit qe shkrimi i këtyre letrave

Por ndërsa mbi mua ra, po bie dhe do të bjenë (sipas parashikimeve) të tjera pësime - mbi ju rëntë mësimi i tyre.-

Ngashërimi juaj është pavdekësia ime.

Ngazëllimi do të jetë lakuriqësia jonë.

Një zë kumbon nga fundi i dheut:

Vetëm harrimi përkon me Kohën e Nëmur.

PËRMBAJTJA

I.	Midis meje dhe lundëtarit të Akeronit një mashtues i madh.....	5
II.	S'lind dielli atje ku perëndon, perënduaka shpirti atje ku lind.....	12
III.	Fjalimi i kryetarit të detashmentit të djajve të skëterrës mbyllet me shfaqje festive.....	17
IV.	Unë nuk e kam më atë që më dhuroi lakmia, ju mbani mësimet e mia	22
V.	Ju m'u bëtë këmbë kur unë u nisa drejt pushtetit shtetëror	28
VI.	"Më sulmojnë të paformuarit për të më sharë e për të më vrarë".....	33
VII.	"Misionit" të UOR fisit kufirin ia caktova te thana....	38
VIII.	Nga biseda me të vdekurin e vitit '53. S'munda të dekonspiroj shefin e proletariatit botëror.....	44
IX.	Ne kërkim të shefit të proletariatit botëror.....	49
X.	Gjeneralisimi një deviator e kapitullant.....	55
XI.	Shefi i përgjithshëm donte harrim të përjetshëm.....	61
XII.	Takim "inkonjito" me të dërguarin e mareshallit.....	66
XIII.	Mareshalli i shqetësuar ka dërguar të gjithë "ekipin" e tij.....	71
XIV.	Bashkëbisedimi merr përpjestime dramatike.....	76
XV.	Vetë ferri tregon të vërtetën!.....	81
XVI.	"Kufiri" i internacionalizmit tim mbaronte atje ku fillon kulti im.....	88
XVII.	Sa më e madhe "motra" aq më e madhe tradhëtia.....	95
XVIII.	Orët e Kremlinit s'tingëllonin më për mua.....	102
XIX.	Vendi ynë - Kështjellë e pathyeshme.....	107
XX.	Po prekët presjen, do tronditen truporet.....	113

XXI.	Lemza: Fiziologji, telepati apo bestytini?.....	120
XXII.	Primitivët ngulmojnë të më dënojnë për shfarrosjen e fiseve pasardhëse.....	125
XXIII.	Kërkojnë të më dërgojnë si kryepronar i tre milionë skllevërve.....	130
XXIV.	Duan te me denojne si kryefeudal i mijëra e mijëra bujkrobërve.....	135
XXV.	Më dënojnë për luftë klasore, një barbari e paparë në historinë e kombeve.....	140
XXVI.	Vdekja e një diktature nuk përjashton "Lulëzimin" e një doktrine të dështuar.....	144



U lindi në Berat në vjeshtën e dytë të vitit '31. Filloren e të mesmen pedagogjike i mora në qytetin tim. Më pak se 20 vjet në arsim, më tepër se 20 vjet në ndërtim.

Tani, në moshë të thyer:

Po zbulohem nga errësira e kohës për t'u ndriçuar,
Po dal nga mjegulla e harresës për t'u kujtuar,
Po kthehem nga lufta e klasës për t'u pajtuar.

Letra nga skëterra - roman publicistik

Vargje mbi vargonj - poezi

Shtetëzimi i njëthundrakëve - komedi

Letra nga skëterra
Roman publicistik
Uegen, 1996

051

Çmimi 150 lekë